

1 E hënë, 2 dhjetor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.02

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare e seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARE E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
12 procesverbal të akuzuarit janë të gjithë të pranishëm në
13 sallën e gjyqit sot.

14 Do të fillojmë sot me dëshminë e Dëshmitarit të
15 Prokurorisë 04401.

16 Përpara sesa të sillet dëshmitari në sallë, Trupi Gjykses
17 do të lëshojë një urdhër gojor përpara parashtrimin F02729 dhe
18 postën elektronike të ZPS-së të datë 30 tetor 2024.

19 Trupi Gjykses vëren se në një email të dërguar më datë 30
20 tetor 2024, ZPS-ja informoi Panelin dhe palët si dhe
21 pjesëmarrësit që faqja U015-8879 e dokumentit U015-8743-U015-
22 9047, të cilën ZPS-ja ia kishte treguar z. Selimi gjatë
23 intervistës me ZPS-në të vitit 2020 edhe që ZPS-ja synonte ta
24 pranonte për pranim në parashtrimin e protokolluar P01351, për
25 shkak të një gabimi administrativ nuk përfshihet në provën

1 P00765, e cila është pranuar në pajtim me vendimin e Trupit
2 Gjykues në parashtrimin e protokolluar F01917. Për rrjedhojë,
3 ZPS-ja kërkon pranimin e faqes U015-8879 dhe përkthimin
4 përkues në anglisht.

5 Mbrojtja nuk u përgjigj komunikimit të ZPS-së më datë 30
6 tetor 2024.

7 Në parashtrimin F02729, të parashtruar në 18 nëntor 2024,
8 ZPS-ja parashtroi se faqja 076604 e provës P00760 - edhe një
9 herë është P00760 - nuk pasqyron faqen që i është treguar z.
10 Thaçi gjatë intervistës me ZPS-në në korrik të vitit 2020 për
11 aq sa duhet të përmbajë faqja SITF00243024 dhe jo në fakt
12 faqen SITF00243029. Duke qenë se të dyja faqet SITF00243028
13 dhe SITF00243029 janë pranuar si prova gjyqësore më vete si
14 provë me numër P01749, ZPS-ja kërkon që faqja SITF00243028 e
15 provës P01749 që është P01749-ET në anglisht të lidhet me
16 provën materiale P00760 dhe fusha e komenteve në *Legal*
17 *Workflow* duhet të përditësohet në mënyrë të tillë që të
18 pasqyrojë historikun procedural përkatës.

19 ZPS-ja ka parashtruar gjithashtu që ka katër prova
20 shoqëruese nga intervista e ZPS-së me z. Selimi të vitit 2019
21 që nuk janë kërkuar gabimisht që të pranohen si prova në
22 parashtrimin e ZPS-së F01351. Trupi Gjykues e ka fjalën për
23 dokumentet e identifikuar në poshtëshënimin 10 të parashtrimit
24 F02729, që përbëhet nga një vendim i nënshkruar nga z. Selimi,
25 dy intervistat të dhëna prej tij dhe fotografive të asaj kohe.

1 ZPS-ja parashtron që këto materiale janë relevante, kanë vlerë
2 provues, janë përdorur dhe janë diskutuar në provën P00761 dhe
3 për pasojë duhet të pranohen.

4 Mbrojtja nuk është përgjigjur ndaj parashtrimin F02729.

5 Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja synon të paraqesë për
6 pranim në prova gjyqësore sipas parashtrimin F01351 materialet
7 përkatëse dhe, sikurse e përmenda, për shkak të gabimeve
8 administrative nuk e ka bërë këtë gjë.

9 Trupi Gjykses është i bindur që për arsyet e deklaruara
10 në parashtrimet e ZPS-së edhe që sapo u cituan në këtë urdhër
11 gojor, në pajtim me kriteret e rregullës 138(1) këto kritere
12 janë përmbushur sa i takon faqes U015-8879 të dokumentit më
13 të gjatë U015-8743 deri në U015-9047, si dhe dokumentet e
14 përmendura në poshtëshënimin 10 të parashtrimin F02729. Këto
15 materiale dhe përkthimet e tyre përkatëse pranohen në prova.

16 Trupi Gjykses, për pasojë, udhëzon Zyrën Administrative
17 që të bashkëlidhë faqen U015-8879 në provën P00765 me numër të
18 ri prove materiale P00765.1, që të shtojë U015-8879-ET në
19 provën ekzistuese P00765-ET.2 dhe të caktojë numra provash për
20 dokumentet e pranuar të renditura në Poshtëshënimin 10 të
21 parashtrimin F02729 duke i bashkëlidhur atë në provën P00761.

22 Për më tepër Trupi Gjykses e udhëzon Zyrën Administrative
23 që të lidhë faqen SITF00243028 të provës P01749 që është
24 P01749-ET në anglisht në provën gjyqësore P00760 dhe të
25 përditësojë fushën e komenteve në sistemin *Legal Workflow* për

1 të pasqyruar historikun përkatës procedural.

2 Këtu përfundon ky urdhër gojor.

3 Znj. Sekretare, ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

4 [Dëshmitari vijon dëshminë]

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për

6 procesverbal Avokati Kujdestar për Dëshmitarin 04401 është i

7 pranishëm në sallën e gjyqit. Mirëmëngjes, Avokat.

8 Mirëmëngjes, Dëshmitar.

9 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kujtoj që

11 duhet që t'i përgjigjeni pyetjeve qartë edhe me fjali të

12 shkurtra. Në qoftë se nuk e kuptoni një pyetje, lirisht mund

13 t'i kërkonti avokatit që ta përsërisë pyetjen ose mund t'i

14 thoni që nuk e kuptoni pyetjen dhe ata do bëjnë sqarimet e

15 nevojshme. Po ashtu, ju lutem thoni se cila është baza e

16 njohurive, fakteve dhe rrethanave të pyetjeve për të cilat do

17 të pyeteni.

18 Gjithashtu duhet të flisni pranë mikrofonit, bëni një

19 pauzë prej pesë sekondash përpara se t'i përgjigjeni pyetjeve

20 në mënyrë të tillë që t'ju kapin përkthyesit.

21 Nëse e shihni të nevojshme për të bërë një pushim, na e

22 bëni me dije këtë gjë edhe ne do të bëjmë organizimet

23 përkatëse.

24 Ju kujtoj që jeni në detyrimin që të thoni të vërtetën

25 ashtu siç keni deklaruar në betimin solemn. Ju kujtoj

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 5

1 gjithashtu që garancitë që ju janë dhënë nga Trupi Gjykses të
2 enjten janë ende të zbatueshme, dhe refuzimi për të dhënë
3 dëshmi mund të sanksionohet me një gjobë.

4 Tani do të vazhdojmë me pyetjet e Prokurorit të ZPS-së.
5 Ju lutem dëgjojini me vëmendje.

6 Z. Halling, e keni ju fjalën.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

8 DËSHMITARI: SOKOL BASHOTA [Vijon]

9 Pyetje nga z. Halling: [Vazhdim]

10 Z. HALLING: [Përkthim]

11 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Do fillojmë aty ku e lamë në fund
12 të javës së mëparshme. Po flisnim për një takim në Negroc në
13 mes të vitit 1998 në të cilin merrnit pjesë ju dhe persona të
14 tjerë duke përfshirë këtu edhe katër të akuzuarit. Për
15 procesverbal, kjo jepet në faqen 23021 deri në 23024 të
16 transkriptit të javës së mëparshme.

17 Ju keni thënë gjithashtu që kishte emërime të diskutuara
18 në këtë takim por ato ishin vetëm në letër, në përjashtim të
19 Jakup Krasniqit dhe emërimin e tij si zëdhënës. Dhe ju mbajtët
20 mend drejtoritë e Shtabit të Përgjithshëm të cilat janë
21 krijuar vetëm pas atij takimi.

22 A ju kujtohet që kjo të ketë qenë një përmbledhje e
23 diskutimit të fundit që neve kemi bërë përpara një jave,
24 Dëshmitar, ju kujtohet kjo?

25 PË. Po.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do i kërkoja Sekretares së
2 seancës që të paraqesë në ekran dokumentin P1277, faqja U015-
3 8833, kjo është pjesë e një dokumenti më të gjatë që mban
4 numrin U015-8743 dhe U015-8935 do ju kërkoja që ta paraqisni
5 këtë fletë në shqip dhe në anglisht.

6 PY. Dëshmitar, ndërkohë që ky dokument paraqitet në ekran,
7 juve ju janë treguar pjesë të librit të Jakup Krasniqi "Kthesa
8 e madhe" gjatë seancës përgatitore. Kjo është një faqe tjetër
9 e të njëjtit libër, kështu që do shikojmë një pjesë bashkë
10 pastaj do ju bëjmë një pyetje.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti P1277 nuk
12 është në listën e dokumenteve. Nuk e gjej dot.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë mund të nxirret me numër
14 ERN të librit dhe referenca për librin është U015-8743 deri në
15 U015-8749. Faleminderit, znj. Sekretare e seancës.

16 PY. Dëshmitar, kjo është faqja për të cilën do të doja të
17 bëja pyetje. Këtu Jakup Krasniqi thotë në fillim fare të faqes
18 që:

19 "Sidoqoftë Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së më 11 qershor
20 1998 me Deklaratën Politike numër 3 shpalli si zëdhënës të
21 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së është Jakup Krasniqi ..."

22 Më pas ai jep përbërjen e Shtabit të Përgjithshëm në atë
23 kohë. Ndërkohë që më poshtë në fund të faqes thuhet që:

24 "Kjo përbërje e Shtabit të Përgjithshëm është konfirmuar
25 në takimin e Negrocit ..."

1 Tani dua që të përqendrohemi tek ajo çfarë ka thënë Jakup
2 Krasniqi se cila është përbërja e Shtabit të Përgjithshëm. Aty
3 thuhet Azem Syla është komandant i përgjithshëm. Ju që jeni
4 zëvendëskomandant. Rexhep Selimi është inspektor gjeneral.
5 Pastaj kemi Hashim Thaçin, kryeshef për drejtorinë e
6 informimit, Kadri Veselin kryeshef për drejtorinë e shërbimit
7 informativ dhe vazhdon më pas lista.

8 Pyetja ime për ju është kjo: Kjo faqe a ju ndryshon
9 mendimin ju që drejtoritë e përgjithshme, drejtoritë e Shtabit
10 të Përgjithshëm në vitin 1998 ekzistonin në fakt? Ky
11 informacion a jua ndryshon mendimin, Dëshmitar?

12 PË. Po. Po.

13 PY. A mund të na e shpjegoni pak më tej?

14 PË. Kjo, ky takim është mbajtur në Negrovç. Kjo ka qenë një
15 përpjekje e jona që të startojmë me një organizim siç është
16 Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Dhe në këtë takim është caktuar
17 z. Jakup Krasniqi si zëdhënës i UÇK-së. Qëllimi për ta bë
18 zëdhënës të UÇK-së z. Jakup Krasniqi ishte si rezultat i
19 propagandës së madhe që na lancoi në opinion për ushtrinë
20 Çlirimtare të Kosovës dhe kemi pas për qëllim që të caktohet
21 një adresë dhe një zë i qartë për objektivat e Ushtrisë
22 Çlirimtare të Kosovës.

23 Ndërsa këta emra kanë mujt veç me u përmend, por me këto
24 funksione nuk besoj që ka pas diçka, diçka të vërtetë, me aq
25 sa më kujtohet mu. Kjo strukturë është arritur veç në mbas

1 ardhjes së Bislím Zyrápit në Kosovë, kur është bë dhe
2 strukturimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në fund të këtij
3 viti. Përbërja ka qenë e njëjta, siç është përshkru këtu.
4 PY. Ju thatë se z. Krasniqi ka qenë në këtë takim në Negroc.
5 Kështu që, në qoftë se e kuptova siç duhet atë çfarë thatë
6 tani në fund, do të thuash që z. Krasniqi e ka thënë gabimisht
7 që ish-in krijuar drejtoritë? Domethënë, këtë informacionin në
8 këtë faqe e ka dhënë gabimisht, nuk e kuptova çfarë thatë?
9 PË. Po duke marrë parasysh që ky libër është shkru mbas
10 luftës, ka të ngjarë. Nuk po di tash, s'po muj me e perceptu
11 saktë atën çka ka dashtë me thënë z. Krasniqi në këtë libër
12 edhe në këtë shkrim. Por, këta emra janë laku, por thjesht
13 kanë qenë, kanë mbet vetëm në letër dhe asnjëherë nuk janë bë
14 as publike dhe asnjëri s'ka mujt me ushtru detyrën për të
15 cilën është përcaktuar në këtë libër.
16 PY. Kjo duket sikur paksa ndryshe krahasimisht me atë çfarë
17 na thatë përpara një jave. Këto drejtori, përfshirë këtu edhe
18 drejtorinë e shërbimit informativ, a janë diskutuar, apo jo,
19 në këtë takim, Dëshmitar?
20 PË. Po, nuk po muj me mbajt mend se ka qenë një takim që më
21 tepër ka pas fokus përcaktimin e një zëdhënësi të Ushtrisë
22 Çlirimtare të Kosovës dhe nuk muj me i mbajt mend të gjitha
23 detalet që janë mbajt në atë takim. Po kryesisht jemi munduar
24 që të bëjnë një, të fillojmë një strukturim të UÇK-së por që
25 realisht nuk kemi mujt me arrit derisa kanë ardh ekspertët

1 ushtarakë, siç është Bislum Zyrapi, Agim Çela dhe ushtarakët e
2 tjerë të cilët i kanë njoft mirë organizimet ushtarake.

3 PY. Dëshmitar, Kadri Veseli po ashtu është pyetur sa i takon
4 drejtorisë së shërbimit informativ në intervistën me Baton
5 Haxhiun.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk besoj që është e rëndësishme
7 që të tregojmë intervistën në ekran, megjithatë bëhet fjalë
8 për provën P1859 ose faqja SPOE00053011.

9 PY. Po ju bëj një përmbledhje, Baton Haxhiu pyet:

10 "Çfarë është G1 dhe G2?"

11 Dhe Kadri Veseli ka thënë që:

12 "G2 është Drejtoria e Shërbimit Informativ të Kosovës.

13 Dhe ky vendim është marrë në qershor të vitit 1998 ..."

14 A keni ndonjë arsye për të kontestuar apo për të
15 kundërshtuar atë çfarë ka thënë Kadri Veseli për Baton
16 Haxhinë?

17 PË. Nëse e ka thënë Kadri Veseli nuk kam arsye me e kontestu.

18 Por thashë, nuk besoj që ka mujt me ushtru këtë funksion për

19 arsye. Se këta emra nuk janë bë publike kërkun dhe askund

20 s'kanë mujt me ushtru funksionin për të cilin është folur

21 këtu, deri, thashë, deri më strukturimin e UÇK-së. Nëse ka pas

22 diçka të tillë unë nuk po muj, nuk e kontestoj, me dijeninë

23 teme jo.

24 PY. A është e saktë atëherë që drejtoritë vetë kanë qenë

25 krijuar në qershor të 1998-s, kështu i takon?

1 PË. Jo, se thashë nuk kemi mujt me ushtru kurrë funksionin.
2 Këto thjesht kanë qenë, bile, në atë kohë s'e besoj që kanë
3 qenë as në letër. Por këtu janë përshkru nga z. Krasniqi në
4 këtë libër dhe po më kthen memorien tek ky takim që është
5 diskutu, por për emra të përveçëm me këto detyra të
6 përcaktuara kështu, unë tash po e di.

7 PY. Në citimin e Kadri Veselit që sapo ju lexova, ai thotë që
8 vendimi për G2 është marrë në qershor të 1998. A e thotë gabim
9 Kadri Veseli sa i takon krijimit të G2?

10 PË. Jo, nuk po e kontestoj atë.

11 PY. Kur ju pyeta që a është e saktë që drejtoritë janë
12 krijuar në qershor të 1998-s, ju më keni thënë "jo", ndërkohë
13 që Kadri Veseli thotë që vendimi është marrë në qershor të
14 1998-s. Po mundohem që të kuptoj se cila është dëshmia juaj
15 dhe si krahasohet kjo dëshmia me atë çfarë ka thënë Veseli.

16 PË. Unë thashë kjo veç ka qenë vetëm një përpjekje, por jo --
17 se në një ushtri, një ushtri e cila synon të organizohet në
18 kuptimin organizativ të mirë me kaq pak drejtori, ku në mesin
19 e tyre dy persona kyç nuk kanë qenë në Kosovë, nuk di sesi
20 mundet me qenë efektive një organizim ushtarak i tillë.

21 Atëherë në Kosovë s'ka qenë as komandanti që është përmend
22 këtu, komandanti përgjithshëm, z. Azem Syla, po nuk ka qenë as
23 kryeshefi këtu për drejtorinë logjistike dhe furnizim, që
24 thuhet Xhavit Haliti. Pastaj Hashimi, Hashim Thaçi, Kadriu
25 kanë dalë disa herë, kanë lëvizë për Shqipëri.

1 Dhe me tre veta s'e besoj që kemi pas mundësi që të quhet
2 tamam, tamam shtab i organizuar.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Do i lutesha Sekretares së seancës
4 që të paraqesë në ekran dokumentin SPOE00226856 deri në
5 SPOE00226857. Do ju kërkoja që të paraqisnit faqen e dytë në
6 shqip dhe në anglisht.

7 PY. Dëshmitar, ju thatë që në këtë takim ka marrë pjesë dhe
8 Rexhep Selimi. Tani dëshiroj që të shikojmë diçka që ai ka
9 shkruar për një muze në Kosovë lidhur me të njëjtën temë.
10 Presim për një çast derisa të shfaqen dy faqet.

11 Këtu në fillim të faqes thuhet:

12 "Në maj të vitit 1998, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së
13 formon të gjitha drejtoritë përbërëse të shtabit ku edhe merr
14 formën complete të tij që nga struktura komanduese e deri në
15 çdo detaje përbërës të organizimit të shtabit ..."

16 Më pas besoj që mund të shikoni një listë të drejtorive,
17 domethënë, G1, G2, e tjerë, përfshirë këtu edhe drejtorinë e
18 shërbimit informativ. Dhe kjo thotë që janë krijuar edhe
19 përpara takimit në Negroc, domethënë, megjithatë thuhet që
20 kanë ekzistuar disa drejtori të caktuara në qershor të vitit
21 1998. Edhe Rexhep Selimi e ka gabim lidhur me atë çfarë thotë
22 këtu?

23 PË. Rexhep Selimi po thotë në maj, unë në maj nuk e di që
24 Shtabi i Përgjithshëm ka qenë formu. Përpjekja e yne ka qenë
25 në qershor, mesa mbaj mend, pikërisht në këtë, në fshatin

1 Negroc dhe jo në maj siç po thuhet në këtë shkrim. Po ashtu në
2 atë kohë nuk ka pas G1, as G2, as G3, as G4. Se këto
3 organizime ne nuk i kemi njoft në atë kohë. Se asnjëri prej
4 neve s'ka qenë ekspert ushtarak për me i emërtu drejtoritë me
5 G1, G2, G3 e kështu me radhë. Dhe këto janë ba vetëm në
6 strukturimin e UÇK-së, domethënë, mbas ardhjes së oficerëve
7 dhe në fund të vitit 1998. Unë mendoj se këtu është e
8 zmadhune, ndoshta nga konteksti kohor që është bë ky shkrim.

9 Por realisht kjo nuk qëndron.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dokumentet që
11 iu treguan këtij dëshmitari tregojnë që ka një lidhje të
12 drejtpërdrejtë ndërmjet takimit në Negroc dhe drejtorive të
13 Shtabit të Përgjithshëm. Të gjitha këto dokumente janë
14 relevante si sa i takon ekzistencës së drejtorive në atë kohë
15 dhe besueshmërisë së dëshmitarit lidhur me këtë temë.

16 Faqet që diskutuam lidhur me Veselin dhe Krasniqin janë
17 të pranuar. Ndërkohë që ky dokument nuk është i pranuar.
18 Është një dokument i cili është marrë nga shtëpia e Rexhep
19 Selimit. Është diskutuar në seancën përpara kësaj. Është një
20 dokument që ka vlerë *prima facie* dhe kështu që duhet të
21 pranohet në provë gjyqësore.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
23 kundërshtim?

24 Z. ROBERTS: [Përkthim] Kundërshtojmë. Besoj që edhe vetëm
25 fjalia e fundit e asaj çfarë tha dëshmitari, mjafton për të

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 13

1 mos e pranuar këtë dokument sepse dëshmitari tha që:

2 "Sipas pikëpamjes sime kjo nuk përkon me realitetin."

3 Nuk e di se si mund të pranohet ky dokument pas kësaj që
4 tha dëshmitari.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, kundërshtimi ynë
6 për Prokurorinë pjesërisht ka të bëjë me kundërshtimin e
7 besueshmërisë së dëshmitarit. Sikurse e thashë dhe një javë më
8 përpara, Dëshmitari nuk mund të diskreditohet nga ZPS-ja sepse
9 ZPS-ja e ka dëshmitarin e vet këtë. Dhe në qoftë se do të
10 shkojë në këtë pistë, kjo mund të bëhet vetëm përmes një
11 deklarate.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Përsëri, ne kemi bërë çdo gjë që
13 parashikohet në kufijtë e rregullores dhe dua të them që ky
14 dokument është i pranueshëm *prime facie*, në qoftë se ky
15 dokument nuk është *prima facie* i pranueshëm atëherë nuk e di
16 cili dokument mund të ishte i pranueshëm.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
18 SPOE00226858 deri në SPOE00226857 pranohet në provë gjyqësore.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
20 i caktohet numri i provës P01881. A mund ta sqaroni se çfarë
21 klasifikimi ka dokumenti, ju lutem?

22 Z. HALLING: [Përkthim] Ky dokument do të klasifikohet si
23 publik.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Klasifikoheni
25 si publik, ju lutem.

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 14

1 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

2 Të paraqesim në ekran tani provën P1109. Për momentin,
3 mjafton që të tregohet vetëm versioni në shqip. Për
4 procesverbal ERN ka numrin U002-2855 dhe U002-2868.

5 PY. Dëshmitar, dokumenti që kemi në ekran --

6 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe do kërkoja që ta zmadhoni pak
7 më shumë dokumentin.

8 PY. Pra, kjo është pjesa e dokumenteve që ne ju kemi treguar
9 në seancën përgatitore. Dëshiroj që t'ju pyes lidhur me
10 përmbajtjen e këtyre faqeve. Megjithatë si pikë paraprake
11 fillestare, më lejoni të them që dua të kalojmë shkurtimisht
12 bashkë 14 faqe, dhe do t'ju pyes lidhur me këto faqe në qoftë
13 se shkrimi i dorës është i juaji dhe në qoftë se shënimet në
14 këtë dokument i keni shkruar ju me shkrimin tuaj të dorës. A e
15 kuptoni këtë, Dëshmitar?

16 PË. Po.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Pra, kjo është faqja 2885.

18 PY. A e keni shkruar ju këtë dokument, Dëshmitar?

19 PË. Jo.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Kalojmë tek 2857.

21 PY. Po këtë faqen e keni shkruar ju me shkrimin tuaj,
22 Dëshmitar?

23 PË. Shkrimi jem duket.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Kalojmë tek 2857.

25 PY. Kjo është e vetmja faqe që është e shtypur në kompjuter.

1 A keni informacion se çfarë është ky dokument dhe kush e ka
2 shkruar atë, kush e ka përgatitur atë, çfarë përmban ky
3 dokument dhe kush e ka përgatitur atë, Dëshmitar?

4 PË. Jo, nuk e di.

5 PY. Në rregull.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Shkojmë tek faqja 2858.

7 PY. Po këtë a e keni shkruar ju?

8 PË. Po.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Tek faqja që përfundon me 59.

10 PY. Po këtë faqe?

11 PË. Po, po më duket. Po.

12 Z. HALLING: [Përkthim] 2860.

13 PY. Po ky është shkrimi juaj i dorës?

14 PË. Po.

15 Z. HALLING: [Përkthim] 61.

16 PY. Është shkrimi juaj?

17 PË. Po.

18 Z. HALLING: [Përkthim] 62.

19 DËSHMITARI: Këtë s'po muj me vërejt saktë. S'muj me.

20 Z. HALLING: [Përkthim]

21 PY. Në rregull.

22 Z. HALLING: [Përkthim] 63.

23 PY. Në fund, në fund të faqes a është shkrimi juaj?

24 PË. Po, duket po.

25 Z. HALLING: [Përkthim] 2864.

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 16

1 DËSHMITARI: Po.

2 Z. HALLING: [Përkthim] 2865.

3 PY. Ky a është shkrimi juaj?

4 PË. Po.

5 Z. HALLING: [Përkthim] 2866.

6 PY. E njëjta pyetje?

7 PË. Po.

8 PY. 2867. Është shkrimi juaj?

9 PË. Jo.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe faqja e fundit 2868.

11 PY. A është shkrimi juaj?

12 PË. Jo.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do i lutesha të vendosim

14 versionin në anglisht të kësaj prove materiale dhe të shkojmë

15 në faqen që mban numrin U002-2861.

16 PY. Dëshmitar, fokusohemi tek faqja në ekran, këtu thotë

17 "Mbledhja e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, 30 dhjetor

18 1998". A keni marrë pjesë në një mbledhje të Shtabit të

19 Përgjithshëm të UÇK-së ju ku janë diskutuar pikat që janë

20 përmendur në rendin e ditës në këtë faqe?

21 PË. Po.

22 PY. Këtu është edhe emri juaj përbri një "Komisioni për

23 gradimet". Ky komisioni për gradimet a u bë ndonjëherë

24 funksional?

25 PË. Jo, asnjëherë s'ka qenë funksional, për arsye se s'kemi

1 pas grada në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

2 PY. Këtu ku thotë "Komisioni për caktimin e vijave

3 kufizuese", këtu thotë "Shërbimi Informativ (zëvendësi i

4 Kadries)". A ju kujtohet si e ka pasur emrin zëvendësi i

5 Kadriut në këtë kohë?

6 PË. Në cilën pjesë? Se s'po mundem saktë me e gjet.

7 PY. Është poshtë, është një me shkurtim dhe thotë "Kom. Cak.

8 Vija. Kufi". Është një shigjetë djathtas, këtu, poshtë emrit

9 tuaj, poshtë komisionit të gradimit. Poshtë komisionit të
10 gradimit shihni më poshtë.

11 PË. Po, po.

12 PY. Poshtë, poshtë këtu thotë "Zv. i Kadriut".

13 PË. Po. Tani.

14 PY. Kush ka qenë zëvendësi i tij më 30 dhjetor 1998?

15 PË. Nuk e kam idenë. Nuk di. Nuk e di nëse ka pas një

16 zëvendës Kadri Veseli. As nuk e di çka është. Ça kam dashtë me
17 thënë këtu.

18 PY. Po atëherë pse e keni shkruar këtu zëvendësi i Kadriut në
19 këtë mbledhje të dhjetorit 1998 në qoftë se Kadriu nuk ka
20 pasur një zëvendës?

21 PË. Nuk e di. Nuk e di absolut. Ose ka qenë dikush që e ka
22 mujt me e caktu ose -- nuk e di. Saktë nuk e di me thënë të
23 drejtën. Nuk më kujtohet. E derisa s'ka një emën, s'po muj me
24 thënë kurrgjë.

25 PY. Këtu thotë "Luli" më poshtë, mbi Lulin është një numër

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 18

1 telefoni. Çfarë është ky numër a e dini?

2 PË. Nuk e di.

3 PY. A e keni nënshkruar ju këtë faqe?

4 PË. Po, nga nënshkrimi që kam këtu po del sikur me e shkru në
5 këtë letër dikun. Siç e thashë edhe në seancën përgatitore, ky
6 mund të jetë naj shkrim të cilin kam dasht me e përpilu me bë
7 naj shkrim gazetaresk. S'ma merr mendja që është shkru në
8 periudhën e luftës. S'po besoj. Nuk po di. Përderisa këtë
9 nënshkrim nuk e di që e kam përdor në -- ky a nënshkrim që e
10 përdori sot.

11 PY. Nëse nuk është shkruar gjatë periudhës së luftës ky
12 dokumentet, atëherë pse e keni nënshkruar?

13 PY. Po ky nuk a dokument për mu. Ma tepër, as në dukje nuk
14 është dokument. Në një dokument nuk lejohet që të bëhen këso
15 shkrime, numra telefoni, viti, nënshkrime pas nënshkrimi. Ky
16 s'është një dokument zyrtar, mendoj, i Ushtrisë Çlirimtare të
17 Kosovës. Përndryshe do të ishte një gabim kjo. Nuk e di as
18 arsyen pse e kam bë me thënë të drejtën, po me siguri kam
19 dasht me i pasuru duke iu referu ndonjë libër ose ndonjë
20 shkrim dikun dhe e kam bë këtë. Po s'po -- kjo më shumë goxha
21 sen që është bë mbas luftës sesa gjatë luftës. Nuk po muj me
22 kuptu.

23 PY. Të flasim për nënshkrimin tuaj.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Me ndihmën e Sekretares së seancës
25 ju lutem më jepini një stilokalem dëshmitarit.

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 19

1 PY. Na thoni me saktësi ku është nënshkrimi juaj në këtë

2 faqe, z. Dëshmitar?

3 PË. Nuk e kam faqen e plotë.

4 PY. Po tani e shihni?

5 PË. Po. Është këtu. Është këtu. Këtu, këtu, këtu. është në

6 gjashtë vende.

7 PY. Faleminderit.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Do kërkonim që kjo të pranohet si
9 faqe veçmas në provat gjyqësore. Nuk e di nëse është e mundur
10 që t'i bashkëngjitet provës që mban numrin P1109.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

12 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

14 Materiali me numër U002-2861 pranohet. Do mbështetemi tek
15 ekspertiza e Sekretares së Gjykatës të na tregojë se si mund
16 të veprojmë lidhur me numrin që do t'i jepet.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do ta ruaj imazhin me
18 shënimin përkatës siç është dhe do t'i jap numër veçmas që
19 është P1109.1.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është
21 konfidencial apo publik ky dokument?

22 Z. HALLING: [Përkthim] Besoj se kjo faqe në fakt mund të
23 jetë publike.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

25 Atëherë kjo provë materiale riklasifikohet si provë publike.

1 Z. HALLING: [Përkthim]

2 PY. Dëshmitar, ju na thatë që ekziston mundësia që këto
3 shënime mund të jenë bërë edhe pas luftës, pas periudhës së
4 luftës. A është e njëjta gjë dhe me shënimet e tjera që pamë
5 më herët pak më përpara, mund të jenë shkruar dhe ato pas
6 luftës?

7 PË. S'mujta me i verifiku për aq kohë sa mu prezantun në
8 ekran.

9 PY. Shohim një faqe konkrete atëherë.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Shkojmë në materialin me numër
11 U002-2863 dhe në shqip dhe në anglisht.

12 PY. Dëshmitar, në fund të faqes a është nënshkrimi juaj?

13 PË. Po.

14 PY. A është shkruar edhe ky dokument pas luftës?

15 PË. Nuk e di. Nuk e di. Thjesht nënshkrimet e kam praktikë që
16 çdo herë i përdori në çdo kohë dhe gati, gati në çdo shkrim që
17 e bëj, përpos atyre dokumenteve zyrtare që realisht nuk
18 guxohen të preken.

19 PY. E keni për praktikë apo për zakon që të shënoni dhe vitin
20 "1998" përbri nënshkrimit tuaj për dokumentet që janë shkruar
21 atë vit?

22 PË. Mvaret. Nuk kam ndonjë, ndonjë -- thjesht s'e kam mendu
23 këtë se që realisht mundet me pas një impakt dhe e bëj herë
24 pas here.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Shkojmë në faqen U002-2865.

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 21

1 PY. E shihni datën këtu "29 dhjetor 1998, Mbledhje e Shtabit
2 të Përgjithshëm". Poshtë këtu thotë:

3 "Blerim Kuqi - Dezertor."

4 A keni marrë pjesë në ndonjë mbledhje të Shtabit të
5 Përgjithshëm në këtë periudhë kohore ku është diskutuar Blerim
6 Kuqi si dezertor?

7 PË. Është përfol që ai është largu nga Kosova pa i raportu
8 askujt, pa i dhënë një raport dikujna se po ik nga Kosova. Por
9 që ky dokument është shkru në atë kohë, prapë po them, që nuk
10 -- s'po muj, s'po muj, nuk po muj me konsulltu. Ose është
11 marrë nga ndonjë dokument tjetër edhe është ba më vonë. Unë
12 thjesht nuk po muj me -- s'muj mbajt mend.

13 PY. Majtas më poshtë të faqes -- në fund të faqes - më falni
14 - a është nënshkrimi juaj?

15 PË. Po, po, nënshkrimi është.

16 PY. A ka një "1998" përbri nënshkrimit tuaj?

17 PË. Po, po.

18 PY. Një pyetje të fundit lidhur me këtë faqe. Në fund thotë:

19 "E diel data 13, ora 12:00 - një mbledhje e mbajtur me
20 pjesëmarrjen e Gani Krasniqit ..."

21 Atëherë fillojmë tani dhe flasim për fillimin e luftës
22 mars-prill të 1998, në këtë periudhë kohore a e keni parë
23 ndonjëherë Gani Krasniqin?

24 PË. Mund ta kem pa. Nuk jam i sigurtë.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do lutesha të

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 22

1 shkonim në Shënimin Përgatitor numër 2, paragrafi 24 për të
2 parë nëse ka një mospërputhje.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

4 Z. HALLING: [Përkthim]

5 PY. Dëshmitar, gjatë seancës përgatitore ju keni thënë, se në
6 mars-prill të 1998-s, e keni parë Gani Krasniqin në Drenicë që
7 po ndihmonte popullatën atje, a është e vërtetë?

8 PË. Po. Po.

9 PY. Pra, e keni parë dhe a jeni takuar me të në zonën e
10 Drenicës?

11 PË. Gani Krasniqin e kam pa në shumë raste. Ka qenë një prej
12 atyre që ka ndihmu shumë popullatën e shpeshherë edhe Ushtrinë
13 Çlirimtare të Kosovës në veshmbathje dhe ushqime të ndryshme.
14 Dhe atë e kam pa disa herë gjatë -- jo, tash me muaj nuk po
15 muj saktë me përcaktu, po muj me thënë gjatë tërë vitit. Edhe
16 nuk e kam pa veç në Drenicë, po e kam pa edhe në fshatin tim
17 të lindjes ku ka pru ndihma ushqimore.

18 PY. Po në Malishevë a e keni parë?

19 PË. Po, me siguri që e kam pa.

20 PY. Flasim prapë për Drenicën. Gjatë luftës sa shpesh shkonit
21 ju në Drenicë?

22 PË. Po gjatë luftës -- unë i kam krejt familjen në pjesë të
23 Drenicës. Dhe unë nënën e kam nga Drenica. Dhe po ashtu motrën
24 e babës e kam pas të martuar në Drenicë. Dhe kam shkuar disa
25 herë. Kam edhe motrën të martuar atje. Kështu që na lidhin

1 vija farefisnore me plot njerëz në Drenicë.

2 PY. Gjatë kohës kur shkonit në Drenicë, a ndodhte që të
3 flisnit ndonjëherë apo të bisedonit ndonjëherë me Sylejman
4 Selimin?

5 PË. Sylejman Selimin e kam taku po vetëm për çështje ditore,
6 naj diçka të naj rëndësie të veçantë s'e besoj. Por, po, jemi
7 taku.

8 PY. Një pyetje të fundit lidhur me Gani Krasniqin. Keni
9 ndonjë dijeni për marrëdhëniet që ka pasur Gani Krasniqi me të
10 akuzuarit të paktën në atë kohë, pra, në 1998?

11 PË. Jo, s -- bëne edhe një herë pyetjen ta marr saktë se nuk
12 u konceptova mirë, të lutem?

13 PY. Patjetër. Dini ndonjë gjë për marrëdhënien që mund të
14 ketë pasur Gani Krasniqi me të akuzuarit në atë kohë, në vitin
15 1998?

16 PË. Përpos raporteve që i ka lidhë lufta, nuk e di që kanë
17 pas diçka tjetër. Nuk mbaj mend.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të doja të
19 shihja dhe një herë paragrafin 24 të Shënimit Përgatitor 2.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

21 Z. HALLING: [Përkthim]

22 PY. Dëshmitar, ju këtu keni thënë që:

23 "Gani Krasniqi ka qenë shok me Ramë Bujën dhe Jakup
24 Krasniqin, sepse përpara luftës kanë qenë të burgosur
25 politikë."

1 A është kështu?

2 PË. Po. Po, kjo, po.

3 PY. Lidhur me dokumentin që kemi diskutuar, ju keni thënë
4 disa herë se është shkruar pas luftës. Dëshmitar, ne kemi
5 informacione që ky dokument është marrë nga autoritetet serbe
6 në Kosovë gjatë luftës. Si ka mundësi atëherë ta kenë
7 sekuestruar gjatë luftës serbët, autoritetet serbe këtë
8 dokument, kur ju thoni se e keni shkruar pas luftës?

9 PË. Unë nuk ngula këmbë me thënë që saktë e kam shkru mbas
10 luftës, po thashë ka të ngjarë se e kam shkru mbas luftës. Me
11 vetë faktin se në shënimet përgatitore pashë disa shënime të
12 cilat mu dukën se i kam bë në kohën kur kemi qenë deputet në
13 komisionin për siguri. Po mund të jetë, mund të jetë, mund të
14 jetë ashtu. Nuk e di. Por një dokument i qitur nga Serbia nuk
15 e di se sa mund t'i besohet për këtë proces gjyqësor që
16 s'është i kamufluar apo i deformuar. Nuk e di.

17 PY. Që ta kemi absolutisht të qartë, kur flisni që keni qenë
18 deputet në komisionin për siguri, ky ka qenë një pozicion që
19 keni pasur pas përfundimit të luftës?

20 PË. Po. Po, po.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Mund të hiqet dokumenti nga
22 ekrani.

23 Z. DIXON: [Përkthim] A mund të japin një referencë për
24 këtë pretendim që sapo u tha, që ky dokument është marrë nga
25 forcat serbe gjatë luftës? Do na shërbejë ne për kundërpjetet

1 tona.

2 Z. HALLING: [Përkthim] E kam thënë për procesverbal këtë
3 gjë në faqen 14166 të transkriptit më 2 prill 2024. Dokumenti
4 që kemi përdorur ne si bazë është dokumenti me numër 111957
5 deri në 111966 dhe mbase faqja më e dobishme për ju është
6 faqja që mban numrin 111957. Kur të shihni faqen, këtë faqe që
7 sapo përmenda, do shihni se përmendet edhe faqja që përdora
8 unë aktualisht si bazë për pyetjen time.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

11 Ju lutem të vendosni në ekran provën materiale me numër
12 P227 në anglisht dhe në shqip.

13 PY. Dëshmitar, do t'ju pyes shkurtimisht lidhur me
14 Marrëveshjen e Rambujesë që nënshkroi UÇK-ja. Keni marrë pjesë
15 ju në nënshkrimin e këtij dokumenti?

16 PË. Po.

17 PY. A është dokumenti në ekran?

18 PË. Po.

19 PY. Sylejman Selimi a e ka nënshkruar këtë dokument?

20 PË. Nuk po e shoh që e ka nënshkru. Nuk e di. Ka disa
21 nënshkrime këtu, po nuk di a janë të Sulejman Selimit apo jo.
22 Ato çka kam mujt me dëshifru, i kam dëshifru në takimin që kemi
23 pas përgatitor. Nënshkrime të tjerë nuk më kujtohen, nuk po i
24 njoh.

25 PY. Ju nuk e përmendët, po le ta marrim hap pas hapi. Ju

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 26

1 lutem me ndihmën e Asistentes së Gjykatës do shënoni me numër
2 përbri secilit nënshkrim. Për shembull, 1, 2, 3, 4, 5 deri tek
3 12 dhe në bazë të numrave që do shënoni ju, unë do ju pyes për
4 secilën nga nënshkrimet.

5 DËSHMITARI: Po.

6 Z. HALLING: [Përkthim]

7 PY. Se i bëna të dy nënshkrimet, më fal. Këto bëjnë pjesë në
8 tjetër vend.

9 PY. Vendosi secilit nënshkrim një numër përbri nënshkrimit 1,
10 2, 3, 4 deri te 12. Përbri secilit nënshkrim vendosni një
11 numër, ju lutem.

12 PË. [Shënon]

13 PY. Faleminderit. Atëherë kujt i përket nënshkrimi numër 1?

14 PË. Me aq sa ka muj me identifiku është nënshkrim -- është
15 emri i Hashim Thaçit, jo nënshkrimi, emri. S'e di a nënshkrim
16 a jo.

17 PY. Po numri 2?

18 PË. Nuk po e njoh.

19 PY. Numri 3?

20 PË. Nuk po e njoh.

21 PË. Numri 4?

22 PË. Këtë është i nënshkru si Daja.

23 PY. Kush është Daja në faqe?

24 PË. Po Daja në faqe duhet të jetë Azem Syla.

25 PY. Numri 5?

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 27

- 1 PË. Jakup Krasniqi.
- 2 PY. Do të jap një të thjesht tani. Kush është numri 6?
- 3 PË. Numri 6 jam unë.
- 4 PY. 7?
- 5 PË. Ramë Buja.
- 6 PY. 8?
- 7 PË. Këtu është Remi, R Mustafa, që duhet të jetë Rustem
- 8 Mustafa.
- 9 PY. Numri 9?
- 10 PË. Kadri Veseli.
- 11 PY. 10?
- 12 PË. Nuk po e njoh.
- 13 PY. 11?
- 14 PË. Fatmir Limaj.
- 15 PY. Dhe në fund 12?
- 16 PË. Nuk po e njoh. Nuk e njoh.
- 17 PY. Faleminderit, Dëshmitar.
- 18 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do dëshironim
- 19 që të pranohej edhe kjo faqe me shënimet përkatëse si provë
- 20 gjyqësore dhe t'i jepet numri përkatës dhe në qoftë se është e
- 21 mundur të bashkëngjitet provës P227.
- 22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
- 23 Z. HALLING: [Përkthim] Është faqja SPOE00228796. Është
- 24 vetëm një faqe.
- 25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 28

1 kundërshtime?

2 Nuk shoh të ketë kundërshtime. Dhe dokumenti pranohet dhe
3 do të marri numrin përkatës.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Njësoj si me provën e
5 mëparshme, kjo provë do të marrë numrin 227.1. Ju lutem dhe
6 klasifikimin?

7 Z. HALLING: [Përkthim] Mund të jetë dokument publik.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

9 Riklasifikojeni si dokument publik.

10 Z. HALLING: [Përkthim]

11 PY. Dëshmitar, na kanë ngelur shumë pak minuta përpara
12 pushimit, por do të filloj me temën e radhës. Kam disa pyetje
13 lidhur me rolin që keni pasur ju me ndërkombëtarët gjatë
14 luftës.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Do të doja që të vendosej në ekran
16 materiali me numër 099786-099788 në shqip dhe në anglisht dhe
17 fillojmë me faqen e parë.

18 PY. Dëshmitar, këtë dokument e pamë gjatë seancës
19 përgatitore. A është kjo një intervistë që i keni dhënë
20 Kosovës së Lirë?

21 PË. Po.

22 PY. Kur e rilexuat, a evidentuat ndonjë gjë të pasaktë në
23 këtë intervistë?

24 PË. Përpos disa glorifikimeve që i kam potencu, intervista
25 është e imja, domethënë, është e saktë.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Shkojmë në faqen 009788.

2 PY. Ju thoni, është janari i 1999:

3 "... Shtabi i Përgjithshëm është në dijeni dhe mban
4 kontakte të vazhdueshme me delegacione diplomatike në nivelet
5 më të larta botërore."

6 A është e vërtetë? A ka vepruar vërtetë kështu Shtabi i
7 Përgjithshëm në këtë kohë?

8 PË. Po takime kemi pas të vazhdueshme me përfaqësues
9 ndërkombëtarë të cilët kanë ardh në Kosovë. Po me nivele ma të
10 nalta botërore, kjo është, janë nga ato glorifikimet që
11 ndoshta është bë.

12 PY. Ju kuptoj. Në intervista si kjo në ekran a kujdeseshit ju
13 të mos thoni asgjë që mund të dëmtonte marrëdhënien tuaj me
14 ndërkombëtarët, pra, ishit të kujdesshëm në këtë aspekt?

15 PË. Patjetër, se jemi munduar që të mos dëmtonim asnjë nga
16 ato raportet të cilat ishin krijuar.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ky është një
18 dokument me tri faqe. Kërkojmë që të pranohet si pjesë e
19 provave gjyqësore.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
21 kundërshtime?

22 Nuk shoh të ketë kundërshtime. Atëherë dokumenti me numër
23 099786-099788 në anglisht dhe në shqip pranohet.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
25 numrin e provës P01882. Dhe do të doja të dija klasifikimin?

1 Z. HALLING: [Përkthim] Mund të jetë dokument publik.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

3 Riklasifikohet si dokument publik.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Po shoh edhe orën, në qoftë se
5 dëshironi mund të bëjmë pushimin tani.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

7 [Përkthim] Do bëjmë dhjetë minuta pushim. Vetëm dhjetë
8 minuta dhe do të vazhdojmë me pyetjet. Ju lutem mos flisni me
9 askënd për dëshminë jashtë sallës së gjyqit, mund të dilni
10 tani nga salla.

11 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë dhjetë
13 minuta pushim.

14 --- Seanca ndërpritet në orën 10.01

15 --- Seanca rifillon në orën 10.10

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

17 Sekretare, mund ta sillni dëshmitarin në sallë.

18 [Dëshmitari vijon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të

20 vazhdoni, Prokuror.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

22 PY. Dëshmitar, të qëndrojmë tek tema e komunikimeve me
23 ndërkombëtarët. Kush ka qenë pika e kontaktit nga UÇK-ja për
24 sa i takon komunikimit me ndërkombëtarët, e kam fjalën
25 përgjatë luftës?

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 31

1 PË. Po një prej të tjerëve kam qenë unë. Dhe besoj, se nuk e
2 di a kanë qenë kontaktet e para me -- kur ka mbërrri KDOM-i
3 amerikan në Kosovë dhe OSBE-ja. Por kanë pas kontakte edhe z.
4 Thaçi, kryesisht me diplomatë të huaj dhe Jakup Krasniqi e
5 Ramë Buja në takimet e ndryshme që i kemi pas të përbashkëta
6 për tema të caktuara.

7 PY. Po Sokol Dobruna a ka qenë ndonjëherë i përfshirë si pikë
8 kontakti për diskutime të tilla?

9 PË. Nuk e di. S'e besoj.

10 PY. Na përshkruani kontaktet dhe marrëdhëniet tuaja në
11 veçanti me Shaun Byrnes gjatë luftës.

12 PË. Fillimisht e kam takuar një zëvendësin e tij Mike Dean
13 dhe pastaj ai ka aranxhuar një takim. Mbasi ja kemi -- ka
14 kërku një shtëpi ku të vendoset KDOM-i amerikan si pikë e
15 takimeve. Atë shtëpi ia kam siguruar unë në Dragobil. Dhe mbas
16 një periudhe ka ardh Shaun Byrnes në takimin e parë me ta që e
17 kemi pas në Dragobil. Dhe kemi vazhduar pastaj takimet e
18 rregullta me të. Janë mbi dhjetëra takime, të cilat shumica
19 prej tyre nuk janë bë publike për opinion. Por që kemi pas
20 takime të shpeshta për tema të ndryshme. Ka qenë një raport
21 shumë korrekt me të.

22 PY. A keni qenë një person kontakti i besuar i z. Byrnes, ju,
23 Dëshmitar?

24 PË. Besoj, po. Besoj.

25 PY. Kur kishte çështje që kërkonin kontributin e UÇK-së, a

1 ishiti ju një ndër personat e parë me të cilët kontaktonte

2 Shaun Byrnes?

3 PË. Mendoj që njeriun e parë që e ka kontakti kam qenë unë.

4 PY. A mund të përmendni emrat e ndërkombëtarëve të tjerë

5 përveç Mike Dean dhe Shaun Byrnes që sapo e përmendët me të

6 cilët keni biseduar në mënyrë të vazhdueshme gjatë luftës?

7 PË. Me disa kemi pas si me z. ambasadorin Hill, me z.

8 Petritsch, takime vetëm për çështje të caktuara. Ndërsa me

9 Walker kemi qenë pothuajse njëjtë si me Shaun Byrnes. Pastaj

10 me David Meyer, një anglez i cili ka qenë në stafin e Walker,

11 Mike Dean, Ron Kepps dhe ky ka qenë një prej stafit të KDOM-it

12 amerikan dhe këto takime kanë vazhdu shumë të shpeshta.

13 PY. Kur flisni për Walker në përgjigjen e fundit që dhatë e

14 keni fjalën për William Walker, Dëshmitar?

15 PË. Po, William Walker, po. Shefi i OSBE-së në Kosovë, më

16 vonë i KVM-it.

17 PY. Kur ndërkombëtarët ju kërkonin informacion për raste ose

18 incidente të caktuara, ju çfarë bënit për të mbledhur

19 informacion dhe për të gjetur, për të konstatuar se çfarë po

20 ndodhte, çfarë bënit ju?

21 PË. Po ato jam mundu me i adresu edhe tek të tjerët.

22 PY. Çfarë do të thotë kjo që "jeni mundu që t'i adresoni,

23 t'ia dërgoni të tjerëve"?

24 PË. Mbi bazën e natyrës të porosive që kanë dhënë. Për

25 shembull, kur kemi pas rastet për çështjet politike jemi ul si

1 drejtori politike në atëkohë. Për çështjen këmbimit të
2 ushtarëve, po ashtu jemi ul ne si drejtori politike. Për
3 çështje të dokumentit, po ashtu dokumentit të Hill kemi pas
4 disa takime me të, e jemi takuar së bashku dhe me si drejtori
5 politike.

6 PY. Kur çështje të caktuara janë sjellë në vëmendjen tuaj, ju
7 vetë a keni bërë përpjekje për të mbledhur më shumë
8 informacion lidhur me atë çfarë po ndodhte realisht?

9 PË. Për aq sa kam pas mundësi, po.

10 PY. A përfshinte kjo edhe takimet ose ndjekjen e situatës me
11 anëtarë të UÇK-së, përfshirë këtu edhe me Shtabin e
12 Përgjithshëm dhe drejtorinë politike?

13 PË. Po.

14 PY. Tani do kalojmë tek disa tema konkrete të cilat janë
15 ngritur me ndërkombëtarët gjatë luftës. Do fillojmë me lirimin
16 e Cen Deskut dhe Jakup Kasttratit, si dhe të dy gazetarëve
17 serbë. Kështu që së pari do ju kërkoja që të përshkruanit
18 përfshirjen tuaj ose sa dijeni, çfarë njohurish keni ju
19 lidhur me lirimin e këtyre personave, Dëshmitar?

20 PË. Fillimisht e kam thënë dhe në takimin që kemi pas
21 përgatitor, privimi nga liria e Cen Deskut për mu ka qenë më
22 tepër se skandaloz. Për vetë faktin se Cen Deskun e kam njohur
23 personalisht si një burrë patriot, si një njeri humanist, i
24 cili ka dhënë një kontribut të çmueshëm në përpjekjet e
25 shqiptarëve të viteve të 1990.

1 Krejt atë çka di e për përfshirjen time në dorëzimin e
2 tyre tek Walker dhe Shaun Byrnes është se një ditë para se me
3 ndodhë kjo ngjarje, dikun më 26 nëntor ka ardh shoferi i --
4 shoferi apo një përfaqësues i zyrës së Demaçit, i cili e
5 shoqëronte herë pas here Demaçin kur vinte në zonat e UÇK-së.
6 Dhe ma ka pru një letër ku tha kështu-kështu do të bëhet
7 ndërrimi, do të bëhet dorëzimi, tha, i dy gazetarëve serbë dhe
8 i dy aktivistëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe këtë
9 letër, tha, për nder të datës 28 nëntor, si datë historike e
10 popullit shqiptar, si dita e pavarësisë së Shqipërisë me e bë
11 një -- në mënyrë humanitare, po i dorëzojmë, me i dorëzu këta.
12 Atë letër e kam marrë. E kam qit në një fletore timen për me e
13 lexu.

14 Ndërkohë, s'e di atë ditë apo të nesërmen më ka thirr
15 edhe Shaun Byrnes dhe më ka dhënë të njëjtën. Të njëjtën.
16 Madje Shaun Byrnes nga unë kërkoj apo bëni një si kërkesë.
17 Tha, kanë me ardh dy gazetarët e Tanjugut apo dy gazetarë
18 serbë, s'më kujtohet saktë, të cilët kanë me përcjellë
19 ngjarjen e ndërrimit të këtyre, dorëzimit të këtyre gazetarëve
20 dhe që janë marrë më herët. "A ka ndonjë problem nëse vijnë në
21 mesin e shumë mediave të tjera?" Dhe unë i kam thënë
22 "Personalisht për mu nuk ka, nuk ka asnjë problem dhe besoj se
23 s'ka me pas asnjë problem edhe ardhja e tyre. Pse vijnë mediat
24 botnore të ndryshme aty, le të vijnë dhe ata". Kështu që kanë
25 qenë prezent. Kjo është për herë të parë që po e bëj publike

1 këtë. Dhe kanë ardhë, më duket, kanë incizu fjalimet tona dhe
2 deklarinimet e dy gazetarëve, kolegëve të tyre serbë në këtë
3 këmbim.

4 Kjo ka qenë krejt puna ime që kam bërë unë në këtë takim.
5 PY. Atëherë të flasim me raportim e "fjalimeve", dua t'ju
6 pyes që ky fjalimi juaj a ka qenë, është filmuar, është
7 regjistruar?

8 PË. Po.

9 PY. Në rregull.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë në këtë pikë nuk ia vlen
11 që të vazhdojmë me videon.

12 PY. Të vazhdojmë me temën e radhës që ka të bëjë me
13 ndërkombëtarët. Ju keni folur për dokumentet e Hillit, sapo i
14 përmende përpara një çasti. Ky dokumenti i Hillit kur i është
15 dërguar për herë të parë Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-,
16 Dëshmitar?

17 PË. Nuk e kujtoj dhe as momentin kur, por kanë ardhë dikund
18 rreth tre dje të tilla, të ndryshme njëri prej tjetrit. Ne i
19 kemi diskutu me z. Krasniqi dhe me Ramë Bujën që ishte në ato
20 takime, për formën dhe modalitetin dhe propozimet që i kemi bërë
21 ne, duke i kundërshtu si dokumente të cilat nuk ishin dhe aq
22 të favorshme ndoshta për ambiciet që kishim ne në atë kohë. Po
23 e di që kanë qenë dy-tre takime rreth dokumenteve të Hillit.

24 PY. Cilat ishin ose çfarë dokumentesh ishin jo të favorshme
25 për ambiciet që ju keni pasur në atë kohë?

1 PË. Po në atë kohë nuk garantohej pavarësia, sipas
2 dokumenteve, pavarësia e Kosovës, nuk garantohej largimi i
3 forcave serbe prej, kujtojt, prej Kosovës. Dokumente të tilla
4 kështu. Po tash nuk i mbaj mend se kanë kalu ca vite dhe këto
5 detale s'më ka ra rasti të përsëritna më vonë.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Do i lutesha Sekretares së seancës
7 të paraqesë në ekran tani dokumentin P068.

8 PY. Atëherë ky është një dokument i cili është vetëm versioni
9 në anglisht i disponueshëm, Dëshmitar, po do ju lexoj faqen
10 konkrete që është 11696. Ndërkohë që paraqitet dokumenti, dua
11 t'ju pyes në qoftë se ka pasur ndonjë propozim nga z. Hill dhe
12 ndërkombëtarët e tjerë për të pasur polici lokale në Kosovë?

13 PË. Po e bëtë pyetjen, më fal?

14 PY. Po. Do që ta përsëris apo mund t'i përgjigjeni?

15 PË. Po.

16 PY. A ka pasur një propozim nga z. Hill dhe ndërkombëtarët që
17 të krijohej një polici lokale në Kosovë?

18 PË. Besoj që po. Besoj që po. Ka pas, po saktë nuk -- po di
19 që është fol për -- kontestuese ka qenë numri i policëve që u
20 diskutu në atë takim.

21 PY. Po, në fakt, kjo lidhet me atë çfarë do t'ju lexojmë.
22 Flitet për një telegram që mban datën 2 dhjetor të vitit 1999
23 që pasqyron bisedën që ju keni pasur më datë 27 dhjetor - 27
24 nëntor - më falni. Do ju lexoj pjesën përkatëse, ju mund të na
25 ndiqni përmes përkthimit. Është në paragrafin 15 në fund fare

1 të faqes:

2 "Bashota vëren që ka dëgjuar që LDK-ja ka punuar me
3 policinë në Podujevë por pa u konsultuar me UÇK-në dhe pyeti
4 nëse KDOM-i kishte informacion lidhur me këtë."

5 Dhe më pas, thua që:

6 "Në një periudhë të shkurtër, ai tha që UÇK-ja mund të
7 trajtonte funksionin e policisë. Policia e UÇK-së ka fjalën e
8 fundit, megjithatë ai nuk përjashtonte LDK-në, pra, nuk
9 përjashtonte anëtarët e LDK-së. Dhe policia nuk do të lidhej
10 me asnjë parti politike dhe nuk do të vepronte kundër
11 pakicave. Byrnes u përgjigj që çështja e policisë duhet të
12 trajtohej dhe që ne duam të shohim që të krijohet një forcë
13 policie profesionale, jo një forcë policie të varur as nga
14 UÇK-ja, as nga LDK-ja. Bashota më pas vërejti që Shtabi i
15 Përgjithshëm i UÇK-së kishte studiuar me kujdes propozimin e
16 Hill për sa i takon çështjes së policisë dhe kishte arritur në
17 përfundimin që numri i propozuar i policisë ishte shumë i
18 vogël, 2500."

19 A ju kujtohet të keni pasur një diskutim të tillë me
20 Hillin, Dëshmitar?

21 PË. Po, po. Kjo është.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Tani le të kalojmë në paragrafin
23 16, besoj që fillon në fund të kësaj faqeje. Atëherë të
24 vazhdojmë tek faqja tjetër më mirë. Këtu në këtë paragraf
25 thuhet që flitet për komente sa i takon çështjes së policisë

1 dhe thotë paragrafi si më poshtë:

2 "Më përpara tre javësh, UÇK-ja kishte kundërshtuar
3 konceptin e një force policore lokale të re të Kosovës që do
4 të pasqyronte baraspeshën etnike të provincës. Përfaqësues të
5 lartë të UÇK-së kishin komentuar që 'kishte vetëm një forcë
6 policore të Kosovës dhe kjo ishte policia e UÇK-së'. Ata
7 kishin shtuar që çdo anëtar i ri shqiptar i forcës së re
8 policore do të konsiderohej në 'polic serb'."

9 Dhe ju thoni që:

10 "Komentet e 27 nëntorit sugjeronin që UÇK-ja të paktën
11 përgatitej, kishte përgatitur procesverbal të diskutuar për
12 formimin e një force të re policore në Kosovë. Në përgjigje të
13 pyetjes", ju thoni pra, "Bashota thotë që komentet e tij
14 pasqyronin pikëpamjet e Shtabit të Përgjithshëm."

15 Pyetja që kam për ju, Dëshmitar, është që a ju kujtohet
16 ky ndryshim qëndrimi lidhur me formimin e forcës së re
17 policore nga ana e UÇK-së?

18 PË. Jo, jo nuk ka pas ndryshim qëndrimi për arsye se ne i
19 kemi qenë shumë të vetëdijsëm se policia ardhshme e Kosovës
20 duhet t'i tejkalojë përmasat politike të cilat ishin atëherë
21 të organizuara në Kosovë. Por që ka qenë një kërkesë e jona që
22 numri i anëtarëve të këtyre policëve të jetë më shumë nga
23 radhët e ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për
24 arsye se flitej, flitej për demilitarizim të Ushtrisë
25 Çlirimtare të Kosovës dhe ne realisht kërkonim që në këtë

1 polici të përfshiheshin sa më shumë ushtarë të Ushtrisë
2 Çlirimtare të Kosovës. S'ka pas ndryshim, ndryshim qëndrimi
3 jonë, s'ka pas qëndrime tjera, me aq sa mbaj mend gjithmonë.
4 PY. Pra, nuk kishte shqetësime nga anëtarë të lartë të UÇK-së
5 që forca policore e re do ishte vetëm policia e UÇK-së, nuk ka
6 pasur asnjë qëndrim të tillë?

7 PË. S'e di. Nuk e di. Nuk e di nëse kemi kërku me qenë veç
8 UÇK-ja.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Tani të shohim provën P168, le ta
10 paraqesim në shqip dhe në anglisht. Bëhet fjalë vetëm për një
11 faqe. Në qoftë se dëshironi mund të jap edhe numrin SPOE të
12 dokumentit, pra, është dokumenti me numër ERN SPOE0019160.

13 PY. Dëshmitar, në ekran shikoni një dokument që thuhet që
14 është nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, mban datën 2 dhjetor
15 1998, që është e njëjta datë si informacioni kabllor që unë ju
16 lexova pak më përpara. Atëherë bëhet fjalë për një urdhëresë
17 ku thuhet që:

18 "Urdhërohen komandat e ZO-së të Ushtrisë Çlirimtare të
19 Kosovës që të urdhërojnë forcat e rendit të UÇK-së që t'i
20 arrestojnë ata qytetarë, që duke treguar lojalitet ndaj
21 pushtuesit, janë uniformuar në polici serbe, me çka kanë bërë
22 vepër të tradhtisë së popullit shqiptar.

23 "Njësoj do të veprohet dhe në të ardhmen për çdo qytetar
24 që implikohet në çfarëdo policie jashtë formacionit të UÇK-së
25 para se të zgjidhet statusi politik i Kosovës."

1 Dëshmitar, a ishte e vërtetë e shqetësuar UÇK-ja vetëm me
2 numrin e policëve në forcën policore në bisedat e bëra me
3 ndërkombëtarët?

4 PË. Nuk është -- unë nuk e kam pa këtë dokument, por s'e
5 besoj që i adresohet atyre numrit të policëve për të cilën
6 kemi kërkuar na në dokumentin e Hill. Këtu më tepër po më
7 duket për ato forca të policisë lokale që Serbia, Serbia i pat
8 veshur në periudhën e luftës. Qytetarë shqiptarë kanë pranuar
9 uniformën e policisë serbe, armatimet dhe në disa raste kanë
10 qenë edhe kundër, kundër vetë neve. Po s'është kjo, nuk i
11 takon kjo asaj policie për të cilën kemi fol me Hill.

12 PY. Të përqendrohemi në veçanti tek fjalia e fundit ku thuhet
13 që:

14 "Njësoj do të veprohet dhe në të ardhmen për çdo qytetar
15 që implikohet në çfarëdo policie jashtë formacionit të UÇK-
16 së".

17 A mund të na shpjegoni se pse Shtabi i Përgjithshëm do të
18 lëshonte një urdhëresë të tillë pas një jave pas bisedës që
19 keni pasur me Shaun Byrnes?

20 PË. Nuk e besoj që ndërlidhet kjo absolut me dokumentin e
21 Hillit, absolut. Fjala është për polici të ngjashme ose
22 formacione të ngjashme që i bën ushtria dhe policia serbe. Po
23 jo që bëhen me marrëveshje e dalun nga dokumenti i Hillit. Gjë
24 që realisht ai dokument nuk është miratu, nuk është aprovu në
25 Kosovë për arsye se në bazë të kundërshtimeve tona që i kemi

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 41

1 bë dokumentit të Hillit, ka pas pastaj edhe Konferenca e
2 Rambujesë. Por nuk besoj që mund të ndërlihet kjo. Unë atë
3 nuk e kam pa këtë dokument kurrë.

4 PY. Dëshmitar, a keni qenë në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-
5 së më 2 dhjetor 1998?

6 PË. Anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, po. Kujtoj, po. Po, po.

7 PY. Po ju thatë që nuk e keni parë asnjëherë këtë dokument.

8 Po ndonjë urdhëresë tjetër që sqaron ose korrigjon qëndrimin e
9 UÇK-së sa i takon policisë lokale a keni parë, Dëshmitar?

10 PË. Për polici lokale e cila është propozuar në dokumentin e
11 Hillit, absolut nuk ka pas mundësi me u bë për arsye se
12 realisht ajo nuk është implementu në Kosovë kurrë. Është bë
13 mbas luftës si rezultat i marrëveshjes pastaj së Rambujesë,
14 por jo, jo gjatë luftës. Këtu është fjala për ata policë të
15 cilët, ata shqiptarë të cilët Serbia i ka uniformu dhe i ka
16 kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe ata janë kanë
17 njëjtë kanë -- ky është ai -- janë kanë në aparatin zinxhiror
18 të policisë dhe ushtrisë serbe. Unë dokumente tjera s'e besoj
19 që kam pa.

20 PY. Faleminderit.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Mund ta hiqni dokumentin nga
22 ekрани, Sekretare.

23 PY. Dëshmitar, kam përshtypjen, që përpara pushimit, ju
24 përmendët diçka që kishte të bënte me një lloj shkëmbimi të
25 burgosurish serbë. A ka pasur ndonjë shkëmbim të burgosurish

1 serbë me të burgosur shqiptarë në fillim të vitit 1999?

2 PË. Ka pas shkëmbime se të ndaluarve serbë të cilët kanë hy
3 në zonën, në zonat e kontrolluara nga Ushtria Çlirimtare e
4 Kosovës me disa të burgosur shqiptarë të cilët janë arrestuar.
5 Në fund, kujtoj, në fund të vitit 1998 ku në mesin e atyre
6 ushtarëve ka rënë edhe komandanti i ynë Mujë Krasniqi. Kanë
7 qenë 9 persona të arrestuar. Në mesin e tyre ka qenë edhe një
8 vajzë. Dhe këta pastaj janë këmbj.

9 PY. A e kuptova saktë që kjo ka qenë pala e të burgosurve
10 shqiptarë, për këta folët?

11 PË. Të burgosurit shqiptarë që janë marrë në burgjet e
12 Serbisë.

13 PY. Si i kapi UÇK-ja të burgosurit serbë që u bënë më pas
14 objekt i këtij shkëmbimi, si u kapën këta prej UÇK-së?

15 PË. Nuk e kam ndonjë ide të kjartë për këtë, por e di që
16 komandanti i zonës, Rrahman Rama, ka spjegu se kanë hy në
17 territorin e UÇK-së. Dhe për formën sesi nuk e di. Ne jemi
18 marrë pastaj vetëm me procedurat dhe format sesi duhet të ju
19 dorëzohen familjeve të tyre këta persona. Gjithmonë me
20 ndërhyrjen e ndërkombëtarëve të cilët ishin prezent në Kosovë.

21 PY. Kur thoni "ne" e keni fjalën për drejtorinë politike të
22 Shtabit të Përgjithshëm?

23 PË. Po. Kryesisht unë, Jakupi dhe Ramë Buja kemi qenë të
24 involvuar në këtë proces.

25 PY. Na shpjegoni diçka më shumë lidhur me vështirësitë që

1 keni ndeshur ju nga ana juaj gjatë këtyre negociatave.

2 PË. Po kemi pas vështirësi të natyrave të ndryshme. Për arsye
3 se, më së pari, Serbia nuk pranonte që ushtarët tanë të cilët
4 ishin zënë në kufirin me Shqipërinë, nuk dëshironte me i liru.
5 Dhe në takimet e shpeshta që i kemi pas me Shaun Byrnes, me
6 Walker, unë e pata bë dhe një tentativë që nëse Serbia nuk
7 dëshiron me i liru ushtarët shqiptarë, atëherë le të lirojë
8 disa persona të cilët ishin në burgjet e Serbisë, të cilët
9 ishin civilë.

10 Dhe ja kam dhënë një listë, po gjithmonë duke i vu
11 theksin mbi rëndësinë e tyre personave që kishin për neve. Dhe
12 e kam porosit Shaun Byrnes që të ketë kujdes me emrat e tyre
13 për arsye se mundet Serbia me i kuptu se këta janë njerëz pro
14 UÇK-së dhe mundet me ndodhë ndonjë ekzekutim i tyre nga forcat
15 serbe. Në mesin e atyre që kemi kërkuar ka qenë Ukshin Hoti.
16 Ka qenë Nait Hasani. Ka qenë - unë që e kam dhënë listën -
17 Bislam Zogaj. E kujtoj ka qenë dhe një Zogaj tjetër. Kanë qenë
18 disa, nja shtatë-tetë emra. Tani s'më kujtohet. Xhavit Haziri
19 më duket. Edhe një Shala. Këta janë emrat që i kam dhënë unë.
20 Por Shaun mbas një kohe më ka ardh dhe më ka thënë se "Këta
21 Serbia nuk pranon me i liru".

22 Më vonë, ne kemi hy në negociata, kemi pas disa takime së
23 bashku me bacën Jakup dhe Ramë Bujën edhe kemi arrit deri tek
24 një marrëveshje të cilën realisht me përgjegjësi të madhe,
25 madje kemi deklaruar se në qoftë se nuk lejohemi, se u marrëm

1 vesh mbas dhjetë dite me u liru, me u liru shqiptarët. Dhe të
2 gjithë ushtarët e UÇK-së në atë kohë, po dhe qytetarët, kanë
3 menduar që kjo është një bluf që bën ushtria dhe policia e
4 Serbisë dhe s'kanë me i liru. Kështu që ne u dakorduar që nëse
5 nuk del fjala e ndërkombëtarëve në këtë rast, të cilët u
6 zotuan në Likovc, na me dhënë dorëheqje prej Shtabit të
7 Përgjithshëm dhe drejtorisë politike. Por kjo marrëveshje mbas
8 dhjetë dite, njëjtë sikurse siç është shkru, është ralizu.

9 Por me ndërkombëtarët zakonisht kemi pas këto
10 mospërputhje rreth datës, por që më në fund është arrit, është
11 arrit me zotimin dhe me garancat që i kanë dhanë Hill,
12 Petritsch, kujtoj, ka qenë dhe Petritsch aty, Walker dhe Shaun
13 Byrnes, kemi pranë që ata të lëshohen, të dorëzohen në
14 familjet e tyre. Dhe mbas dhjetë ditësh pastaj i kanë kthy
15 ushtarët tanë.

16 PY. E keni fjalën për vendimin për lirimin e tyre, pra, ky
17 vendim është vendim që është marrë nga drejtoria politike?

18 PË. Po.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Kjo është sugjestionuese.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E pranojmë.
21 Ishte në fakt pyetje sugjestionuese.

22 Z. HALLING: [Përkthim]

23 PY. Dëshmitar, kush vendosi t'i lironte ushtarët?

24 PË. Ne, domethënë, me ndërhyrjen, me ndërhyrjen e
25 ndërkombëtarëve, me ndërhyrjen e ndërkombëtarëve, ata veç

1 vetëm janë shkëmby. Thjesht ka qenë një vullnet edhe i zonës,
2 po pastaj edhe i yni. Ne jemi marrë vetëm me procedurat për
3 ndërrimin, për ndërrimin me ushtarë shqiptarë. A vullneti ka
4 qenë i zonës për lirimin e tyre. Thjesht ne kemi përfitu këtu
5 me lirim informacioni e nëntë kolegëve tanë.

6 PY. Kur ju pyeta kush vendosi t'i lironte ushtarët dhe ju
7 thatë "ne, me ndërhyrjen e ndërkombëtarëve kryem këtë
8 shkëmbim".

9 PË. Po.

10 PY. Me përemrin "ne" për cilin e keni fjalën?

11 PË. Unë, Jakupi dhe Ramë Buja.

12 PY. Faleminderit. Kjo është e qartë tani. Një pyetje të
13 fundit për këtë -- më falni. Ta bëj dhe një herë pyetjen.

14 Serbët që u liruan, këta ishin ata ushtarët serbë që kishte
15 kapur Rrahman Rama?

16 PË. Po.

17 PY. Faleminderit.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për pyetjet e
19 radhës do kërkoja të kalonim në seancë private.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

21 Z. HALLING: [Përkthim] Për t'u mbrojtur disa nga
22 dokumentet që do t'i shfaqim dëshmitarit sepse mund t'i
23 shfaqim vetëm në seancë private.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në
25 seancë private.

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 46

1 [Seancë private]

2 [Seancë private teksti i fshirë]

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 47

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 48

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 49

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 50

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 51

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 52

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19 [Seancë e hapur]

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pushim

22 deri në orën 11.30.

23 --- Pauza fillon në orën 11.01

24 --- Seanca rifillon në orën 11.30

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 54

1 Sekretare, ju lutem mund ta sillni dëshmitarin në sallë.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, sa për t'ju
3 përditësuar lidhur me kohën, unë do përfundoj në gjysmën e
4 parë të kësaj seance me pyetjet e mia për dëshmitarin.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

6 Për të qenë të qartë, rendin do ta merrni si përherë,
7 sipas radhës së zakonshme? Në rregull.

8 Të kalojmë përsëri në seancë private?

9 Z. HALLING: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të kalojmë
11 në seancë private.

12 [Seancë private]

13 [Seancë private teksti i fshirë]

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 55

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 56

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 57

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 58

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 59

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 60

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 61

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11 [Seancë e hapur]

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
13 jemi në seancë publike.

14 Z. HALLING: [Përkthim]

15 PY. Dëshmitar, gjatë pyetjeve të bëra dhe gjatë seancës
16 përgatitore ju keni theksuar në mënyrë të përsëritur kufizimet
17 që kishit sa i takon rolit dhe njohurisë që kishit në UÇK-në.
18 Ka disa deklarata të tjera të anëtarëve të tjerë të Shtabit të
19 Përgjithshëm që flasin lidhur me ju dhe çfarë keni bërë ju
20 gjatë luftës, dhe tani dua t'ju bëj disa pyetje lidhur me
21 gjërat që kanë thënë të tjerët mbi rolin tuaj.

22 Sa i takon pyetjes së parë, do t'jua lexoj, nuk do të
23 kërkoj që të paraqitet dokumenti.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Por për procesverbal është prova
25 P739.4, faqja 19.

1 PY. Dëshmitar, kjo është deklarata që i ka dhënë Hashim Thaçi
2 ZPS-së. Do t'ju lexoj pjesën përkatëse të diçkaje që ka thënë
3 ai, dhe që ju përmend juve. Hashim Thaçi ka thënë:

4 "Po theksoj se prej marsit deri në qershor të 1998, ka
5 qenë kryesisht çështje konsultash në Shtabin e Përgjithshëm.

6 "PY. Pra, vendime në grup?

7 "PË. Edhe po të ishim vetëm ne të dy, për shembull, po
8 të ishin dy prej nesh, për shembull, kryesisht jam takuar me
9 Sokol Bashotën deri në emërimin e zëdhënësit të Shtabit të
10 Përgjithshëm, me Jakup Krasniqin. I kam thënë që Azem Syla
11 propozoi që të bëhej komandant i përgjithshëm. Ishte një
12 bisedë e lirë, një konsultim.

13 "Pra, zëvendëskomandanti ishte Sokol Bashota. Të tjerët
14 kishin përgjegjësi të barabarta.

15 Pra, ju flisni lidhur me rolin e zëvendëskomandantit në
16 librin e Jakup Krasniqit, edhe thoni që ky rol ka qenë vetëm
17 në letër. Ndërkohë që Hashim Thaçi ju përshkruan juve në këtë
18 rol që prej marsit deri në qershor të 1998. A mund të na
19 shpjegoni se pse Hashim Thaçi mendon këtë gjë?

20 PË. Pse e ka thanë këtë, unë nuk e di, por nuk është e
21 vërtetë që kam qenë nga marsi. Realisht diskutimet e para për
22 organizimin e UÇK-së janë bo pikërisht në një shtëpi, në
23 fshatin e lindjes së Jakup Krasniqit në Negroc, ajo që është
24 në qershor, dhe aty është bisedu për herë të parë për
25 pozicionet e, me të cilat u përmendën më herët, për qato të

1 gjitha kanë mbetur vetëm në letër. Thashë nuk kemi mujt me
2 ushtru funksionin. Ju e dini mjaft mirë se me momentin e parë
3 kur unë kam bo publike, kur është bo publike pozicioni im si
4 zëvendëskomandant dhe Azem Sylës si komandant i Shtabit të
5 Përgjithshëm të UÇK-së, komandantët e zonave kanë, janë rebelu
6 dhe e kanë lëshu mbledhjen.

7 PY. Ju flisni për Azem Sylën, dhe gjatë përgjigjes së fundit
8 e përmendët Azem Sylën, por ndërkohë do shikojmë tani bashkë
9 se çfarë ka thënë ai lidhur me ju.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Për procesverbal, bëhet fjalë për
11 provën P847, me faqe SITF00243001. Edhe këto pjesë mund ta
12 lexojmë.

13 PY. Azem Sylë ka thënë si më poshtë:

14 "Pas ngjarjeve të janarit të 1997, ne u detyruam që të
15 ndanim detyrat. Zëvendësi im, Sokol Bashota, u vendos në
16 Shtabin e Përgjithshëm dhe kreu të dyja detyrat deri në
17 periudhën midis dy takimeve në Rambuje.

18 Dëshmitar, tani pikësëpari, ngjarjet e janarit të 1997-s,
19 a është kjo periudha kur është arrestuar Nait Hasani dhe është
20 vrarë Zahir Pajaziti, për ta kuptuar më qartë?

21 PË. Po, në 1997.

22 PY. A mund të na shpjegoni që, që prej atij momenti e në
23 vazhdim, në Kosovë, Azem Sylë në Kosovë ka thënë që ju keni
24 kryer detyrat e zëvendëskomandantit? Mund të na e shpjegoni
25 këtë?

1 PË. Jo, nuk është e vërtetë.

2 PY. Dëshmitar, a nuk keni thënë ju përpara një jave se Azem
3 Syla ka qenë autoritet në historinë e UÇK-së?

4 Z. HALLING: [Përkthim] Për procesverbal këtë e keni thënë
5 në faqen 22964 të transkriptit.

6 PY. Por tani po thoni që është, e ka thënë gabim këtë gjë,
7 është i gabuar lidhur me këtë që ka thënë lidhur me ju?

8 PË. Po. Po.

9 PY. Rexhep Selimi ka thënë si më poshtë lidhur me ty.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Për procesverbal është prova
11 gjyqësore P761.7. Dhe në versionin në anglisht është faqja 5.

12 PY. Atëherë, Rexhep Selimi ka thënë si më poshtë për ZPS-në.
13 Kjo ka të bëjë me komunikatat. Rexhep Selimi thotë që:

14 "Që prej fillimit dhe deri në fund personi që është marrë
15 me komunikatat ka qenë një shok i joni, ka qenë Nait Hasani
16 deri kur ai u arrestua në janar të 1997.

17 "PY. Po më pas?

18 "PË. Më kujtohet që ndër peronat që janë marrë me
19 komunikatat gjatë 1997 ka qenë Sokol Bashota."

20 Dëshmitar, Rexhep Selimi nuk po thotë që ju i keni
21 shkruar këto komunikata apo i keni publikuar ato, por thotë që
22 jeni marrë me to gjatë 1997. Çfarë përgjigje keni ju lidhur me
23 këtë?

24 PË. Jo, absolut nuk jam marrë asnjherë me lëshimin e
25 komunikatave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo ka qenë

1 pjesë e -- që Nait Hasani, e kam sqaru edhe në takimet
2 përgatitore, në seancat përgatitore, dhe aty i ka lëshu. Të
3 paktën ka thanë Nait Hasani që, "Unë dhe Xheladin Gashi
4 merremi me këtë çështje". Mund të jetë Xheladin Gashi, por unë
5 nuk kam ndonji informacion të saktë rreth lëshimit të
6 komunikatave për asnjërën.
7 PY. Ju në seancën përgatitore e keni thënë këtë, megjithatë
8 një prej komenteve të fundit që dëshiroj që t'jua parashtroj
9 është ajo çfarë i keni thënë ju TPNJ-së, ish-Tribunalit të
10 Hagës. Kjo jepet në provën P1870.1, në faqen 10. Juve ju bëhet
11 pyetje e mëposhtme nga TPNJ-ja:

12 "Çfarë po bënit ju gjatë kësaj kohe, domethënë, çfarë
13 keni bërë ju gjatë 1997, çfarë lloj detyrash keni kryer? A
14 keni planifikuar konfliktin që do të vinte më pas?

15 Në përgjigje ju thoni:

16 "Ne kemi qenë kryesisht të përfshirë në shkrimin e
17 komunikatave dhe mbledhjen e materialeve ushtarake. Ato
18 materiale janë marrë nga shokët tanë jashtë shtetit sepse ne
19 nuk kishim profesionistë ushtarakë."

20 Në qoftë se ju vërtet nuk kishit asnjë lloj përfshirjeje
21 në këto komunikata, sikurse po thoni tani, pse ju thoni në
22 përgjigje të pyetjes në pjesën e parë të përgjigjes tuaj, ju
23 thoni që kryesisht keni i përfshirë me shkrimin e komunikatave
24 si pjesë e përgjigjes së detyrave që ju kishit në 1997. Pse ka
25 ndodhur kështu?

1 PË. Fjala, fjala -- këtu është fjala për tërësinë e grupit
2 tonë, që e kemi pas. Aty ka qenë edhe Azem Sylja, edhe Xheladin
3 Gashi, si pjesë e atij Shtabi Qendror. Edhe Xhavit Haliti,
4 edhe Ali Ahmeti. Këta kanë qenë si pjesë e Shtabit Qendror dhe
5 fjala është për, ju kam referu për tërësinë e grupit, si grup.
6 Por jo që e kam shkru unë atë. Thashë, asnji komunikatë nuk e
7 kam shkru.

8 PY. Nuk ju pyeta në qoftë se e shkruat apo jo. Unë ju pyeta
9 në qoftë se ke qenë i përfshirë me ta apo jo, sepse kështu i
10 keni thënë TPNJ-së në përgjigje të pyetjes.

11 PË. Unë, ne në atë përgjigje vetëm iu kam referu, iu kam
12 referu atyre që kam pas informacion për kohën, dhe si grup i
13 Shtabit Qendror të asaj kohe që janë lëshuar komunikata, pjesa
14 dërrmuese -- na është thanë që po lëshohen edhe nga jashtë,
15 por unë nuk kam pas informacion dhe nuk kam hulumtu ma shumë
16 rreth gjenezës të atyne komunikatave nëse ato vërtet po bëhen
17 jashtë, a po bohen mbrenda. Kështu që, edhe një herë po e
18 përsëris, nuk kam lëshu ndonji komunikatën unë. Por iu kam
19 referu vetëm grupit si tërësi, si shtab.

20 PY. A nuk është e vërtetë që në ato komunikata ju po e bëni
21 të qartë që nuk do të lejoni asnjë aktivitet, asnjë
22 veprimtari që ishte kundër luftës së UÇK-së?

23 PË. Mund të jetë e shkruar në komunikata, por zakonisht
24 komunikatat kanë qenë ma tepër propagandistike. Kujtoj se sa
25 qenë me të vërtetë kanë mujt me ndodh ashtu. Ka pas [E

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 67

1 pakuptueshme] aq të mëdhaja nëpër ato komunikata sa që

2 nganjëherë dilke pyetja se çfarë po thuhet në to.

3 PY. Dëshmitar, nuk iu përgjigjët pyetjes që bëra. Do t'jua

4 bëj dhe një herë pyetjen. A nuk është e vërtetë që në këto

5 komunikata ju e bëni të qartë që nuk do të lejoni asnjë

6 veprimtari që ishte kundër luftës së UÇK-së?

7 PË. Mund të jetë kështu. Mund të jetë.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares tani të

9 paraqesë në ekran provën P1870.3, faqja 16 në shqip dhe në

10 anglisht.

11 PY. Dëshmitar, ju sapo thatë që "mund të jetë kështu".

12 Megjithatë, unë dua që të shikojmë plotësisht atë çfarë i keni

13 thënë TPNJ-së. Në fund të faqes në anglisht:

14 "Kur thoni masa ndëshkuese brenda zonës, për çfarë e keni

15 pasur fjalën? Çfarë mund të nënkuptojë kjo"

16 Dhe ju thoni:

17 "Faktikisht, në përgjithësi në komunikatat tona më të

18 hershme, në komunikatat tona të para, komunikoni publikisht

19 se UÇK-ja nuk lejonte asnjë aktivitet që ishte në, që shkonte

20 ndesh me luftën e qytetarëve të Kosovës, dhe kjo thirrje u bë

21 disa herë. Dhe në shumicën e rasteve u morën vendime për t'i

22 vrarë ata."

23 Dëshmitar, këtu ju nuk thoni që mund të jetë kështu, por

24 këtu ju thoni që ky në fakt ishte rasti. Dhe, ju thoni që edhe

25 janë vrarë njerëz që ishin kundër luftimeve, dhe ju thoni që

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 68

1 kështu ka qenë, apo jo? A është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

2 Z. DIXON: [Përkthim] Pyetja është orientuese.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Po i bëj pyetje dëshmitarit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
5 kundërshtimi, përgjigjuni.

6 DËSHMITARI: Kjo është, kjo është nxjerrë nga konteksti që
7 është fol për policët lokalë, dhe fjala ka qenë -- që tash më
8 riktheve tek ajo pjesa që kam thanë ma herët. Për policët
9 lokalë të uniformuar të armatosur nga policia serbe, të cilët
10 kanë qenë dhe janë zanë në vazhden e aktivitetit të tyre
11 kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Domethënë, jemi informu
12 nga ata. Kjo ka qenë. Në këtë kontekst është thanë.

13 Z. HALLING: [Përkthim]

14 PY. A mund të na shpjegoni se pse në përgjigjen tuaj nuk
15 përmendet asgjekundi "policia lokale"?

16 PË. Nuk e di këtë. Thashë veç më është, kur, këtu e kam pas
17 synimin. Jo gjithçka kena mujt me thanë në intervistë, me
18 thanë të drejtën.

19 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Nuk kam pyetje të tjera për ju.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

21 Z. Misetic, fjala për ju.

22 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic:

23 Z. MISETIC: [Përkthim]

24 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Unë quhem Luka Misetic. Jam Avokat i
25 z. Thaçi. Kam disa pyetje për ju. Dua që ta filloj aty ku e la

1 z. Halling. Pra, dua që ta filloj duke folur për historikun që
2 ka çuar ne deklaratën ose në intervistën që i keni dhënë TPNJ-
3 së në vitin 2006.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Për këtë arsye, do i kërkoja
5 Sekretares që të paraqesë në ekran dokumentin që tanimë është
6 provë gjyqësore e pranuar, me numër P1870.4, në faqen 2 në
7 anglisht dhe në faqen 13 në versionin në shqip. Ju kërkoj
8 ndjesë, e thashë gabim. Në faqen 13 në të dyja versionet.
9 PY. Do të filloj në rreshtin 21 në versionin në anglisht që
10 përkon me rreshtin 18 në shqip. Këtu ju thoni:

11 "Unë nuk do thoja, nuk do doja u premtova njerëzve të
12 Ramush Haradinajt se do të isha i gatshëm të dëshmoj në
13 favorin e tij.

14 "PY. Erdhën ata te ju apo shkuat ju te ata?

15 "PË. Ata më kanë kërkuar mua dhe shumë të tjerëve. Kush
16 është gati të dëshmojë. Dhe unë shpreha gatishmërinë time. Dhe
17 ata menduan se", dhe tani mund të vazhdojmë me faqen tjetër
18 "se për shkak të marrëdhënieve që kisha në të kaluarën me
19 Ramushin ... të isha i përgatitur të dëshmoja për të. Prandaj
20 unë shpreha gatishmërinë time për t'u bërë dëshmitar i
21 mbrojtjes, prandaj jam në dijeni se do të merrem në fillim në
22 pyetje nga avokati mbrojtës, por më pas edhe nga prokurori."

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani le të kalojmë tek prova
24 P1870.7, në faqen 5 aty, në versionin anglisht edhe në faqja 8
25 në versionin në shqip.

1 PY. Hetuesi ju bën një pyetje plotësuese. Fillon në rreshtin
2 5 anglishtja. Shqipja tek rreshti 18 -- më falni 16, 16
3 shqipja. 5 anglishtja, 16 shqipja.

4 Pyetje:

5 "Keni thënë që keni folur me anëtarë të familjes së
6 Ramushit për dëshminë e mundshme në Hagë."

7 Dhe ju keni thënë, me këta persona, me këta shokë. Doja
8 të shprehja gatishmërinë time.

9 "PY. A mund të më thoni diçka lidhur me këto diskutime,
10 saktësisht me kë keni biseduar?"

11 Jeni përgjigjur:

12 "Këta janë persona që janë të afërm me familjen e
13 Ramushit. Këta ... këto, pra, janë njerëzit e tij, të afërm me
14 familjen e Ramushit ... struktura politike, thashë jam i
15 gatshëm për çdo rast.

16 "PY. Po a ju kanë ardhur juve ata apo jeni afruar vetë
17 atyre?"

18 "PË. Unë kur më pyetën a jeni të gatshëm të jepni dëshmi
19 për Ramushin, iu kam përgjigj menjëherë po, jam treguar i
20 gatshëm.

21 "PY. Kush ju ka pyetur?"

22 "PË. Po ka veprimtarë që i ka në aleancë në Klinë, shokë
23 që e di që rrinë. Që kur ka marrë aktakuzën, ka qenë e njëjta
24 gjë dhe me rastin e Fatmir Limaj. Ka pas një listë të madh
25 personash që do të jepnin dëshmi për të."

1 Pyetja ime e parë është kjo. Kjo ka ndodhur përpara se të
2 flisnit ju me TPNJ-në në 2006, apo jo? E gjithë kjo, para se
3 të shkonit konkretisht dhe të jepnit dëshmi, apo jo?

4 PË. Kjo kam thanë këtu ka ndodhur në dëshmi.

5 PY. Jo nuk u kuptuam. S'e bëra unë pyetjen të qartë në fakt.
6 Kur them përpara se të flisnit me TPNJ-në, po them në 2006, ju
7 kishit folur me personat që ishin në familjen e Ramush
8 Haradinajt dhe ju u keni thënë se do të ishit i gatshëm që të
9 jepnit dëshmi për Ramushin e në favor të Ramushit. Pra keni
10 biseduar me këta njerëz përpara dëshmisë, është pyetja.

11 PË. Po.

12 PY. Dhe siç keni thënë vetë, këtu ata ju kishin dhënë një
13 kopje të aktakuzës që ishte kundër Ramushit që ta lexonit, apo
14 jo?

15 PË. Jo. Jo, jo. Kopje jo. Fjala ka qenë vetëm për atë
16 shkrimin që e kam pas ba unë atëherë kundër Ramush Haradinit
17 në media. Unë nuk e kam aktakuzën e Ramushit prej dikuj.
18 Përpos në media kur ka dalë.

19 PY. E shohim tek anglishtja të paktën, në rreshtin 19,
20 anglishtja. Po përpiqemi në fakt të gjejmë edhe
21 korresponduesen, përkthimin korrespondues në shqip.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në fund të faqes.

23 PY. Shqipja është rreshti 15 dhe 16. Pra, prokurorisë i keni
24 thënë që:

25 "... që prej momentit kur më kanë dhënë aktakuzën."

1 E shihni? Pra, sipas kësaj ju thoni që ju kanë dhënë
2 aktakuzën.

3 PË. Jo. Këtu shkrun kur iu dha aktakuza. Prej momentit kur iu
4 ka dhanë aktakuza, domethënë kur i ka dalë aktakuza e
5 Ramushit. Kur iu ka bo publike aktakuza. Nuk është fjala që më
6 është dhanë mu aktakuza. Në shqip është "kur iu dha". Unë nuk
7 e di që kam pas një aktakuzë nga dikush në dorë të Ramushit.
8 Kjo s'më kujtohet, absolut.

9 PY. Në rregull. Mirë.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim në ekran provën me numër
11 P1870.6, në faqen 5, rreshti 3 anglishtja. Do shohim shqipen
12 këtu. Faqja 5 tek shqipja, rreshtat 13 dhe 14.

13 PY. Në përmbledhjen që është bërë për ju, jua kanë lexuar
14 deklaratën dhe këtu thuhet:

15 "Kam lexuar aktakuzën kundër Ramush Haradinajt dhe të
16 tjerëve kur është lëshuar".

17 Dhe ju keni thënë:

18 "Po."

19 E keni konfirmuar këtë. A ju kujtohet tani që në fakt e
20 keni lexuar aktakuzën kundër Ramush Haradinajt përpara se të
21 flisnit me ish-Tribunalin e Hagës?

22 PË. Nuk e kam lexu krejt, por e di që ka dalë në media. Dhe
23 fjala është kanë vetëm për aq sa kam mujt me pa në media,
24 q'atë aktakuzë. Këto ka qenë. Vetëm për aq sa është kanë në
25 media.

1 PY. Të shohim disa pjesë të tjera, atëherë, të deklaratës
2 tuaj.

3 Z. MISETIÇ: [Përkthim] Ju lutem, në ekran të vendoset
4 prova P1870.3, faqja 11, dhe në anglisht edhe në shqip. Fillon
5 tek rreshti 4 anglishtja, tek rreshti 3 fillon shqipja. Faqja
6 11.

7 PY. Keni thënë:

8 "Këtë e lexova kur u publikua për herë të parë. E lexova
9 në media. Dhe në fakt më ngjethi lëkurën. Të gjitha akuzat që
10 ishin bërë kundër tij. Kur lexova aktakuzën e tij, u çudita me
11 gjërat që thuheshin në të. Siç thashë më parë, Ramush
12 Haradinaj mund të ketë pasur dobësi në udhëheqjen e tij, por
13 asnjëherë atëherë, dhe as tani, nuk e dyshoj se është
14 kriminel."

15 Shkojmë pak më poshtë, në rreshtin 14, ju keni thënë:

16 "Por gjërat që shkruhen në aktakuzë janë të pabesueshme.
17 Nuk i besoj këto gjëra. Nëse ai do t'i kishte kryer këto
18 veprime për të cilat akuzohet, këto përmes këtyre kanaleve të
19 informacionit që përmenda më herët, Shtabi i Përgjithshëm do
20 të ishte informuar rreth këtyre gjërave. Dhe mendoj se do të
21 kishte qenë, do të ishin marrë masa të padiskutueshme."

22 Dëshmitar, kur keni dhënë dëshmi dhe keni thënë se e
23 kishit lexuar aktakuzën, dhe ishit i bindur se Ramush
24 Haradinaj nuk mund t'i kishte kryer gjërat që pretendoheshin
25 në aktakuzë, ju po përpiqeshit ta mbronit atë ndaj akuzave që

1 kishte ngritur TPNJ-ja kundër tij, kështu?

2 PË. Unë duhet me thënë një të vërtetë, për aq unë e kam pas
3 informacion për Ramush Haradinajn.

4 PY. Po. Dhe ju jeni përpjekur t'i tregoni TPNJ-së se në fakt
5 ju ishit dëshmitar i mbrojtjes dhe ju nuk i besonit akuzat që
6 ishin ngritur kundër tij në aktakuzë, saktë?

7 PË. Po.

8 PY. Siç u lexua, siç e lexova në këtë fragment, është që një
9 nga gjërat që keni përdorur si argument ishte që ai nuk ishte
10 i -- përgjegjës -- më falni, dhe se Shtabi i Përgjithshëm
11 informohej për gjithçka që ndodhte në zonën e Dukagjinit, dhe
12 nëse do të kishte vepruar ai në mënyrë të gabuar, Shtabi i
13 Përgjithshëm do ta kishte disiplinuar, do të kishte marrë masa
14 disiplinore, apo jo?

15 PË. Po.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim disa nga akuzat konkrete në
17 aktakuzën që keni diskutuar në deklaratën tuaj. Ju lutem, të
18 vendoset në ekran materiali me numër DHT04880, DHT04912, në
19 faqen DHT04885. Ju lutem, paragrafi 24. Anglishtja është faqja
20 tjetër.

21 PY. Këtu një nga pretendimet kundër z. Haradinaj ishte:

22 "Ky qëllim, i cili domosdoshmërisht kërkonte kryerjen e
23 krimeve kundër njerëzit dhe shkeljen e ligjeve ose zakoneve të
24 luftës, ishte konsolidimi i kontrollit të plotë të Ushtrisë
25 Çlirimtare të Kosovës mbi zonën operative të Dukagjinit të

1 UÇK-së përmes sulmeve dhe përndjekjeve të drejtuar ndaj
2 pjesëve të caktuara të popullatës civile të atjeshme.
3 Domethënë, largimi i paligjshëm i civilëve serbë prej rajonit
4 nga zona dhe shtypja e të gjitha formave të bashkëpunimit me
5 serbët, pra, me civilët shqiptarë apo shtypja me forcë dhe
6 dhunë e çdo bashkëpunimi të vërtetë apo në dukje me serbët nga
7 ana e cilëve shqiptarë ose romë të atjeshëm. Qëllimi kriminal
8 përfshinte kërcënimet, rrëmbimet, burgimet ..."

9 Dëshmitar, ju i keni ditur akuzat e ngritura kundër z.
10 Haradinaj në kohën që i keni dhënë intervistën TPNJ-së, apo
11 jo?

12 PË. Jo kështu, por pjesë të shkëputura për aq sa kanë paraqit
13 mediat. Jo aktakuzën e plotë. Atë s'e kam pas kurrë në dorë.
14 Thjesht iu kam referu vetëm mediave që kanë fol rreth
15 aktakuzave të mundshme të Ramushit në Tribunalin e Hagës.

16 PY. Dhe një pjesë e atyre që kanë raportuar, apo që kanë
17 përmendur këtu është fakti që ai akuzohej edhe për faktin që
18 ka shënjestruar bashkëpunëtorët, apo jo?

19 PË. Ka mundësi.

20 PY. Kur keni dhënë këtë intervistën --

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Ose më saktësisht, shohim
22 paragrafin 35 të aktakuzës fillimisht. Duhet të jetë me numër
23 DHT04889. Këtu thotë:

24 "... gjatë muajve të mëvonshëm brenda zonës --"

25 Më falni.

1 "... forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e Ramush
2 Haradinajt duke përfshirë Shqiponjat e Zeza nën komandën e
3 drejtpërdrejtë, ngacmuan, rrahën ose përndryshe dëbuan
4 personat që nuk morën pjesë në luftime."

5 Ju e dinit përpara se të shkonit në TPNJ se një nga
6 akuzat kundër z. Haradinaj ishte se personat që kishin kryer
7 krime kundër personave që perceptoheshin si bashkëpunëtorë,
8 ishin nën komandën dhe nën kontrollin e tij, apo jo?

9 PË. Unë e kam thanë për, në intervistën time për Ramushin se
10 përgjegjësitë komanduese nëpër zona i kanë pas komandantët e
11 zonave. Dhe në këtë rast e kanë pas, përgjegjësitë në zonën e
12 Dukagjinit i ka pas Ramushi. Por thashë, një aktakuzë kështu
13 të kompletume me këto detale që po më shfaqen mu këtu, unë nuk
14 e kam pas, që të përcaktoj saktë se me çka është akuzu direkt
15 z. Haradinaj në atë kohë, por thjesht në gjenerale.

16 PY. Po. Dhe ju e kishit kuptuar në vija të përgjithshme që
17 po, ai po akuzohej për përgjegjësi eprore, apo jo?

18 PË. Po.

19 PY. Në rregull.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim tani materialin me numër
21 DHT04871 deri në DHT04875. Do t'ju lexoj shkurtimisht dy
22 dokumente. Në shqip është me numër DHT04872 deri në DHT04872-
23 AT.

24 PY. Dëshmitar, do t'ju lexoj disa nga fjalitë. Është fjala e
25 kryeprokurores së TPNJ-së për Këshillin e Sigurisë më 13

1 qershor 2005. Një vit, për afërsisht një vit para se të jepnit
2 ju dëshmi për TPNJ-në. Ajo thotë:

3 "Është një nder i madh të jem prapë këtu sot për të
4 sjellë një vlerësim për progresin e bërë në implementimin e
5 strategjisë së përfundimit. Një vlerësim me shkrim është
6 shpërndarë tashmë dhe unë kam qëllim të përqendrohem në
7 çështjet më të rëndësishme. Përparim i dukshëm mund të
8 raportohet në çështjet kryesore të strategjisë së përfundimit.
9 Të gjitha hetimet janë përfunduar dhe aktakuzat e fundit janë
10 lëshuar deri në fund të 2004."

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani shohim materialin DKV1045-
12 1066 në anglisht dhe DHT04876 deri në DHT04877-AT, shqipja.
13 Shohim faqen 3 në anglisht.

14 PY. Është një raport ky që është për afërsisht i të njëjtës
15 periudhë kohore lëshuar nga kryetarja e TPNJ-së për Këshillin
16 e Sigurisë, ku thuhet:

17 "Në përfundim të strategjisë të përfundimit, ne po
18 dorëzojmë aktakuzat deri në fund të ... 2004."

19 Dhe fjalia e fundit në këtë paragraf thotë:

20 "Nuk do të lëshohen aktakuza të reja nga Prokurori, çka
21 do të thotë se nuk do të konfirmohen më aktakuza të reja."

22 Dëshmitar, dhe kjo ka ndodhur në 2005, një vit përpara se
23 të jepnit ju deklaratën tuaj. Pra, ju e dinit se nuk do të
24 kishte aktakuza të reja për asnjë prej anëtarëve të Shtabit të
25 Përgjithshëm në TPNJ bazuar në atë që ishte thënë. Pra, ishte

1 raportuar gjerësisht në Kosovë se ish-Tribunali i Jugosllavisë
2 nuk do të lëshonte aktakuza të reja në kohën që ju keni dhënë
3 deklaratën tuaj, apo jo?

4 PË. Ka mundësi, por me thanë të drejtën këtë informacion nuk
5 e kam marrë, nuk e kam ndi. Realisht. Nuk e kam ndi. Mund të
6 jetë.

7 PY. Pra, ju nuk mendoni se, për shembull, kur flisni me
8 anëtarë të tjerë të UÇK-së në 2005, dhe në një pjesë të 2006,
9 asnjëherë s'keni folur ju që aktakuza, nuk do të kishte më
10 aktakuza të reja nga TPNJ-ja ose kur keni folur dhe me të
11 afërm të z. Haradinaj, nuk keni biseduar ju për këtë, që s'do
12 të kishte më aktakuza të reja?

13 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtoj.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

15 Mund të përgjigjeni.

16 DËSHMITARI: Jo. S'e besoj. Jo, s'e besoj.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkoj që të pranohen këto dy
18 dokumente si provë gjyqësore.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtojmë për arsye të
20 relevancës. Nuk më kujtohet ndonjë rast mua që të jetë lexuar
21 ndonjë pyetje dëshmitarit, të jetë treguar -- më falni, një
22 pyetje, një pjesë dëshmitarit, mos të jetë bërë as pyetje për
23 dokument, e të kërkohet pranimi.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Si nuk pati pyetje? Pati pyetje.

25 Për ne është e rëndësishme për besueshmërinë pranimi i këtyre

1 dokumenteve.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

3 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

5 Na i thoni dhe një herë numrat, ju lutem. Se keni përmendur

6 shumë dokumente, dhe nuk jam i sigurt për cilin po bëhet fjalë

7 konkretisht.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Pa problem. Është materiali

9 DHT04871-DHT04875 anglishtja. Ndërsa shqipja është me

10 versionin DHT04872-DHT04872-AT.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'i

12 pranojmë.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumentet në fjalë do

15 të marrin numrin 1D217. Klasifikimi është konfidencial.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, në rregull.

17 Dokumenti i radhës është me numër DKV1045-1066 deri në

18 DHT04876-DHT04877-AT.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe ky

20 dokument pranohet.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë

22 numrin 2D218, dhe klasifikimi është publik.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

24 PY. Të shohim edhe një herë intervistën që keni dhënë,

25 Dëshmitar, për TPNJ-në, ish-Tribunalin e Hagës.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Numri është P1870.3, në faqen 12
2 anglishtja edhe shqipja është në të njëjtën faqe. Tek
3 anglishtja do fillojmë të lexojmë në rreshtin 23, shqipja
4 duhet të jetë në numrin 17.

5 PY. S'kam përkthim.

6 PËRKTHYESI: Më dëgjoni?

7 DËSHMITARI: Përkthim, s'kam.

8 PËRKTHYESI: E kam të ndezur, më dëgjoni?

9 DËSHMITARI: Po, po. Tash po. Fjalët e fundit nuk e
10 dëgjova.

11 Z. MISETIC: [Përkthim]

12 PY. Po e përsëris.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E fillojmë
14 nga e para pyetjen ju lutem?

15 Z. MISETIC: [Përkthim]

16 PY. Pra, pyetja ju është bërë, shikoni rreshtin 17 tek
17 shqipja, ju lutem. I përkon 23 tek anglishtja:

18 "Gjatë kohës suaj në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së,
19 asnjëherë nuk dëgjuat pretendimin për pjesëtarë të UÇK-së që
20 mund të kishin kryer krime të këtij lloji?"

21 Të kalojmë faqen tek anglishtja, ju jeni përgjigjur:

22 "Nuk i dëgjova këto ..."

23 Dhe vijoni më tej, pra, ju e mohoni që e keni dëgjuar,
24 dhe më pas në rreshtat 14 dhe 15 në këtë faqe --

25 Z. MISETIC: [Përkthim] A jeni në faqen 13 tek anglishtja?

1 Po. Pak më lart, ju lutem.

2 PY. Ju thoni:

3 "... nuk ka pasur urdhra të këtij lloji që të vriteshin
4 civilët."

5 Tek anglishtja në fakt është rreshti 14:

6 "... nuk ka pasur urdhra të këtij lloji për të vrarë
7 civilët."

8 Pra, ju TPNJ-së i keni thënë që nuk keni pasur dijeni të
9 ketë pasur urdhra nga ndokush në UÇK, përfshirë këtu Shtabin e
10 Përgjithshëm, për të vrarë civilët, saktë?

11 PË. Po.

12 PY. Vazhdojnë pyetjet, në rreshtin 21, në këtë faqe, 14
13 shqipja. Ju vazhdoni dhe thoni që:

14 "... të gjitha njësitë kishin urdhra që në ato vende ku
15 familjet serbe nuk ishin larguar, të mos i preknin ata në
16 asnjë mënyrë."

17 E shihni? Është rreshti 14, 15 tek shqipja.

18 PË. Po.

19 PY. Më pas ju bëhet një pyetje, "A keni marrë ndonjë urdhër
20 me shkrim për këtë?" Ju thoni:

21 "Jo. Jo."

22 Kështu?

23 PË. Po.

24 PY. Në këtë pikë të intervistës, ju e kuptuat që nuk e kishit
25 realizuar, pra e kuptuat që nuk kishit asnjë urdhër me shkrim

1 për të mbështetur pretendimin tuaj se ishin lëshuar urdhra për
2 të mos prekur popullatën serbe, kështu? Civilët, serbë.

3 PË. Po.

4 PY. Më pas ju thoni në faqen 14, ju thatë që këto urdhra janë
5 lëshuar me gojë nga Shtabi i Përgjithshëm me radio, përmes
6 komunikatave, kështu?

7 PË. Po.

8 PY. Në paragrafin 16 të Shënimit Përgatitor numër 1, ju e
9 keni korrigjuar dhe keni thënë në fakt që drejtoria politike
10 nuk ka lëshuar aspak urdhra të tillë përmes komunikatave,
11 saktë?

12 PË. Po.

13 PY. Në përgjithësi komunikatat ishin me numra, apo jo?

14 PË. Po, me numra janë paraqitur.

15 PY. A ju kujtohet numri i ndonjë komunikate ku është
16 diskutuar fakti që nuk duheshin prekur civilët serbë?

17 PË. Jo, jo, s'kam [E pakuptueshme].

18 PY. Në provën P1870.3, intervistuesi vijon me këtë pistë të
19 pyetjeve.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Në faqen 15, fillimi i rreshtit 15
21 anglisht dhe 13 shqipja.

22 PY. Intervistuesi ju thotë:

23 "Një nga gjërat që është diskutuar në aktakuza, si të
24 Limaj ashtu edhe të Haradinajt, është çështja e
25 bashkëpunëtorëve të pretenduar serbë. Mes tyre edhe të

1 popullatës shqiptare. Dhe ky është sigurisht një problem në
2 çdo luftë. Kjo është diçka që duhet adresuar. Kush merrej me
3 këtë? Kush ishte i autorizuar të merrej me këtë? Ishte Shtabi
4 i Përgjithshëm apo ishte kjo diçka me të cilën mund të merrej
5 edhe një komandant vendor brenda zonës së tij?"

6 Pra, hetuesi këtu ju ka pyetur se kush ishte përgjegjës
7 për t'u marrë me bashkëpunëtorët shqiptarë në popullatën
8 shqiptare. Dhe ju ka dhënë disa alternativa këtu, thotë, a ka
9 qenë komandanti i zonës si Ramush Haradinaj apo ka qenë Shtabi
10 i Përgjithshëm?, saktë?

11 PË. Po.

12 PY. Ju keni zgjedhur Shtabin e Përgjithshëm, saktë?

13 PË. Jo, Shtabin e Përgjithshëm e kam zgjedh edhe nuk e di në
14 notë thashë, kam, q'aq s'e kam ba këtë përmirësim. Gjatë
15 pyetjes që bëri Prokurori më herët, gjatë ditës, në javën e
16 kaluar, unë nuk e di pse s'e kam ba në notë këtë përmirësim.
17 Por thjesht ka qenë kompetencë e zonave për arsye se Shtabi i
18 Përgjithshëm, e kam thanë në këtë intervistë, diku ma lart,
19 ose ma poshtë, për Tribunalin, se Shtabi i Përgjithshëm nuk i
20 ka njoftur as policinë lokale, e as ata të cilët janë kanë të
21 armatosur me armë kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
22 Komunikatat pastaj janë lëshu në gjenerale për t'u
23 paralajmëruar. Si preventivë, jo me raste konkrete.

24 PY. Por ama ju keni zgjedhur Shtabin e Përgjithshëm këtu, dhe
25 unë po ju them që një nga arsyet pse e keni zgjedhur Shtabin e

1 Përgjithshëm është sepse ju e dinit se po intervistoheshit për
2 z. Haradinaj, kështu?

3 PË. Po.

4 PY. Dhe nëse do të thoshit ju që ka qenë z. Haradinaj
5 përgjegjës, do ta implikonit atë në krimet e luftës, për të
6 cilat akuzohet, apo jo?

7 PË. Jo, nuk iu kam shmang në asnjë moment për ato çka kam pas
8 informacione. Në atë intervistë jam mundu me e thanë të
9 vërtetë. Për atë sa kam pas informacion. Intervistën e dini se
10 e kam bo pak nën presion. Edhe të shëndetit që kam pas, edhe
11 të kohës së gjatë që jam intervistuar gjatë tërë ditës në atë
12 intervistë. Pa pas mundësi të ushqimit e -- se kam marrë edhe
13 medikamente. Pa pas avokatin prezent.

14 Dhe terminologji edhe kam mujt edhe shpeshherë me gabu
15 për shkak se nuk i njoh këtë lëminë e drejtësisë. Pra,
16 shpeshherë kam mujt me qenë gabim në, dhe në terminologji kur,
17 gjatë intervistës.

18 PY. E kuptoj. Tani të vazhdojmë më tej me intervistën që po
19 shohim.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Vazhdojmë në faqen 18 në rreshtin
21 3 në shqip [Sipas përkthimit], dhe rreshtin 2 në shqip, në
22 versionin, në këtë faqe, domethënë, në faqen 18.

23 PY. Do t'jua lexoj pyetjen, Dëshmitar. Atëherë, pyetja që ju
24 bën hetuesi është kjo:

25 "A po thoni se nëse komandanti i zonës pasi bënte hetimet

1 e tij në terren me ndihmën e ushtarëve të tij në terren, dhe
2 pasi kishte përcaktuar se dikush sipas mendimit të tij ishte
3 bashkëpunëtor me serbët, a mundej ai -- dhe ky person nuk e
4 kishte dhënë këtë informacion, ai do ta mohonte këtë fakt, por
5 komandanti i zonë kishte bërë hetimet e veta dhe ishte
6 krejtësisht i qartë në vetvete se ky person bashkëpunon me
7 serbët? A mund ta merrte ai vendimin vetë për ta vrarë këtë
8 person?"

9 Përgjigjja që ju jepni menjëherë është si më poshtë:

10 "Le të kemi parasysh një gjë."

11 Atëherë, dhe një herë:

12 "Le të kemi parasysh një gjë. Me sa di unë asnjë
13 bashkëpunëtor për sa i përket mundësisë për të komunikuar,
14 asnjë bashkëpunëtor nuk është vrarë për shkak të faktit se ai
15 ishte bashkëpunëtor."

16 A e kuptoj drejt se ju nuk keni asnjë informacion ose
17 njohuri për asnjë person që është vrarë nga UÇK-ja nën akuza
18 që ishte bashkëpunëtor? A e kuptoj drejt këtë gjë unë,
19 Dëshmitar?

20 PË. Po.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani vazhdojmë më tej në rreshtin
22 18 në anglisht dhe në rreshtin -- jo, ju kërkoj ndjesë. E
23 thashë gabim. Atëherë, dhe një herë. Rreshti 18 në anglisht
24 dhe rreshti 12 në shqip.

25 PY. Hetuesi vazhdon më tej, ju bën pyetje plotësuese që ju

1 thoni që nuk keni asnjë informacion të një personi që është
2 vrarë dhe ju thotë:

3 "Por thjesht për t'u kthyer në pyetjen time. A do kishte
4 pra, nëse kjo do të kishte ndodhur, siç e shpjegova më herët,
5 nëse do të kishte ndodhur në mënyrën që e shpjegova fillimisht
6 më herët, a mund të merrnin ata vendim ta vrisnin këtë
7 person?"

8 Pyetja e parë është kjo. A e keni kuptuar që kjo ka qenë
9 pyetje hipotetike, Dëshmitar? E keni kuptuar si hipotetike
10 këtë pyetje?

11 PË. Po, tamam pyetje hipotetike ka qenë.

12 PY. Në rregull. Ju përgjigjeni si më poshtë:

13 "Jo."

14 Komandanti i zonës, në rastin në fjalë Ramush Haradinaj,
15 në qoftë se ishte në gjendje të komunikonte me këtë
16 bashkëpunëtor, ai nuk do të kishte të drejtë ta vriste këtë
17 bashkëpunëtor.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të kalojmë te faqja tjetër në
19 anglisht.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk e shohim citimin.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Do ju lexoj të gjithë pjesën.

22 PY. Atëherë, ju thoni që:

23 "Në qoftë se nuk do të komunikonte në zonë ose me çdo
24 ushtar të UÇK-së, në përgjithësi këto raste ndodhnin në këtë
25 formë në tokën e askujt, mes vijave të forcave shqiptare dhe

1 serbe. Me fjalë të tjera, këto raste ndodhnin ndërkohë që ai
2 ishte duke i kryer aktivitetet e veta. Por, nëse ishte bërë
3 ndonjë kontakt me ushtarët e UÇK-së, ai atëherë qortohej,
4 qortohej gojarisht, jepeshin paralajmërime që të mos sillen në
5 këtë mënyrë, që të mos kishte kontakt me forcat serbe dhe disa
6 prej këtyre njerëzve i respektonin këto paralajmërime dhe disa
7 të tjerë jo.”

8 Pastaj ju bëhet pyetja e radhës:

9 “Dhe çfarë ndodhte me ata që nuk e respektonin këtë
10 paralajmërim?

11 Përgjigje:

12 “Ata persona që nuk u vinin veshin këtyre paralajmërimeve
13 dhe vazhdonin me aktivitetet e tyre armiqësore ...”

14 Dhe pastaj në mënyrë të pakuptimtë incizimi i
15 audiokasetës mbaron. A është e saktë kjo?

16 PË. Po.

17 PY. Tani le të shohim deklaratën e dëshmitarit të vitit 2006
18 të dhënë prej jush, dhe të shohim se si mbushet kjo mangësia
19 në transkript.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Për këtë arsye do i kërkoja
21 Sekretares që të kalojmë në provën P1871 në paragrafin 38.

22 PY. Në paragrafin 38 të deklaratës së dëshmitarit të dhënë
23 prej jush në 2006 për TPNJ-në, ju keni thënë si më poshtë:

24 “I pyetur rreth kolaboracionistëve të serbëve, mund të
25 them se ata na kanë shkaktuar shumë probleme pasi ata ishin të

1 infiltruar nëpër zona që i kontrollonte UÇK-ja. Me vendim të
2 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së këta njerëz konsideroheshin
3 se ishin instrumente të regjimit të Millosheviqit dhe pjesë e
4 aparatit të policisë dhe ushtrisë dhe duhet të trajtoheshin si
5 të tillë. Hapat e ndërmarrë kundër tyre kishin për qëllim të
6 bëhej e ditur se askush nuk duhej të sillej më në këtë
7 mënyrë.”

8 Ndërkohë që në paragrafin 39 vijohet më tej:

9 “Sigurisht, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së nuk mund ta
10 dinte se kush ishte kolaboracionist serb. Ne mbështeteshim në
11 zona të ndryshme operationale për ta ditur se cilët ishin ata.
12 Kur dikush identifikohet si kolaboracionist serb në zonën
13 operationale, masat ndëshkuese do të merreshin ndaj tyre
14 brenda zonës. Në raste kur ata janë zënë në vazhdën e
15 aktiviteteve të tyre, ai person do të vritej. Shtabi i
16 Përgjithshëm i UÇK-së pastaj do të informohet rreth masave të
17 veçanta ndëshkuese që ishin marrë.”

18 Ndërkohë që në paragrafin 43, thuhet si më poshtë:

19 “Sa u përket kolaboracionistëve serbë, komandantët e
20 zonave operationale vepronin në bazë të raportit që u jepej
21 nga ushtarët nën komandën e tyre. Pasi që personit i është,
22 është paralajmëruar dhe Shtabi i Përgjithshëm është i bindur
23 që ai ishte kolaboracionist, kolaboracionisti mund të vritej
24 nga komanda, nga struktura e komandës së UÇK-së nëse ai
25 vazhdonte aktivitetet e tij. Pas urdhrit për ta vrarë që ishte

1 lëshuar nga Shtabi i Përgjithshëm vrasja mund të kryhej nga
2 cilido ushtar që e identifikonte kolaboracionistin.”

3 Ne pamë që ju i keni thënë TPNJ-së në pjesë të caktuara
4 të intervistës të paktën në dy raste, që ju nuk keni njohuri
5 që të jenë vrarë kolaboracionistë dhe nuk keni njohuri që
6 është vrarë ndokush si kolaboracionist. Por në këtë paragraf
7 të deklaratës së dëshmitarit tuaj, për çfarë flisni ju në
8 qoftë se keni thënë më përpara që nuk keni pas njohuri që të
9 jetë vrarë dikush si kolaboracionist? Për çfarë e keni fjalën?
10 PË. Këto kanë qenë, këto kanë qenë ma të -- për mendimin tim,
11 kanë qenë më tepër pyetje hipotetike për ngjarje, për ngjarjet
12 e ngjashme. Si do të veprohej nëse. Ose si të veprohej nëse
13 ndodh diçka e tillë. Unë thashë, nuk e di në nota a e kam
14 ndryshu këtë apo jo, por e kam përmend se këtu është për
15 shtabet në disa raste është për shtabet e zonave, dhe gjithmnë
16 iu kam referu policëve lokalë të cilët kanë qenë në territoret
17 tona të veshur si, të veshur me uniformë serbe dhe me armë. Të
18 cilët realisht, kur e kam thanë në vazhdën e aktivitetit të
19 tyre, kjo duhet të kuptohet se ata të cilët me armë na kanë
20 sulmuar neve, apo i kanë sulmuar ushtarët e UÇK-së, duhet të
21 merren masa të tilla. Thjesht mos të zbrapsen ushtarët tanë
22 përballë këtij agresioni të tyre të policëve lokalë. Kjo
23 është.

24 PY. Në rregull. Dëshmitar, në seancën përgatitore me ZPS-në,
25 pra, me Zyrën e Prokurorit të Specializuar disa javë më

1 përpara, a ju janë bërë pyetje hetuese sa i takon këtyre
2 pjesëve të deklaratës së dëshmitarit që keni dhënë ju më
3 përpara? Për shembull, se kush ka dhënë konkretisht urdhra për
4 vrasjen e kolaboracionistëve, ose kur ka ndodhur kjo gjë. A ju
5 kanë bërë pyetje të kësaj natyre gjatë seancës përgatitore me
6 ZPS-në, Dëshmitar?

7 PË. Ka pas edhe pyetje shtesë.

8 PY. Në rregull. Çfarë pyetje ju kanë bërë dhe çfarë përgjigje
9 keni dhënë?

10 PË. [E pakuptueshme] tash, nuk po i mbaj mend të gjitha
11 pyetjet, por ka pas pyetje shtesë. Q'ato ça i kemi ndërru në
12 notën na është dhanë mundësia me i ndërru dy ditë, me i ndërru
13 për aq sa kemi pas mundësi. Se volumi ka qenë shumë i madh i
14 materialeve edhe ndoshta ka mujt me qenë ashtu pa korrigju,
15 por ka pas edhe pyetje shtesë në këtë takim.

16 PY. Në rregull. A ju kujtohen pyetje plotësuese të lidhura me
17 këto tre paragrafë të deklaratës së dëshmitarit që i keni
18 dhënë ju TPNJ-së në 2006? Konkretisht, për këto tri paragrafë,
19 a ju janë bërë pyetje plotësuese, Dëshmitar?

20 PË. Saktë, s'e kujtoj. Nuk më kujtohet saktë.

21 PY. A ju kujtohet në qoftë se Prokurori ju ka pyetur që të
22 identifikonit personin ose personat në Shtabin e Përgjithshëm
23 që kanë nxjerrë urdhër për vrasjen e kolaboracionistëve?

24 PË. Më duket që është bë një pyetje e tillë. Më duket që
25 është bë. Nuk jam shumë i sigurt, të them të drejtën.

1 PY. A keni përmend ju një person të tillë?

2 PË. Jo.

3 PY. Pse nuk e keni përmend?

4 PË. Se s'kam dit që ka një person që ka mujt me dhanë një
5 urdhër për vrasjen e dikujt.

6 PY. Në rregull. Do ju bëj një pyetje tjetër. Ju thatë në këto
7 pjesët që unë jua lexova që:

8 "Kur ato janë kapur gjatë veprimtarive të tyre, personi
9 do vritej."

10 ZPS-ja në seancën përgatitore a ju ka bërë pyetje që ju
11 t'i jepnit një shembull të një personi që është vrarë gjatë
12 veprimtarive të veta kolaboracioniste? Jua ka bërë ndonjë
13 pyetje të tillë, Dëshmitar?

14 PË. Jo, me sa kujtoj.

15 PY. Më tej ju keni thënë në këto tre paragrafë që sapo
16 lexova, që:

17 "Shtabi i Përgjithshëm më pas informohej lidhur me masat
18 ndëshkuese konkrete të marra."

19 A ju bëri ZPS-ja pyetje që ju t'i jepnit një rast konkret
20 ku Shtabi i Përgjithshëm është informuar për masat konkrete
21 ndëshkuese të marra kundër kolaboracionistëve?

22 PË. Jo. S'besoj.

23 PY. Lidhur me paragrafin 38 të deklaratës që ju thoni që:

24 "Me vendim të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, këta
25 persona konsideroheshin si instrumente të regjimit të

1 Millosheviqit dhe si pjesë e aparatit ushtarak dhe duhet të
2 trajtoheshin si të tillë”.

3 A të ka pyetur Prokurori gjatë seancës përgatitore për të
4 identifikuar, për shembull, se kur është marrë një vendim i
5 tillë?

6 PË. Ndoshta, ndoshta më ka pyet, por nuk e di kur është marrë
7 një vendim i tillë. Kjo është bo përmes komunikatash politike,
8 komunikata që kanë dal në opinion, dhe është fol për raste
9 gjenerale, jo për raste të veçanta.

10 PY. Kush i ka lëshuar, me emër, kush i ka lëshuar këto
11 komunikata?

12 PË. Nuk e di.

13 PY. A e dini se kur, domethënë, për cilat komunikata bëhet
14 fjalë, domethënë këto komunikatat kur janë lëshuar, kohën a e
15 dini kur?

16 PË. Këto janë lëshu kohë pas kohe, dhe aq sa kemi pas mundësi
17 ne me i përcjell --

18 PY. Një çast.

19 PË. Okej.

20 PY. Një çast, një çast. Duhet të kisha qenë unë më i saktë,
21 më preciz në pyetjen time. Këtu ju flisni për një vendim të
22 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Pra “këta persona
23 mendoheshin që ishin instrumente të regjimit të
24 Millosheviqit”. Kur e ka marrë një vendim të tillë Shtabi i
25 Përgjithshëm i UÇK-së? Pra, ju nuk e dini kush e ka marrë

1 brenda Shtabi të Përgjithshëm. Po kohën kur është marrë një
2 vendim i tillë, a e dini?

3 PË. Jo, nuk e di.

4 PY. Në rregull. Dëshmitar, a ju kujtohet se jeni takuar me
5 anëtarë të Mbrojtjes së z. Thaçi më 13 prill 2022, konkretisht
6 jeni takuar me z. Greg Kehoe, Peter McCloskey, z. Dastid
7 Pallaska, dhe një përkthyes. A ju kujtohet të keni marrë në
8 një takim të tillë?

9 PË. Po.

10 PY. Do dua t'ju tregoj shënimet që janë marrë në këtë takim.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Për procesverbal është dokumenti
12 DHT004866 [Sipas përkthimit] deri në DHT04869. Ju lutem,
13 paraqisni versionet në anglisht dhe në shqip.

14 PY. A konfirmoni që takimi është organizuar më ose rreth
15 datës 13 prill 2022?

16 PË. Po.

17 PY. Procesverbali i takimit që është mbajtur nga z.
18 Kruszewski, do t'ju tregoj për një çast, thonë që:

19 "Z. Bashota ... është intervistuar nga TPNJ-ja,
20 megjithatë, 4-5 ditë më përpara ZPS-ja është munduar që të
21 kontaktojë me të në një numër telefonik që nuk ishte i tij. Ai
22 e kishte të paqartë në qoftë se duhet të flasë me ta apo jo.
23 Kur e kanë intervistuar, kur e ka intervistuar ZPS-ja ai ka
24 vendosur të mos flasë.

25 "Kur e ka intervistuar TPNJ-ja pyetjet ishin hipotetike,

1 si do të kishin ndodhur gjërat në rast të kësaj apo të asaj.
2 Më shumë referenca për Shtabin e Përgjithshëm. Rrjedhja e
3 hetuesve të ZPS-së ishte bazuar në raste hipotetike, si për
4 shembull nëse gjërat do të ishin në këtë formë ...”

5 “Sokol Bashota komentoj paragrafin 39 dhe paragrafin 43
6 të deklaratës së tij për TPNJ-në. Nëse dikush i identifikuar
7 si bashkëpunëtor kapej në flagrancë, pra, gjatë ushtrimit të
8 aktiviteteve të veta, nëse ishte duke shtënë në drejtim të
9 ushtarëve të UÇK-së, nëse i ka bërë rezistencë, atëherë ai do
10 të vritej. Pasi personi ishte paralajmëruar dhe Shtabi i
11 Përgjithshëm ishte informuar, ai do të qëllohej apo mund të
12 vritej nëse do të vazhdonte aktivitetin e vet. Sokol Bashota
13 nuk ka dëgjuar ndonjëherë që Shtabi i Përgjithshëm të ketë
14 lëshuar ndonjë urdhër për të vrarë një bashkëpunëtor. Kurrë
15 nuk e kanë pritur një vendim të tillë. Kjo është një gjë
16 hipotetike.”

17 A ju kujtohet që t’ia keni thënë këtë avokatëve të z.
18 Thaçi në takimin që keni organizuar më 13 prill 2022 ose rreth
19 kësaj date?

20 PË. Po.

21 PY. Faleminderit.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Dua të kërkoj që të pranohen
23 dokumentet në prova gjyqësore, megjithatë ka një korrigjim që
24 dua të bëj që do lidhet me pyetjet që kam më pas. Atëherë, të
25 kalojmë te faqja e fundit, këtë më shumë për Trupin Gjyqësor e

1 kam, dhe për Prokurorinë. Jo, një faqe më përpara. Të kalojmë
2 nga fundi i faqes. Atëherë, ka një paragraf këtu që thuhet që:

3 "Gjatë incidentit me dy gazetarët serbë, z. Thaçi ka qenë
4 në një fshat në Malishevë."

5 Z. Kruszewski e ka korrigjuar këtë.

6 Kështu që për këtë arsye dua që të kërkoj që të paraqitet
7 në ekran dokumenti DHT04870 [Sipas përkthimit] deri në
8 DHT04870 si në shqip ashtu dhe në anglisht. Pra, Trupi Gjykses
9 do të shikojë që z. Kruszewski e ka korrigjuar këtë. Pra këtu
10 në shënimet origjinale të tij thuhet që ai, z. Kruszewski, e
11 ka interpretuar gabimisht dhe ka dhënë gabimisht emrin e z.
12 Thaçi.

13 Kështu që dua që të pranohen këto dy dokumente si
14 dokumente, si prova gjyqësore.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtim?

16 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kjo është
17 dita e parë që ne e shikojmë këtë dokument. Mbështetur në
18 përkufizimin e Trupit Gjykses për një deklaratë të një
19 dëshmitari, kjo, ky cilësohet si deklaratë e një dëshmitari.
20 Avokati nuk ka përmbushur kriteret e rregullës 153, apo 55 të
21 rregullores, kështu që nuk mund të pranohet.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Pse është e papranueshme, se
23 dëshmitari është këtu? Bëhet fjalë për shënimet e një
24 interviste. Unë nuk po kërkoj që të pranohet si deklaratë
25 dëshmitari.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po është
2 deklaratë, nuk e di se çfarë emri mund t'i vëmë.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë e kuptoj që sipas rregullës
4 153, 155, është detyrë e palës thirrëse sipas kësaj
5 rregulloreje, nuk është detyra jonë. Sepse në të kundërtën në
6 qoftë se, për shembull, unë do të doja që të pranohej një
7 deklaratë e OTP-së që nuk është përdorur në pyetje, atëherë i
8 takon që duhet të shkojë sipas procedurës dhe kritereve të
9 rregullës 153 dhe 55.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta
11 pyesni në qoftë se e ka nënshkruar këtë dokument apo jo.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk e ka nënshkruar, se këto janë
13 shënimet e hetuesit. Por e konfirmoi që ka thënë këtë gjë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po duhet ta
15 konfirmosh këtë në njëfarë mënyre.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të më jepni një çast, ju
17 lutem.

18 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

19 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do i japim
21 një numër provizor prove. Dhe kjo besoj që do të japë
22 mundësinë Prokurorisë që ta rishikojë dhe do ta zgjidhim në
23 momentin e volitshëm.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull. Por jam pak i paqartë
25 sepse në të shkuarën ne, ju i keni pranuar shënimet e

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 97

1 Prokurorisë sa i takon kontakteve me dëshmitarin si prova
2 gjyqësore. Ndërkohë që nuk e kuptoj se pse duhet të bëni
3 ndryshe tani.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E gjithë
5 gjëja ka të bëjë me faktin në qoftë se bëhet fjalë për
6 deklaratë apo jo. E kuptoj që kemi mospajtime lidhur me këtë,
7 megjithatë do t'i japim një numër provizor prove.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do i japim
10 një numër MFI.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Ka pasur raste që deklarata përtej
12 rregullës 154 që janë përgatitur nga ZPS-ja, ose janë mbledhur
13 nga ZPS-ja, janë pranuar në prova gjyqësore, por pavarësisht
14 kësaj, do të duhej që të ndiqej procedura të paktën në seancë
15 përgatitore ku dëshmitari ka pas mundësi të plotë që të
16 rishikojë ato dhe të bëjë komente ose korrigjime.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të bëjmë parashtime më vonë,
18 por unë nuk kërkoj që të pranohet si deklaratë dëshmitari.
19 Këto janë shënime të takimit të tij. Kështu që e tha këtë gjë,
20 dhe për këtë arsye unë po ju kërkoj që ta pranohet, që ta
21 pranoni këtë. Thjesht sa për të përcaktuar ose vërtetuar datën
22 që ai tha që është hipotetike.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, çfarë po thoni? Po
24 thoni që personi që ka mbajtur procesverbalin është dëshmitar
25 apo jo, Misetic?

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Dua të them që ...

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë po them
3 është e kundërshtueshme, por nga ana tjetër duhet që të shohim
4 pjesën e vlerës provuese, vlera provuese është e kufizuar. Nuk
5 është se dua të tregoj gishtin, por thjesht, domethënë, po
6 them që kemi pikëpamje të ndryshme sa i takon kësaj.

7 Në rregull, atëherë le të caktojmë një numër provizor
8 prove.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti i parë nga
10 DHT04866 deri në DHT04869 dhe përkthimi në shqip do të marrin
11 numrin e provës provizore 1D218. Ndërkohë që dokumenti tjetër
12 DHT04870 deri në DHT04870 dhe përkthimi ose versioni përkues
13 në shqip do të marrin numrin 1D00220. Faleminderit.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
15 ju.

16 Z. MISETIC: [Përkthim]

17 PY. Dëshmitar, i keni thënë në vitin 2022 dhe e thatë përsëri
18 këtu gjatë pyetjeve të bëra, që ju e keni kuptuar që pyetjet
19 që të janë bërë nga TPNJ-ja kanë qenë pyetje hipotetike. Unë
20 vërej gjithashtu që hetuesit e TPNJ-së nuk ju kanë bërë pyetje
21 plotësuese, të natyrës që jua bëra unë, për shembull se kush i
22 ka lëshuar këto urdhra, ose kur janë lëshuar këto urdhra.

23 A është përshtypja juaj që edhe hetuesit juve ju kanë
24 bërë pyetje hipotetike?

25 Z. HALLING: [Përkthim] Kërkon spekulim.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Po i kërkoj pikëpamjen e vet,
3 përshtypjen e vet.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po mund ta
5 pyesni çfarë përshtypje keni ju, por jo se çfarë kanë bërë.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Këtë pyetje i bëra në fakt.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo çfarë po
8 bënte, por çfarë po mundohej të realizonte. Mendoj, domethënë.
9 Duhet ta perifrazoni.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] në rregull.

11 PY. A ka qenë përshtypja juaj, Dëshmitar, që pyetjet që ju
12 janë bërë juve kanë qenë hipotetike?

13 PË. Po, këta kam thanë edhe Mbrojtjen e z. Thaçi që ka qenë,
14 ka pas momente kur kanë qenë pyetje që unë i kam konsideruar
15 si pyetje hipotetike.

16 PY. Në rregull. Zyra e Prokurorisë të TPNJ-së pasi dhatë
17 dëshmitë, pra këtë dëshmi, kjo Zyrë, pra Zyra e Prokurorit nuk
18 vendosi që juve t'ju thërriste si dëshmitar në çështjen
19 Haradinaj, apo jo?

20 PË. Po.

21 PY. Përpara intervistës me TPNJ-në që keni parë, a ju ka
22 thënë ndonjëherë ndokush që jeni i dyshuar?

23 PË. Jo.

24 PY. Ne e dimë që z. Haradinaj asnjëherë nuk ka paraqitur
25 lëndën e tij, nuk ka bërë, domethënë, parashtrime mbrojtëse.

1 Megjithatë, pasi i keni dhënë këtë deklaratë për TPNJ-në në
2 2006, ndokush që ka qenë pjesë e ekipit të Haradinajt, a ju ka
3 thënë juve ndonjëherë që ju mund të thërriteshit si dëshmitar
4 i mbrojtjes në qoftë se mbrojtja do vendoste të thërriste
5 dëshmitarët e vet?

6 PË. Po thashë, nuk më kujtohen me kënd kam bisedu saktë në
7 atë kohë, por thjesht kanë qenë ndoshta elementë domethënë të
8 subjektit të tij politik të cilët kanë qenë më shumë, më afër
9 me Ramushin. Dhe një ndër pyetjet që është ba, më është ba se
10 a mundesh me bo një, a mundesh nëse të thirr mbrojtja, me
11 dhanë një deklaratë të tillë. I kam thanë "po" kam shpreh
12 gatishmërinë time, se "po", muj.

13 PY. Në rregull. Në përgjigje të kësaj pyetjeje hipotetikusht
14 siç keni bërë që ndëshkimi i kolaboracionistëve nuk ishte
15 përgjegjësi e z. Haradinaj, por ishte përgjegjësi e Shtabit të
16 Përgjithshëm, a mendoni ju që kjo dëshmi ka qenë fajësuese për
17 z. Haradinaj -- shfajësuese, për z. Haradinaj? Mendonit ju e
18 zhvishte nga barra z. Haradinaj kjo gjë?

19 PË. Unë e thashë edhe më herët më duket, se nuk ka pas, nuk
20 kam pas qëllime me fajësu ose me shfajësu z. Haradinaj. Jam
21 mundue që deklaratën, edhe mbrenda atij presioni që kam pas në
22 atë kohë, me dhanë aq, për aq sa di edhe për aq sa kam
23 informacion, e të sigurt. Por thashë nuk e di pse në notën nuk
24 e kam ndryshuar atë "Shtabi i Përgjithshëm" ku është në një
25 vend aty, që kam thanë "Shtabi i Përgjithshëm", nuk është ba

1 "shtabi i zonës". Përndryshe deklaratën që kam dhanë në atë
2 kohë e kam dhanë, konsideroj që e kam dhanë në përputhshmëri
3 me njohuritë e mia që i kam pas.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës po mundohem që të
5 ndryshoj temë dhe po mundohem që të zgjedh një temë që kërkon
6 pesë minuta për t'u trajtuar.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndoshta do
8 jetë më mirë që të bëjmë pushimin tani, dhe pastaj të vazhdoni
9 me pjesën tjetër dhe të keni pak çaste për të menduar me
10 pyetjet e radhës.

11 Dëshmitar, tani do bëjmë pushimin e drekës. Do bëjmë
12 pushim për një orë e gjysmë. Do takohemi përsëri këtu në orën
13 14.30. Do ju lutesha të mos bisedonit me askënd për dëshminë
14 tuaj jashtë sallës së gjyqit. Mund të largoheni nga salla
15 tani.

16 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
18 pushim deri në orën 14.30.

19 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.57

20 --- Seanca rifillon në orën 14.31

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic, e
22 kuptoj -- me sa kuptova kishe një kërkesë.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Doja të bëja një parashtrim
24 shtesë meqë pata kohë gjatë drekës, sa i takon pranueshmërisë
25 së shënimeve të hetuesit.

1 Pikë së pari do doja të fillonim në seancë private, sepse
2 dokumenti në fjalë është i natyrës private.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në
4 seancë private.

5 [Seancë private]

6 [Seancë private teksti i fshirë]

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10 [Seancë e hapur]

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

13 [Dëshmitari vijon dëshminë]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë se u

15 kthyet, Dëshmitar.

16 Z. Misetic do vazhdojë me pyetjet.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

18 Z. MISETIC: [Përkthim]

19 PY. Dëshmitar, Mirëdita. Dua t'ju bëj disa pyetje lidhur me

20 dëshminë që keni dhënë javën e kaluar e cila është reflektuar

21 në transkriptin faqja 22987, rreshti 16. Dhe ju thatë që

22 bashkëpunëtorët ishin një rrezik i madh. Do t'ju tregoj tani

23 një intervistë që ka dhënë Zoran Stijovic, që ka qenë shefi i

24 seksionit të analizës në qendrën e Prishtinës për Shërbimin e

25 Sigurisë Serbe nga '96 deri më 12 qershor 1999.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretares së seancës të
2 vendosë në ekran materialin filmik. Është me përkthim, me
3 dublim në shqip, më saktë. Ka numër DHT04913, anglishtja ka
4 transkriptin që mund të shfaqet përbri, DHT4193-TR-ET. Fillon
5 në faqen 3 transkripti. Ne nga videoja duhet të shikojmë
6 minutën 09:48.

7 PËRKTHYESI: Nuk është me dublim, por është video me zë;
8 material filmik me zë.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk mund ta shohim?

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Është në shqip audioja
11 mund të jetë vetëm në shqip dhe një nga përkthyesit do duhet
12 ta lexojë në anglisht atëherë.

13 [Luhet videoincizimi]

14 "... të Kuçovës në Maqedoni ku udhëheqësit e ngushtë të
15 Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës kanë qenë të
16 orientimit komunist-marksist dhe aty kanë marrë pjesë liderët
17 e shqiptarëve nga të gjitha trevat nga Serbia, Maqedonia, Mali
18 i Zi, Greqia, komunat në jug të Serbisë dhe ndër ta ka patur
19 njerëz që kanë qenë në kontakt me shërbimin.

20 "Kanë qenë dy drejtime: Një që anëtarët e Lëvizjes
21 Popullore të Kosovës të kyçen në jetën publike me partitë që
22 kanë qenë legale dhe që autoritetin e tyre ta ndërtojnë përmes
23 tyre, por të ngelen besnikë. Pra, në Lidhjen Demokratike,
24 Parti Demokristiane dhe Social-Demokristiane. Vendimi i dytë
25 ishte në takimin e ardhshëm në një fshat të Drenicës. Njerëzit

1 që kanë qenë edhe të gjykuar për shkak të veprimtarisë në këto
2 parti kanë patur për detyrë të përgatisin shqiptarët për
3 rezistencë të armatosur ndaj forcave të rendit publik dhe
4 qetësisë në Kosovë e Metohi dhe do shkohet në krijimin e
5 Republikës së Kosovës. Kjo ka ndodhur në vitin në '93 dhe në
6 takimin e dytë në vitin '94. Në këtë periudhë ne kemi bërë
7 disa aksione duke dokumentuar ekzistencën e këtyre
8 organizatave."

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

10 PY. Dëshmitar, kjo që thotë personi këtu për infiltrimet në
11 LKÇK, pra, kjo që thotë personi që pamë ne në video për
12 infiltrimin e LKÇK-së, a përputhet me ato që keni kuptuar edhe
13 ju asokohe se [E pakuptueshme] kanosjeve që përbënin apo
14 kërcënimet që përbënin bashkëpunëtorët për lëvizjen?

15 PË. Unë kam qenë atëherë një udhëheqës, s'kam qenë udhëheqës
16 por kam qenë një anëtar i LPK-së në nivel lokal dhe janë këto
17 politikat e kryesisë qendrore të LPK-së dhe qëndrimet e tyre
18 dhe karshi këtyre probleme nuk i di. Por e kam thënë më duket
19 edhe më herët se në çdo organizim ilegal patjetër se armiku
20 synon që të fusë elementët, elementët e et, por unë kam një
21 diçka konkrete rreth saj.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Për hir të kohës do i lutesha
23 Sekretares së seancës të shkonim në minutën 13:47 në video dhe
24 pjesa përkuese e transkriptit, ju lutem. Fundi i faqes 3 në
25 transkript.

1 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
2 këshillohen]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ky dokument
4 është konfidencial dhe po i përcillet publikut.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Po kjo është transmetuar në
6 televizion. Nuk e shikoj çfarë problemi ka.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të jetë
8 publik, ka ndonjë kundërshtim?

9 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk ka asnjë kundërshtim.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
11 riklasifikojeni dokumentin në fjalë si dokument publik.

12 [Luhet videoincizimi]

13 "A më mirë të keni njerëz, a keni pasur shqiptarë në
14 mesin tuaj dhe sa ka qenë numri i pjesëtarëve të shërbimit?"

15 "Për shkak të anës profesionale nuk mund të përgjigjem
16 për pjesën e dytë, por dihet se nëse ju i gjurmoni hajdutët
17 nuk mund ta zbuloni përmes njeriut të ndershem. Pra, duhet të
18 keni njerëz që merren me aktivitete të tilla. Duhet të keni
19 njeriun brenda. Për të ditur për aktivitetet e shqiptarëve nuk
20 mund të keni njerëz që quhen Zoran, por duhet të jetë Agimi që
21 ta përkthejë emrin tim. Është çështje e teknikës se si duhet
22 të vihet deri te këta njerëz. Këto janë lojëra që bëhet nga
23 shërbimet dhe kjo do të vazhdojë derisa të ketë informacione.

24 A mund të thuhet se ka qenë një numër mjaft i madh i
25 shqiptarëve që kanë punuar për shërbimin?"

1 Z. MISETIC: [Përkthim]

2 PY. Dëshmitar, pyetja ime është kjo: Ai thotë, "S'fut dot një
3 Zoran, të duhet një Agim për këto raste". A na e konfirmoni
4 dot në qoftë se Agim është ekuivalenti i emrit Zoran në
5 serbisht?

6 PË. Nuk e njoh serbishten aq mirë. Nuk e di.

7 PY. A përputhet kjo dhe me mënyrën si e keni kuptuar ju
8 asokohe që shërbimi sekret serb në mënyrë aktive përpiquej të
9 infiltrohej në UÇK?

10 PË. Për -- përbrenda UÇK kemi menduar se ka mundësi me i fut
11 elementet e vet brenda radhëve të UÇK-së, por nuk e dimë një
12 rast konkret.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, Kryegjykatës. Kërkoj
14 pranimin e videos dhe të transkriptit si provë gjyqësore.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
16 kundërshtime?

17 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Për procesverbal unë nuk kërkoja
19 që të shfaqet transkripti në gjuhën shqipe, po në mënyrë që ta
20 kemi të zbardhur. Në procesverbal është me numër DHT04913-TR.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

22 [Përkthim] DHT04913 deri në DHT04913-TR-ET, bashkë me
23 përkthimin në gjuhën shqipe pranohet.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Materiali do të marrë
25 numrin e provës 1D221 dhe klasifikimi është publik.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

2 I lutem tani Sekretares së seancës që të vendosë në ekran
3 materialin me numër 006867 deri në 0068868-ET si dhe
4 serbishten që mban numrin 006798 deri në 006791 në faqen
5 konkrete 006867.

6 Ju lutem, të kalojmë në seancë private njëkohësisht.

7 Duhet të kalojmë në seancë private.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në
9 seancë private.

10 [Seancë private]

11 [Seancë private teksti i fshirë]

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24 [Seancë e hapur]

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

1 jemi në seancë publike.

2 Z. MISETIC: [Përkthim]

3 PY. Dëshmitar, përpara një jave i keni thënë ZPS-së dhe për
4 procesverbal këtë e keni thënë në shënimin përgatitor që
5 komandantët e zonave janë revoltuar kur mësuan që jeni
6 zëvendëskomandant dhe këtë e keni thënë në paragrafët 52 deri
7 në 55. Po ashtu ju kujtuat rastin kur Ramush Haradinaj ka
8 shtënë në ajër. A ju kujtohet t'ia keni thënë ZPS-së këtë në
9 seancën përgatitor, Dëshmitar?

10 PË. Po.

11 PY. Në paragrafin 55 të Shënimit Përgatitor numër 2, ju keni
12 thënë që këtë e keni parë si grusht ushtarak. A ju kujtohet që
13 ia keni thënë këtë ZPS-së përpara një jave?

14 PË. Po, kështu e kam konsideru.

15 PY. Në rregull. Ju keni qenë zëvendëskomandanti dhe për
16 historik bëhet fjalë për një periudhë ku ju thoni në seancën
17 përgatitore që ju edhe Azem Syla, të dy, u detyruat që të
18 jepnit dorëheqjen. Domethënë, ju dhatë dorëheqjen si
19 zëvendëskomandant, ndërkohë që Azem Syla dha dorëheqjen si
20 komandant i përgjithshëm, pra, në shkurt të '99-s, a është e
21 vërtetë kjo, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

22 PË. Po, në një mbledhje të Shtabit të Përgjithshëm, mbas asaj
23 revoltës së komandantëve të zonave operative, kemi ofruar
24 dorëheqjen Azem Syla, unë dhe Jakup Krasniqi.

25 PY. Në rregull. Kur ju patë atë çfarë përshkruani si grusht,

1 pse ti vetë dhe Azem Syla disiplinuat komandantët e zonës, pse
2 nuk i disiplinuat këta komandantë të zonës dhe pse nuk i
3 arrestuat ata, për shembull, që u përpoqën që të përfshiheshin
4 në një grusht ushtarak, pse nuk e bëtë këtë gjë?

5 PË. [E pakuptueshme] kishte me qenë një tragjedi për vetë të
6 qenit për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Ne nuk kemi mujt me
7 hi në konflikt me komandantët e zonave për arsye se ata kanë
8 pas një autoritet të madh tek ushtarët dhe te vartësit e tyre,
9 kështu që realisht ne e kemi pranuar si kërkesë të tyre dhe nuk
10 kemi dashur që të shkaktohet ndonjë përçarje mes Ushtrisë
11 Çlirimtare të Kosovës.

12 PY. Dëshmitar, unë do bëj një përmbledhje për ju, dëshminë që
13 ka dhënë Bislime Zyrapi i cili e ka dhënë dëshminë, duke thënë
14 kështu në faqen 17657 deri në 17660 se ka pasur një takim
15 fillestar ku prania juaj në takim ka shkaktuar që z. -- e bëri
16 z. Haradinaj që të largohej nga takimi dhe ka thënë që nuk do
17 të vazhdonte të qëndronte në takim në qoftë se ju do të
18 vazhdonit të ishit i pranishëm aty. A ju kujtohet të këtë
19 ndodhur kështu, Dëshmitar?

20 PË. Po në një takim që e ka thirr Bislime Zyrapi në Likoc,
21 prezenca ime aty ka ngjallë këtë reagim te komandantët e
22 zonave dhe -- po Ramushi e mori përsipër që të marrë fjalën
23 dhe të dalë i revoltuar duke gjuajtur edhe me armë brenda
24 objektit të -- ku ne qëndronim.

25 PY. Si rezultat i kushteve të tij ka pasur një takim tjetër,

1 domethënë, pas këtij takimi për të cilin po flasim u
2 organizuar një tjetër takim ku ju nuk ishit i pranishëm, a
3 është e saktë kjo, Dëshmitar?

4 PË. Nuk e di nëse ka pas ndonjë takim tjetër.

5 PY. Në rregull. Le të shohim një dokument dhe pastaj do ju
6 bëj pyetje në qoftë se dini ndonjë informacion lidhur me
7 takimin që është organizuar më pas.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Bëhet fjalë për provën P00182 në
9 faqen SPOE00226397 në shqip dhe në anglisht.

10 PY. Mund të shikoni se çfarë është shkruar në fletën që keni
11 përpara. Domethënë, këtu thuhet se kush ka qenë i pranishëm në
12 takim. Emrat janë Ramush Haradinaj, Rrustem Mustafa, Ekrem
13 Rexha, Sylejmani Selimi, ndërkohë që përfaqësuesit e Shtabit
14 të Përgjithshëm janë Rexhep Selimi dhe Bislir Zyrapi. A e
15 shihni këtë, Dëshmitar?

16 PË. Po.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë te faqja tjetër.

18 PY. Flet Ramushi dhe thotë:

19 "Sokol Bashota thotë që atij -- ai nuk i beson
20 udhëheqjes."

21 A e dini për çfarë mund ta ketë pasur fjalën Ramushi
22 këtu? A keni shprehur ju ndonjëherë ndonjë mendim ose opinion
23 për mungesë besimi ndaj udhëheqjes?

24 PË. Jo.

25 PY. A e keni idenë se për çfarë mund ta ketë fjalën ai kur e

1 kanë thënë këtë?

2 PË. Jo, nuk e di, nuk e di.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull. Kalojmë te faqja
4 tjetër.

5 PY. Komandant Remi thotë:

6 "Në të gjitha zonat operative ne përballemi me probleme
7 të ngjashme."

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Vazhdojmë te faqja tjetër.

9 PY. Po ashtu ai thotë që e mbështet plotësisht atë çfarë
10 thotë Ramushi në fjalën e vet. Më pas në këtë faqe ai thotë:

11 "Propozoj Bislim Zyrapin për postin e komandantit të UÇK-
12 së. Personalisht nuk kam asnjë ambicie për asnjë pozicion.

13 "Ne dhe Shtabi i Përgjithshëm jemi të gjithë përgjegjës
14 për këtë situatë dhe nuk do të heshtim më!"

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Vazhdojmë te faqja tjetër.

16 PY. "Kam mendimin që duhet të caktohet komandant një
17 profesionist të cilin -- i cili të na raportojë ne, që të na
18 mbajë të informuar."

19 Ndërkohë që Sylejman Selimi thotë:

20 "Emërimet që janë bërë në Shtabin e Përgjithshëm janë
21 çështje shqetësuese. (Sokol Bashota dhe Jakup Krasniqi).

22 Mendoj se Sokol Bashota nuk bën për postin e
23 zëvendëskomandantit. Shtabi i Përgjithshëm e ka injoruar
24 kërkesat e bëra lidhur me këtë gjë."

25 A keni qenë i informuar ju në atë kohë që disa prej

1 komandantëve të zonës si për shembull, Ramush Haradinaj dhe
2 Syljeman Selimi nuk ishin të kënaqur që ju ishit i emëruar si
3 zëvendëskomandant dhe i kishin dërguar kërkesa të mëparshme
4 lidhur me këtë pakënaqësi Shtabit të Përgjithshëm? A keni qenë
5 në dijeni të këtyre, Dëshmitar?

6 PË. Këtë ma ka thënë Bislam Zyrapë më vonë.

7 PY. A të tha ty ai se çfarë problemi kishit ata me aty;
8 domethënë, pse ishin kaq kundër jush, çfarë argumentesh
9 kishin?

10 PË. Më thënë të drejtën unë nuk e -- ndonjë argument bindës
11 mu personalisht nuk e kanë pas kurrë se ata nuk kanë qenë as
12 më trima as më të fortë sesa unë. Por më tepër i kam
13 konsideruar si një ambicie egoiste e tyre për të marrë
14 udhëheqjen e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Fillimisht nuk
15 e kam fsheh edhe idenë se mund të jenë -- mund të jetë
16 pikërisht ajo shërbimi i mfshehtë i Serbisë që ka mujt me fut
17 këtë përçarje, por këtë dilemë e kam hjek për shkak se të
18 gjitha këta komandantë të zonave në historinë e tyre, në
19 biografinë e tyre konsiderohej se nuk i takojnë asaj kategorie
20 që bien pre e kësaj propagande, por në fund e kam kuptu vetëm
21 si një egoizëm, një ambicie egoiste e tyre, jo më shumë

22 PY. Në rregull. Në përgjigjen që dhatë përmendët se ata donin
23 që të merrnin udhëheqjen e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.
24 Në paragrafin 180 të dosjes paraprake Prokurori i Specializuar
25 pretendon që Sylejman Selimi në fakt u komandant i

1 përgjithshëm i UÇK-së në fund të shkurtit '98-s. A është e
2 saktë kjo?

3 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtojmë. E thatë gabimisht
4 se bëhet fjalë për shkurtin e '99-s.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, keni të drejtë. Ju kërkoj
6 ndjesë.

7 Z. MISETIC: [Përkthim]

8 PY. Është fakt apo jo, Dëshmitar, që Sylejman Selimi u bë
9 komandant i përgjithshëm i UÇK-së në shkurt të '99-s?
10 PË. Po.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani kalojmë në faqen 404.

12 PY. Këtu kam përshtypjen që përsëri vazhdon dhe flet Sylejman
13 Selimi:

14 "Në qoftë se Sokol Bashota dhe Jakupi vazhdojmë që të
15 qëndrojnë në këto poste, unë nuk do t'i raportoj Shtabit të
16 Përgjithshëm."

17 A e shikon këtë pjesën, Dëshmitar?

18 PË. Jo, s'e kam unë faqen aty.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë pak më në fund të faqes në
20 versionin shqip. Ja këtu e keni në fund, Dëshmitar.

21 DËSHMITARI: Këtu, po.

22 Z. MISETIC: [Përkthim]

23 PY. Thotë:

24 "Nëse Sokol Bashota mbetet në këtë pozitë dhe Jakupi, unë
25 nuk i referohem Shtabit të Përgjithshëm -- nuk i raportoj

1 Shtabit të Përgjithshëm.”

2 E shikon këtë?

3 PË. Po.

4 PY. Është e saktë, apo jo, që komandantët e zonave e ndienin
5 veten kaq të fuqishëm sa sikur e kishin në dorë vetë ata të
6 vendosnin në qoftë se do i raportonin apo jo Shtabit të
7 Përgjithshëm, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

8 PË. Po.

9 PY. Ata e ndienin që kishin kaq shumë fuqi sa që mund të
10 kushtëzonin raportimin e vazhdueshëm për Shtabin e
11 Përgjithshëm duke bërë emërimë në udhëheqjen e Shtabit të
12 Përgjithshëm të UÇK-së, apo jo? Domethënë, mund të bënë edhe
13 emërimë kaq të fortë ju dukej vetja, kështu?

14 PË. Po.

15 PY. A kam të drejtë unë, a është e saktë që ju nuk keni pasur
16 polici ushtarake për të arrestuar Ramushin ose Sylejman
17 Selimin, a është e saktë kjo?

18 PË. Po, është e vërtetë që s’kemi mujt me bë një veprim të
19 tillë.

20 PY. A është e saktë se marrëdhënia juaj me komandantët e
21 zonave ishte më tepër një marrëdhënie e pëlqimit të
22 ndërsjellët, reciprok midis jush për të punuar së bashku, a
23 është kështu, Dëshmitar?

24 PË. Po, në të shumtën e rasteve më tepër mbi bazat e
25 mirëbesimit, por që unë realisht në zonat nuk i kam vizitu

1 vetë. Asnjëherë. Por më tepër në ato fillime ka pas mirëbesim.
2 Komandantët e zonave gati në të gjitha rastet janë zgjedhur
3 brenda zonës.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë te faqja 407 në
5 dokument.

6 PY. Përsëri këtu flet Sylejman Selimi dhe thotë:

7 "... Unë nuk do i përgjigjem asnjë kërkesë dhe nuk do ju
8 informoj. Madje as në pozitën edhe si pozitë dhe në pozitën
9 time si Komandant i Zonës Operative do të kundërshtoj, do të
10 kontestohet.

11 Pastaj do t'i përgjigjem çdo detyrë që më ngarkohet. Në
12 të kundërtën do ta kontestoj çdo urdhër."

13 Si e keni kuptuar ju -- si e kuptoni ju këtë që shkruhet
14 këtu, Dëshmitar?

15 PË. Ka vazhdu vetëm me kundërshtime dhe urdhrin e tina për në
16 raport me mua dhe Jakup Krasniqin dhe Azem Sylën.

17 PY. A është -- a e kuptoj saktë që ai vazhdon e thotë që nuk
18 do jetë mbështetës derisa të përmbushen kërkesat e tij, e
19 kuptoj saktë këtë?

20 PË. Po, po.

21 PY. A pajtoheni me mua që kompetenca ose fuqia e vërtetë në
22 UÇK na fillimi i '98-s, madje edhe përpara kësaj kohe deri të
23 paktën në këtë takim për të cilin po flasim e kishin
24 komandantët e zonës?

25 PË. I nderuar avokat, e kam thënë edhe më herët se fuqia e

1 komandantëve të zonës ka qenë absolute në zonën që ata kanë
2 operu, por edhe bashkimi i tyre ka mujt me bo ndryshime siç ka
3 bë edhe në kreun e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

4 PY. Në rregull. Faleminderit.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund ta hiqni dokumentin nga
6 ekrani.

7 PY. Dëshmitar, tani do të kalojmë te një tjetër temë. Bëhet
8 fjalë për fazat e para të UÇK-së dhe duam që të diskutojmë
9 lidhur me këtë temë.

10 Keni dhënë dëshmi në provën P1875 në faqen 67709 që keni
11 marrë pjesë në një mbledhje në Shqipëri me Azem Sylën, Xhavit
12 Halitin, Xheladin Gashin, Ali Ahmetin dhe një person tjetër.
13 Besoj në dhjetor të '93, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

14 PË. Po, e kam dhënë këtë dëshmi, por unë nuk e kam thënë këtë
15 se ky deklaram.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Është një
17 intervistë e Azem Sylës. Nuk e keni thënë ju. Ju kërkoj
18 ndjesë.

19 PY. Megjithatë pyetja ime është kjo: Ky informacion a është i
20 saktë, Dëshmitar?

21 PË. Informacioni pjesërisht është i saktë se Azem Sylë aty
22 thotë se aty është formuar Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Unë
23 nuk jam në dijeni që është folur aty për krijimin e Ushtrisë
24 Çlirimtare të Kosovës.

25 PY. Në rregull. Megjithatë, mendoj se ju këtu thoni, dhe e

1 kam fjalën për provën P1870.1 në faqet 9, rreshti 8 deri në

2 10. Ju bëhet pyetja:

3 "Në '97 keni shkuar në Drenicë dhe atëherë a ishte e
4 qartë për ju që do të kishte një konflikt të armatosur?"

5 Dhe ju jeni përgjigjur:

6 "Po."

7 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

8 PË. Nuk e kuptova pyetjen mirë, më fal. Unë kam shku në '97
9 në Drenicë. A muj me.

10 PY. Po, dhe sipas pyetjes që ju kanë bërë, pra, juve pyeteni
11 në qoftë se ju në atë kohë a mendoni që do të kishte një
12 konflikt të armatosur dhe në përgjigje ju keni thënë, "po." A
13 ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

14 PË. Atëherë ka qenë periudhë e konsideroj fillimit të luftës
15 dhe patjetër që ka mujt me pas.

16 PY. Ju keni thënë që Nait Hasani ka qenë një prej personave
17 në strukturën e UÇK-së në '97, a është e saktë kjo, Dëshmitar?
18 Deri në burgosjen e tij, a është kështu?

19 PË. Po.

20 PY. Kjo ju bëri juve që të shkonit në Drenicë. Domethënë,
21 arrestimin e Nait Hasanit ju bëri që të shkonit në Drenicë që
22 ju e konsideroni që ishte një zonë e çliruar atëherë, a është
23 kështu, Dëshmitar?

24 PË. Unë shtëpinë e kam në zonë të Drenicës në fshat ngjit me
25 Drenicën dhe një pjesë e asaj kohe e kam bë edhe në shtëpinë

1 për arsye se kemi qenë të vëmendshëm unë me vllazërit e mi,
2 duke bërë roje që të mos vinin forcat e policisë për të na
3 kapur, por një pjesë të kohës e kam bërë edhe te dajat e mi edhe
4 te familjarët të kam pas në Drenicë.

5 PY. Në rregull. Në këtë kohë dhe tani po i referohem Seancës
6 Përgatitore numër 2, paragrafët nga 36 deri në 38. Ju i thatë
7 Prokurorisë që në këtë periudhë, domethënë në vitin 1997,
8 personat kryesorë të asaj çfarë më pas u bënë anëtarë të
9 Shtabit Qendror ishin Azem Sylja, Xheladin Gashi, Nait Hasani,
10 Xhavit Haliti dhe ju vetë, a është e saktë kjo?

11 PË. Po.

12 PY. A e konfirmoni që ju nuk e keni përmendur Hashim Thaçin
13 si një prej personave që kanë qenë anëtarë, që ka qenë anëtar
14 i Shtabit Qendror, e saktë është kjo, Dëshmitar?

15 PË. Po.

16 PY. Ai nuk u bë anëtar i Shtabit Qendror ose Shtabit të
17 Përgjithshëm deri në vitin 1998, apo jo, Dëshmitar?

18 PË. Hashim Thaçi, me sa unë e di, është bërë mbas operimit të
19 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës si anëtar i Shtabit. Është fol
20 në mbledhjen e që e kemi pas në Negroc. Por realisht nuk ka
21 mujt me ushtru funksionet se ai ka lëvizur edhe në Shqipëri
22 disa herë. Por zyrtarisht anëtar i Shtabit të Përgjithshëm
23 është bërë në fund të vitit '98, mbas strukturimit të Ushtrisë
24 Çlirimtare të Kosovës.

25 PY. Në rregull. Pra, ai zyrtarisht u bë anëtar i Shtabit të

1 Përgjithshëm në nëntor të '98-s, është e saktë kjo?

2 PË. Po.

3 PY. Nëse ju kuptova drejt, ju thatë që ka pasur një bisedë sa
4 i takon atij që të bëhej pjesë e Shtabit të Përgjithshëm dhe
5 kjo bisedë ka filluar në Negroc që i takon që ka qenë diku nga
6 qershori i '98-s, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

7 PË. Po.

8 PY. Besoj që e keni konfirmuar këtë edhe në pyetjet e
9 Prokurorisë, megjithatë dua të jem i sigurt. Nait Hasani është
10 arrestuar në janar të vitit 1997, apo jo, Dëshmitar?

11 PË. Po.

12 PY. Zahir Pajaziti është vrarë në janar të 1997, kështu?

13 PË. Po.

14 PY. Në seancën përgatitor 2 -- Shënimin Përgatitor 2 -- në
15 paragrafët 36 deri në 38 i keni thënë ZPS-së që deri në
16 arrestimit e Nait Hasanit komunikatat janë shkruar nga Nait
17 Hasani dhe Xheladin Gashi, a është e saktë kjo?

18 PË. Ata janë marrë me -- ata më kanë thënë që ne merremi me
19 shkrimin e komunikatave.

20 PY. A e dini në qoftë se Zahir Pajaziti gjithashtu ka lëshuar
21 deklarata publike, domethënë, po i quaj deklarata publike, jo
22 komunikata. A keni dijeni në qoftë se ky person, domethënë,
23 Zahir Pajaziti e ka bërë këtë gjë, pra, ka lëshuar deklarata
24 publike përpara sesa të vritej?

25 PË. Nuk e di.

1 PY. Në rregull. I keni thënë ZPS-së dhe kjo është thënë në
2 Shënimin Përgatitor 1, paragrafi 16, ku thuhet:

3 "Ju asnjëherë nuk keni lëshuar asnjë komunikatë dhe nuk e
4 dini se kush i ka shkruar këto komunikata deri nga
5 pranvera/vera e vitit 1998, deri në fund të luftës, a është e
6 saktë kjo, Dëshmitar?"

7 PË. Po.

8 PY. Në Shënimin Përgatitor 2, në paragrafin 37, thoni:

9 "Shtabi Qendror ende po lëshonte komunikata në vitin
10 1997, megjithatë ju nuk keni qenë pjesë e tyre dhe nuk e keni
11 informacione, nuk keni dijeni se kush i ka lëshuar
12 komunikatat. Megjithatë, përpara arrestimit të tij komunikatat
13 janë shkruar nga Nait Hasani dhe Xheladin Gashi."

14 A është e saktë kjo, Dëshmitar?"

15 PË. Po.

16 PY. Pra, në qoftë se i mbledhim bashkë këto pjesë të seancës
17 përgatitore me Prokurorinë, ju po thoni që ju e dini për
18 përfshirjen e Nait Hasanit në shkrimin e komunikatave, deri
19 kur ai është arrestuar, por më pas ju nuk keni informacion se
20 çfarë ka ndodhur që pas janarit të '97-s deri në fund të
21 luftës; domethënë, ju nuk e keni idenë se kush i ka shkruar
22 këto komunikata, a është e saktë kjo? Dua që

23 PË. Jo, jo, jo.

24 PY. Dua që të jem i qartë. Ju po thoni që jo, nuk e dini, nuk
25 keni njohuri, domethënë, se çfarë ka ndodhur ose kush i ka

1 shkruar komunikatat pas janarit të '97-s, kështu, Dëshmitar?

2 PË. Ka mujt me i shkru Xheladin Gashi me një pjesë tjetër të
3 shtabit, por unë nuk e di. Ose janë shkruar nga jashtë.

4 PY. Dua që të jem i qartë lidhur me këtë pikë. Dëshmia juaj
5 është që pas janarit të '97, ju nuk keni asnjë informacion
6 vetë se kush i ka shkruar komunikatat, duke filluar nga
7 shkurti '97 deri në fund të luftës, a është e saktë kjo,
8 Dëshmitar?

9 PË. Jo, jo, është e saktë.

10 PY. Në rregull. Faleminderit. Keni thënë në pika të ndryshme,
11 për shembull, në një pyetje që ju bëri Prokurori përpara një
12 javë, dhe për procesverbal këtë e keni thënë në faqen e
13 transkriptit 22975, rreshti 12 dhe në faqen 230023 [Sipas
14 përkthimit], rreshti 3 [Sipas përkthimit] që komunikata janë
15 shkruar jashtë shteti, por keni thënë që ju nuk e dini se kush
16 i ka shkruar ato.

17 Po nga e dini ju që komunikatat janë shkruar jashtë
18 shteti në qoftë se nuk e dini se kush i ka shkruar ato?

19 PË. Po se thjesht nuk e -- me njerëz që kam nejt s'më ka
20 thënë dikush që "i kam shkru u". Spekulime ka pas që po
21 shkruhen edhe nga jashtë shteti, por nuk e di nga kush, por di
22 që spekulime ka pas që po shkruhen edhe prej jashtë shtetit.
23 S'e di a nga Shqipëria apo nga Zvicra, po a Gjermania apo ku
24 nga cili vend, veç ka pas spekulime se po shkruhen jashtë
25 shteti.

1 PY. Pra, siç e thatë që ka pas spekulime, a është e saktë që
2 mbështetur në këtë dëshmi që sapo e cekëm bashkë që nuk ka
3 pasur takime të Shtabit të Përgjithshëm për të diskutuar
4 lidhur me përmbajtjen e komunikatave përpara sesa të
5 lëshoheshin komunikatat, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

6 PË. Jo. E saktë është kjo që po thoni, por nuk janë lëshu
7 kështu.

8 PY. Pra, do ishte mirë që të thoni që është "e saktë", se
9 përkundrazi çorientohemi pak me përgjigjen që jepni në qoftë
10 se thoni "jo".

11 PË. Po, po.

12 PY. Ju bë pyetje disa herë se pse nuk i keni korrigjuar
13 komunikatat. Ta bëj paksa ndryshe pyetjen sesa e kisha
14 menduar. Ju personalisht, a keni lëshuar komunikata në '97,
15 '98 dhe '99, Dëshmitar?

16 PË. Komunikata, unë jo.

17 PY. A keni menduar ju që ka qenë detyra jote që të lëshonit
18 komunikata gjatë këtyre tre viteve?

19 PË. Jo.

20 PY. Për pasojë, a do ishte puna jote që të bëje korrigjime të
21 komunikatave të nxjerra gjatë kësaj periudhe?

22 PË. Jo, këtë s'e kam mendu.

23 PY. Në rregull.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani të shohim provën P1D00050 në
25 anglisht, ndërkohë versionin në shqip ka të njëjtin numër.

1 PY. Kjo është Deklarata Politike numër 7 që është lëshuar më
2 13 gusht 1998 ku publikisht është njoftuar se përfaqësimi
3 politik u UÇK-së janë Adem Demaçi, Xhavit Haliti, Bardhyl
4 Mahmuti, Hashim Thaçi, Faton Mehmetaj, Sokol Bashota dhe
5 zëdhënësi i UÇK-së ishte Jakup Krasniqi.

6 Pyetja e parë që kam për ju është kjo, Dëshmitar, është
7 një pyetje e cila ka të bëjë me atë çfarë i keni thënë ZPS-së
8 në paragrafin 42 të Shënimit Përgatitor 2. Faton Mehmetaj
9 është propozuar që të bëhej pjesë e drejtorisë politike, por
10 ai nuk u bë asnjëherë pjesë e kësaj drejtorie. A ia keni thënë
11 këtë gjë ZPS-së, Dëshmitar?

12 PË. Po.

13 PY. Këtu thuhet që Adem Demaçi është emëruar gjithashtu si
14 përfaqësues politik. A e shikoni këtë informacionin? Duhet të
15 jetë diku nga mesi i faqes aty ku është i rrethuar emri juaj.
16 Tek ajo pjesa shikoni.

17 PË. Po këtu nuk e kam emrin e Adem Demaçit.

18 PY. Jo, ju kërkoj ndjesë. E kam fajin unë. Pra, është
19 rrethuar emri juaj, ndërkohë që në qoftë se do shikoni në
20 paragrafin në fund fare të faqes, paragrafi i fundit. Ju
21 lutemi, lexojeni me mendje paragrafin e fundit.

22 PË. Po.

23 PY. A keni marrë pjesë ju në ndonjë takim ku emërimi i Adem
24 Demaçit si përfaqësues politik është diskutuar në atë takim
25 ose në atë mbledhje?

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 132

1 PË. Në këtë takim kur është bë drejtoria politike nuk kam
2 qenë, këtë e kam lexu më vonë. Por që iu kanë dhënë këto
3 kompetenca Demaçit e kam mësu.

4 PY. A keni mësuar lidhur me emërimin tuaj, sa i takon
5 përfaqësuesit politik?

6 PË. Po.

7 PY. Si e keni mësuar?

8 PË. Nuk e di, nuk e di formën se si; nuk e di a më ka thirr
9 dikush prej këtyre shokëve, por e di që -- ose nëpërmes
10 mediave, por e di që iu ka dhënë fuqi e madhe nga Shtabi i
11 Përgjithshëm Adem Demaçit për krijimin edhe të institucioneve
12 dhe për aspektet politike dhe publike të Ushtrisë Çlirimtare
13 të Kosovës.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Kam një pyetje të fundit.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

17 [Përkthim] Do bëjmë pushimin kur të jetë e përshtatshme.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Jam gati duke e përfunduar me këtë
19 takim.

20 PY. Dëshmitar, në qoftë se s'keni qenë në -- pjesëmarrës në
21 takim kur është emëruar Adem Demaçi ose kur nuk keni marrë
22 pjesë në takimin që iu ka emëruar juve, por thoni që e keni
23 mësuar nga media. Atëherë i takon që nuk kemi të bëjmë me një
24 vendim kolektiv ose kolegjal të Shtabit të Përgjithshëm, a
25 është kështu, apo jo?

1 PË. Mungesa, mungesa e një anëtari të Shtabit të Përgjithshëm
2 nuk do të thotë që s'është veprim kolegjal. Kanë mujt me
3 vendos edhe të tjerët. Nuk është që ka pas ndonjë pengesë me
4 këto vendime.

5 PY. Po, por ju nuk e dini se kush ka qenë i pranishëm në këto
6 takime. Ndoshta nuk është se s'keni qenë vetëm ju i pranishëm,
7 mbase s'kanë qenë as të tjerët?

8 PË. Nuk e di, nuk e di.

9 PY. Mund të kenë qenë vetëm Azem Syla personi që i ka bërë
10 këto emërime, apo jo?

11 PË. Ka të ngjarë, nuk e di. Ka mundësi.

12 PY. Tani do të bëjmë pushim. Megjithatë, pas pushimit do të
13 diskutojmë për shembujt të tjerë të vendimeve të cilat mbase
14 nuk janë marrë në mënyrë kolektive.

15 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
17 pushim prej dhjetë minutash, Dëshmitar, tani.

18 Mund të dilni nga salla dhe do kthehemi përsëri për
19 dhjetë minuta.

20 Do bëjmë pushim për dhjetë minuta.

21 --- Seancë ndërpritet në orën 15.32

22 --- Seanca rifillon në orën 15.43

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
24 silleni dëshmitarin në sallë.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Për procesverbal, doja të njoftoj

1 palët edhe Trupin Gjykues që do kërkojmë një verifikim
2 përkthimi të transkriptit të sotëm për faqen 108, rreshtat 22
3 dhe 23. Është fjala "themelim", fjala "themelim" është një
4 fjalë që duhet të ketë qenë "ristrukturim" dhe kërkojmë
5 verifikim transkripti.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
7 Faleminderit.

8 Do të mbaroni brenda kësaj seance?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Fatkeqësisht jo.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk po ju
11 thoja që duhet të mbaroni. Thjesht isha i interesuar të dija
12 se kur do të përfundonit.

13 [Dëshmitari vijon dëshminë]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë. Z.
15 Misetic, fjala është ende për ju.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

17 PY. Dëshmitar, vazhdojmë aty ku e lamë. Ju thatë që nuk e
18 dinit se kush i lëshonte komunikatat nga shkurti i 1997-s e
19 deri në fund të luftës. A do të thotë kjo se përmbajtja e
20 komunikatave nuk ishte një vendim kolegjal i Shtabit Qendror
21 apo Shtabit të Përgjithshëm?

22 PË. Nuk e di kush i ka lëshu. Nuk kemi marrë ndonjë vendim
23 specifik në mbledhje të Shtabit të Përgjithshëm për lëshimin e
24 komunikatave, mesa unë e mbaj mend, nuk e di që ka pas një
25 vendim.

1 PY. Po, po. Po unë po të them këtë, po përpiqem që të them
2 këtë gjë, kushdo që i lëshonte këto komunikata nuk i lëshonte
3 këto komunikata duke u pajtuar paraprakisht me ju apo me
4 anëtarë e tjerë të Shtabit të Përgjithshëm apo Shtabit Qendror
5 sa i takon përmbajtjes, nuk kishte përmbajtja një vendim
6 kolegjial apo i përbashkët?

7 PË. Jo, nuk ishte.

8 PY. Tani, të kuptojmë në sa mbledhje të Shtabit të
9 Përgjithshëm keni qenë ju në 1998-n. Në Shënimin Përgatitor
10 numër 2, paragrafët 46 deri në 49, ju keni thënë, keni folur
11 për një mbledhje në Negroc në shtëpinë e z. Krasniqi në
12 qershor të 1998 dhe keni thënë që atje ka qenë z. Krasniqi, z.
13 Rexhep Selimi, z. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Lahi Brahimaj
14 dhe unë personalisht, saktë?

15 PË. Po.

16 PY. Javën e kaluar, në transkriptin e seancës në faqen 23021,
17 rreshtat 22 dhe 23, keni thënë se nuk mund ta quanit këtë
18 tamam-tamam në kuptimin e mirëfilltë një mbledhje të Shtabit
19 të Përgjithshëm. Pse nuk mund ta quanit këtë një mbledhje të
20 Shtabit të Përgjithshëm?

21 PË. Për arsye se këta emra nuk kanë qenë publik kurrë, s'janë
22 bë publik për opinionin kurrë dhe nuk kam mujt me i ushtru
23 funksionet e tona për të cilat dhe është fol. Me thënë të
24 drejtën unë mbasi jam ardh këtu i kam pa këto funksione të
25 cilat janë shkruar në -- që më janë paraqit.

1 PY. Në rregull. Azem Syla nuk ka qenë i pranishëm në këtë
2 takim, saktë?

3 PË. Jo. Jo.

4 PY. A mund të merrnit ju një vendim kolektiv pa qenë i
5 pranishëm komandanti i përgjithshëm në këtë mbledhje?

6 PË. Nuk e di nëse ka pas kontakt dikush me Azem Sylën. Por e
7 di që në atë mbledhje është përcaktu vetëm zëdhënësi, për
8 shkak të propagandës që është, fillojë me u rritë kundër
9 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe thjesht kemi dashur që ta
10 kemi një adresë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ku
11 pasqyrohen politikat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

12 PY. Në këtë mbledhje a është diskutuar çështja e
13 bashkëpunëtorëve?

14 PË. S'e besoj, jo.

15 PY. A është diskutuar çështja e komunikatave?

16 PË. Jo. Jo.

17 PY. Në paragrafin 49 të Shënimit Përgatitor 2 i keni thënë
18 ZPS-së se nuk ju kujtohet të ketë pasur ndonjë mbledhje tjetër
19 të Shtabit të Përgjithshëm në muajin qershor 1998, saktë?

20 PË. Nuk më kujtohet. S'më është kujtu.

21 PY. Po në mars të 1998 a ka pasur ndonjë mbledhje?

22 PË. S'e di. S'e besoj. Mesa unë e di, jo.

23 PY. Prill i 1998-s, ndonjë mbledhje?

24 PË. S'e mbaj mend.

25 PY. Po në maj të 1998-s?

1 PË. Nuk e besoj.

2 PY. Mirë. Flasim për korrikun tani.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Vendosim në ekran provën materiale
4 me numër P00643.

5 PY. Dëshmitar, ky dokument pretendohet se është një
6 procesverbal i mbledhjeve të UÇK-së në korrik të 1998-s. Data
7 e parë është data 9 korrik 1998, pra, një mbledhje në këtë
8 datë ku thuhet:

9 "Merret vendim për shpërndarjen e rregulloreve ...

10 "Krijimin e formacioneve nga të gjitha nivelet në
11 kompani.

12 "Xhavit Haziri caktohet që të merret me rregulloren GS.

13 "Intervista me ..."

14 Pastaj është e paqartë, këtu është e padeshifrueshme.

15 A ju kujtohet të keni qenë në ndonjë mbledhje ku janë
16 diskutuar këto tema në korrik të 1998?

17 PË. Jo, nuk ka qenë në këtë takim. Kam pas dhe një arsye
18 familjare. Se në fund të qershorit më ka vdekur prindi, babai
19 dhe jam marrë kryesisht me punë të familjes. Dhe nuk më
20 kujtohet ky dokument.

21 PY. Dëshmitar, ne këtë e trajtuam edhe kur dhatë dëshmi z.
22 Zyrapi, po të shohim nëse mund të na ndihmoni ju me diçka.

23 Është një fjali në shqip dhe aty ku duket Xhavit Haziri. E
24 lexoni dot fjalinë këtu ku përmendet emri Xhavit Haziri?

25 PË. Po. Vetëm vetë Haziri në -- te paragrafi i parë?

1 PY. Po. Ju lutem lexojeni me zë fjalinë ku përmendet Xhavit
2 Haziri.

3 PY. "Në këtë mbledhje ...", nuk e di më tepër, "në SHP ka
4 qenë caktuar Xhavit Haziri ..."

5 Nuk është shkrimi jem, s'po muj me e dëshifru. Këtu s'muj
6 e di këtu "Në këtë mbledhje për" shka është kjo. Është shkrim
7 dore dhe nuk po muj me e dëshifru.

8 PY. Mesa dini ju, Xhavit Haziri a është emëruar ndonjëherë
9 shef shtabi?

10 PË. Jo, nuk e di.

11 PY. Shtabit të Përgjithshëm ë?

12 PË. Jo, nuk e di.

13 PY. Në rregull. Pra, ju nuk keni qenë i pranishëm në këtë
14 mbledhje, po a keni qenë i pranishëm në një mbledhje tjetër ku
15 janë diskutuar rregulloret?

16 PË. Ka mundësi, po nuk e di saktë për cilat rregullore, po ka
17 mundësi. Kryesisht rregulloret i binte Bislīm Zyrapi si oficer
18 i karrierës, por për të cilat rregullore nuk e di.

19 PY. Do të jem më konkret. Përpara ristrukturimit, a ju
20 kujtohet ju konkretisht të jetë bërë ndonjë diskutim në
21 mbledhje të Shtabit të Përgjithshëm për rregullore?

22 PË. Nuk më kujtohet. Tash është -- jemi njerëz. 25 vite kanë
23 shku nga ajo kohë dhe mund të ngatërrohem ndoshta me këtë
24 pjesën e dytë të ristrukturimit të UÇK-së, por nuk e di saktë.
25 E di që ne para ristrukturimit, para ardhjes së Bislīm

1 Zyrapi, si oficer i karrierës dhe oficerëve të tjerë të
2 karrierës, nuk kemi pas shumë njohuri rreth rregulloreve
3 ushtarake. Nuk më kujtohet me thënë drejtën.
4 PY. Shohim më poshtë në dokument dhe shohim që përmendet një
5 datë 23 korrik 1998.

6 "Bislim Zyrapi vjen në shtab dhe merr pozicionin e
7 kryetarit -- drejtuesit - më falni - të drejtorisë operative.
8 Diskutohet rasti i Rahovecit. Pika e mbrojtjes ra në një grup
9 sabotazhi ..." është e palexueshme, pastaj thotë "... në nivel
10 komande ishin ushtarët e 'Çelikut' ..."

11 A ju kujtohet ju të keni marrë pjesë në një takim në
12 datën 23 korrik 1998 ose me përfaqësi afër kësaj date kur qe
13 diskutuar ofensiva e Rahovecit?

14 PË. Rahoveci si ngjarje që ka ndodhë e di që ka qenë pa
15 miratimin dhe pensimin e Shtabit të Përgjithshëm. Është
16 diskutu në një nga mbledhjet ku Bislim Zyrapi është ngarku që
17 të merret më tepër me këtë informacionin e ofensivës së
18 Rahovecit, por në cilën datë nuk e di.

19 PY. A e dini kush ka qenë tjetër i pranishëm kur është
20 diskutuar kjo temë? Pra, keni qenë ju, ka qenë Bislim Zyrapi,
21 po tjetër kush ka qenë i pranishëm?

22 PË. Të tjerët nuk i di, po ka pas anëtarë të Shtabit të
23 Përgjithshëm në atë takim. Po s'po muj me i mbajt mend me emër
24 të them të drejtën.

25 PY. Në rregull. Shënime, të paktën në këto shënime nuk

1 flitet as për bashkëpunëtorët dhe as për komunikatat. A
2 përputhet kjo dhe me kujtesën tuaj lidhur me këtë mbledhje?
3 PË. Po.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim një faqe tjetër.

5 PY. Ndërkohë me përjashtim të këtyre dy mbledhjeve që janë
6 pasqyruar këtu, a ju kujtohet ju ndonjë mbledhje tjetër e
7 Shtabit të Përgjithshëm në korrik të 1998?

8 PË. S'më kujtohet.

9 PY. Flasim tani për gushtin. Këtu përmendet një mbledhje më
10 16 gusht të 1998s-, UÇK, Shtabi i Përgjithshëm:

11 "Në këtë mbledhje raportohet për situatën, gjendjen
12 operative në terren pas ofensivës së parë me përmasa të mëdha
13 në Drenicë, e cila vijojë më tej në Dukagjin ku pati luftime
14 të ashpra. Në këtë mbledhje u fol për luftën speciale dhe
15 veprimet e organizuara të qëllimshme dhe të oficerëve të FARK-
16 ut të cilët përfaqësoheshin nga Tahir Zemaj dhe veprimet që
17 kishin ndërmarrë këta persona kundër UÇK-së dhe luftës në
18 përgjithësi.

19 "Në këtë takim është folur gjatë e gjerë për emërimet e
20 komandantëve në zonat operative të UÇK-së, formimin e
21 brigadave dhe emërimin e komandantëve të tyre."

22 A ju kujtohet kjo mbledhje? Ose fillimisht desha t'ju
23 pyes a keni qenë i pranishëm?

24 PË. Nuk e di. Ndoshta, po s'më kujtohet të them të drejtën.

25 Jo, s'e di.

- 1 PY. A ju kujtohet konkretisht të keni qenë i pranishëm?
- 2 PË. Jo, s'më kujtohet. Jo, s'më kujtohet.
- 3 PY. Më lejoni të përfundoj pyetjen, ju lutem.
- 4 PË. Okej. Më fal.
- 5 PY. A ju kujtohet specifikisht të ketë pasur ndonjë mbledhje
6 të Shtabit të Përgjithshëm ku të jetë diskutuar çështja e
7 Tahir Zemajt?
- 8 PË. Për çështjen e Tahir Zemajt kam ni kështu në periferi
9 prej njerëzve tjerë, jo, jo në Shtabin e Përgjithshëm. S'e
10 besoj që kam dëgju në Shtabin e Përgjithshëm diçka për Tahir
11 Zemajn. Kjo s'më kujtohet.
- 12 PY. A ju kujtohet të keni qenë i pranishëm në ndonjë mbledhje
13 ku të jetë diskutuar lufta speciale?
- 14 PË. Tash është zor me mendu për atëherë se çfarë diskutimesh
15 kemi pas saktë, por që ka pas luftë speciale kundër Ushtrisë
16 Çlirimtare të Kosovës kjo është ditë. Ka mundësi që kam qenë
17 në ndonjë takim të tillë. Por nuk e di a është marrë përmes --
18 idenë a e ka marrë përmes komunikatave, a përmes shtypit apo
19 kam qenë unë në një takim të tillë, nuk muj me dit saktë. Nuk
20 po e them, nuk po e përjashtoj mundësinë që kam qenë edhe në
21 mbledhje të shtabit. Po që s'po më bien ndërmend.
- 22 PY. Si e kuponi ju termin "luftë speciale"?
- 23 PË. Tash edhe muj me gabu në definicion, po propaganda
24 kundër, kundër vlerave që ti ofron. Një propagandë që e bëjnë
25 të tjerët për të degradu punën që e bën ti ose organizata për

1 të cilën ti përfaqëson. Kështu e kuptoj.

2 PY. Po -- jo do t'jua bëj ndryshe. Me përjashtim të mbledhjes
3 së mundshme së 16 gushtit, ju kujtohet ju specifikisht të keni
4 marrë pjesë në ndonjë mbledhje tjetër në gusht të 1998-s?

5 PË. Muajt nuk i di në cilët muaj kemi marrë pjesë, por në
6 disa mbledhje kemi marrë, po nuk e di tash saktë në cilën me
7 thënë drejtën. S'e kam memorien e freskët për të kujtu në sa
8 mbledhje dhe në çilat mbledhje kam qenë unë realisht.

9 PY. Do t'ju bëj një pyetje tjetër. Në korrik të 1998-s, ju
10 personalisht, ku qëndronit?

11 PË. Unë në korrik në fshatin tim, për arsye se aty patën dalë
12 pozicionet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kanë dalë
13 publikisht. Domethënë mbi fshatin Kievë është kriju një vijë
14 ndarëse mes pozicioneve serbe dhe UÇK-së dhe aty kemi nejt
15 brenda territorit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ka qenë
16 një vatër e nxehtë mund ta quajmë, se ishte pozicioni mbi
17 Kievë dhe ishte pika e parë për t'u futë prej jugut në Drenicë
18 nga forcat serbe. Kryesisht kam nejt në fshatin tim të
19 lindjes.

20 PY. Mesa keni ju dijeni, ku ka qenë selia e Shtabit të
21 Përgjithshëm në muajin korrik?

22 PË. Në Divjakë ne e kemi pas një shtëpi, e cila është
23 përdorur prej ilegales. Se ka qenë një burrë i mirë që nuk ka
24 hezitu me e lëshu atë shtëpi për njerëz të cilët kanë qenë të
25 rrezikuar. Edhe prej atëherë ne e kemi përdorur atë shtëpi

1 herë pas here në Divjakë. Nezir Zogaj ka qenë pronari i asaj
2 shtëpie e cila më vonë është rrethuar nga forcat serbe.
3 PY. Flasim tani për shtatorin. Kjo është periudha që besoj se
4 pajtoheni me mua, periudha korrik, gusht, shtator edhe në
5 tetor madje është pikërisht periudha kur po ndodhnin ofensivat
6 serbe, apo jo?

7 PË. Po. Atëherë ka pas një dinamikë më të madhe të shtuar të
8 ofensivave serbe përgjatë vijës prej Komoranit e deri në
9 Klinë, por edhe në territore tjera, në zona tjera ka pas
10 luftime.

11 PY. Ju kujtohet ndonjë mbledhje e Shtabit të Përgjithshëm në
12 të cilën keni marrë ju pjesë në shtator të 1998?

13 PË. I nderuar Avokat, po më qitni pak në siklet me mendu
14 vërtetë muajt. Nuk e di. S'po e përjashtoj mundësinë që kam
15 qenë në takim, por nuk po e di për cilat takime. Herë pas here
16 kemi shku. Herë pas here kemi shku në mbledhjet e Shtabit të
17 Përgjithshëm. Kanë qenë të organizuara mbledhjet e Shtabit të
18 Përgjithshëm, por kryesisht ma me dinamikë kanë qenë mbas
19 strukturimit, mbas strukturimit të UÇK-së, pasi ka ardhë
20 Bislimi. Tjerët na jemi marrë ma tepër me çështje teknike të
21 asaj kohe.

22 PY. Ka ngelur dhe një muaj, është tetori. Do t'ju bëj disa
23 pyetje për tetorin dhe nëse ka pasur mbledhje në tetor. Besoj
24 ju e dini që marrëveshja Holbrooke-Milosevic për armëpushimin
25 u negociua dhe hyri në fuqi rreth mesit të tetorit 1998,

1 saktë?

2 PË. Po, kështu është.

3 PY. Ju personalisht keni marrë pjesë në ndonjë takim ku u ra
4 dakord mbi kushtet e armëpushimit?

5 PË. Ka mundësi. Ka mundësi që kam qenë. Nuk po e mbaj mend
6 saktë.

7 PY. Nuk ju kujtohet po. Pra, nuk ju kujtohet që të jetë
8 mbledhur Shtabi i Përgjithshëm dhe të ketë thënë duhet të
9 respektojmë armëpushimin edhe duhet t'u kërkojmë trupave tonë
10 që ta respektojnë këtë marrëveshje?

11 PË. Jo, jo, saktë nuk e mbaj mend. Thjesht nuk e mbaj mend. E
12 di që u shpall një armëpushim edhe nga ana e UÇK-së, por nuk e
13 di a është bërë përmes komunikatës apo ka qenë një takim i
14 mbledhjes së Shtabit të Përgjithshëm. Këtë s'e mbaj mend.

15 PY. Do e marr hap pas hapi. Ju, personalisht, nuk ju kujtohet
16 që të jetë diskutuar respektimi i marrëveshjes për armëpushim
17 në nivel të Shtabit të Përgjithshëm. E kuptova drejt?

18 PË. Jo. Po. S'më kujtohet.

19 PY. Bazuar në dëshminë e mëparshme që keni dhënë ju keni
20 thënë që nuk e dinit se kush i lëshonte komunikatat, që do të
21 thotë që ju nuk e dini nëse është lëshuar ndonjë komunikatë ku
22 diskutohej çështja e armëpushimit apo respektimi i
23 armëpushimit, saktë?

24 PË. Saktë.

25 PY. Tani do flasim për një ngjarje tjetër që ka ndodhur në

1 fund të tetorit.

2 Z. MISETIÇ: [Përkthim] Për këtë do të kërkoja që të
3 vendosej në ekran materiali me numër 1D00166 me -ET për
4 anglishten, por do të doja të shfaqej dhe shqipja në ekran.
5 Faqja 2.

6 PY. Dëshmitar, ju lutem shiheni këtë dokument. Është pranuar
7 tani si provë gjyqësore, është një marrëveshje kjo që është
8 arrirë mes përfaqësuesve të FARK-ut dhe atyre të UÇK-së për të
9 bashkuar forcat. Besoj se takimi është mbajtur më 31 tetor të
10 1998, por më duket se nënshkrimin e ka 2 nëntor të 1998, është
11 nënshkruar më 2 nëntor.

12 E njihni këtë marrëveshje?

13 Z. MISETIÇ: [Përkthim] Shkojmë në faqen e fundit se mund
14 t'ju shërbejë për ta rikujtuar. Jo, ju kërkoj ndjesë. Jo në
15 faqen e fundit.

16 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

17 Z. MISETIÇ: [Përkthim] Në faqen 4. Në faqen 4 të
18 marrëveshjes.

19 PY. Ka një shtojcë kjo marrëveshje ku është rënë dakord që
20 komandant do të ishte Agim Çeku dhe ju do të ishit
21 zëvendëskomandant, po ashtu Ismet Alia do të ishte një nga
22 zëvendëskomandantit. A e njihni këtë marrëveshje?

23 PË. Jo. Për herë të parë po e shoh.

24 PY. Ju nuk keni qenë në dijeni që sipas kësaj marrëveshjeje
25 shefi i shtabit i UÇK-së do bëhej Bislum Zyrapi? Nuk e keni

1 parë asnjëherë -- do ta bëj ndryshe pyetjen. Në përgjithësi a
2 keni qenë i informuar që kishte një marrëveshje midis FARK-ut
3 dhe UÇK-së për t'u bashkuar?
4 PË. Më aq sa më ka fol Bislum Zyrapi rreth asaj
5 marrëveshjeje, unë e kam kuptu se marrëveshja ka qenë për të
6 ju bashkuar FARK-u Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me të gjithë
7 oficerët të cilët dëshirojnë me hy në Kosovë, si dhe ushtarët
8 e FARK-ut të hyjnë nën emblemen e Ushtrisë Çlirimtare të
9 Kosovës.

10 Kaq kam marrë informacion nga Bislum Zyrapi dhe këto
11 emërime që shoh unë këtu, këtu për herë të parë po i shoh. Nuk
12 i kam pa më herët dhe nuk kam qenë pjesë e kësaj marrëveshje
13 ma herët.

14 PY. Në qoftë se marrëveshja është e re për ty dhe në qoftë se
15 ti nuk e ke parë më përpara, atëherë është e drejtë që unë të
16 përfundoj, të arrij në përfundimin që kjo marrëveshje nuk
17 është diskutuar asnjëherë në një takim të Shtabit të
18 Përgjithshëm përpara se të bie dakord me të, a është e saktë
19 kjo, Dëshmitar?

20 PË. Aty ku kam qenë unë nuk është diskutu kurrë një
21 marrëveshje e tillë. Nuk më është -- Agim Çeku, Agim Çeku ka
22 ardh në luftë, ka ardh në fund të luftës.

23 PY. Në qoftë se kjo marrëveshje nuk është diskutuar në asnjë
24 nga takimet ku keni marrë pjesë ju, a keni ju ndonjë njohuri
25 për ndonjë takim konkret ku është diskutuar një çështje e

1 tillë po ku ju nuk keni qenë i pranishëm, Dëshmitar?

2 PË. Unë thashë vetëm për aq sa më ka thënë Bislime Zyrapi, se
3 thjesht marrëveshja, një marrëveshje e kemi pas, po për
4 ushtarët e FARK-ut me hi nën emblemën e Ushtrisë çlirimtare të
5 Kosovës. Këtë e kam kuptu. Si dhe me ardh oficerët e
6 karrierës.

7 PY. Në rregull. Ta them më shkoqur. Ky është një vendim
8 kryesor, ky është një vendim i rëndësishëm për të cili ju nuk
9 keni njohuri që Shtabi i Përgjithshëm në mënyrë të
10 përgjithshme kolektive e ka shqyrtuar marrëveshjen dhe ka rënë
11 dakord për ta respektuar atë, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

12 PË. A mund t'i referohem datës të lutna, se nuk e mora mirë?

13 PY. Po.

14 PË. Datën kur është bërë kjo marrëveshje?

15 PY. Po.

16 Z. MISETIÇ: [Përkthim] Të kalojmë dy faqe më përpara. Në
17 fund.

18 PY. E shikoni është dokument i cili është nënshkruar nga
19 Bislime Zyrapi dhe Kadri Veseli në emër të UÇK-së. Po ju bëj
20 pyetjen edhe një herë tjetër dhe po e ndryshoj, po e
21 perifraroj pyetjen. Ju nuk keni informacion që Shtabi i
22 Përgjithshëm ka autorizuar Bislime Zyrabin dhe Kadri Veselin që
23 të dy ta nënshkruajnë këtë marrëveshje --

24 PË. Jo.

25 PY. -- a është e saktë kjo, Dëshmitar?

1 PË. E saktë është. E saktë.

2 PY. Pra, unë ju sugjeroj ose ju propozoj se janë marrë
3 vendime të rëndësishme në emër të UÇK-së që nuk përfshinin një
4 proces vendimmarrës kolegjal ose kolektiv nga anëtarët e UÇK-
5 së përpara ristrukturimit të tilla si, për shembull, kjo
6 marrëveshje ose respektimi i armëpushimit ose emërimi i
7 përfaqësuesve politikë në gusht. A pajtoheni ju me mua lidhur
8 me këto, Dëshmitar?

9 PË. Po.

10 PY. Dëshmia juaj është që edhe komunikatat janë nxjerrë apo
11 janë lëshuar pa vendimmarrjen kolektive të UÇK-së, a është e
12 saktë kjo?

13 PË. Unë nuk kam pas informacion rreth lëshimit të
14 komunikatave në asnjë moment, mund të konstatoj se mund të
15 jetë edhe kështu.

16 PY. Po. Por ju keni qenë pjesë e Shtabit të Përgjithshëm që
17 prej fillimit?

18 PË. Po.

19 PY. Kështu që unë po jua them si fakt, po ju them, po ju
20 parashtroj se në qoftë se ju nuk keni dit ndonjë gjë vetë
21 drejtpërdrejt, pra, i takon që kjo temë, për shembull, tema e
22 komunikatave nuk është diskutuar nga Shtabi i Përgjithshëm në
23 mënyrë kolektive?

24 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtojmë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

1 Z. MISETIC: [Përkthim]

2 PY. Tani, Dëshmitar, do të diskutojmë diçka që ka ndodhur në
3 nëntor. Po përpara kësaj do ju bëj disa pyetje tjera. Shtabi i
4 Përgjithshëm a ka marrë projekte fillestare ose drafte të
5 rregulloreve dhe a i ka miratuar ato përpara sesa ato të hynin
6 në fuqi ose që të lëshoheshin? Domethënë, po ju pyes lidhur me
7 atë çfarë dini ju personalisht me informacionin që ju e dini
8 personalisht.

9 PË. Disa, disa rregullore të cilat i ka sjellë Bislime Zyrapi
10 edhe janë diskutuar, por ato mbasi është bërë strukturimi i
11 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në atë periudhë.

12 PY. Në fakt e keni të drejtë sesi ju përgjigjët se duhet ta
13 kisha formuluar ndryshe, pra, të thoja përpara ristrukturimit.
14 A keni marrë rregullore dhe drafte paraprake të tyre përpara
15 miratimit të tyre, domethënë, përpara ristrukturimit?

16 PË. Rregullore? Nuk e mbaj mend nëse kemi marrë ndonjë
17 rregullore tjetër.

18 PY. Në rregull. A keni marrë ndonjëherë pjesë në ndonjë takim
19 të Shtabit të Përgjithshëm ku ka pasur diskutim për krijimin e
20 pikave të ndalimit ose qendrave të ndalimit?

21 PË. Jo. S'po di saktë. Do të ishte mirë me ma shpjegu në
22 kuptimin e "pikave të ndalimit". E keni fjalën për ato ku
23 krijoheshin zonat e lira të UÇK-së apo për ndonjë pikë tjetër?

24 PY. Nuk e kam fjalën për punktet ose postblloqet. E kam
25 fjalën për vendin ku ndaloheshin persona që arrestoheshin, për

1 shembull, me dyshimin që mund të ishin bashkëpunëtorë ose
2 kolaboracionistë, për këtë e kam fjalën kur them "qendra
3 ndalimi".

4 PË. Jo, nuk e di për këtë. S'e besoj që ka pas.

5 PY. Në rregull. Po intervista të medias nga anëtarë konkretë
6 ose individual të Shtabit të Përgjithshëm, domethënë, përpara
7 sesa të jepeshin intervistat për median nga anëtarë të Shtabit
8 të Përgjithshëm a merrej miratim nga Shtabi i Përgjithshëm?

9 PË. Jo, s'e besoj që është marrë. Deklaratat publike kanë
10 qenë -- s'po them që ka qenë e drejtë, po kanë qenë ekskluzive
11 të individëve që i kanë dhënë ato. Nuk kemi pas një
12 marrëveshje për deklaratat, përpos ato të cilat zëdhënësi i
13 UÇK-së i ka paraqitë.

14 PY. Në transkript në faqen 22986, duke filluar nga rreshti 22
15 ju thoni si më poshtë. Pyetja ishte kjo:

16 "Kur ju dha mundësia për të korigjuar deklaratën tuaj
17 përpara një jave, pse nuk e korigjuat këtë pjesë?"

18 Ju u përgjigjët:

19 "Unë kisha në mendje masat ndëshkuese në kuptimin që ne
20 nuk kishim dokumente me shkrim për raste specifik ose
21 konkrete. Për raste të përgjithshme, ka pasur kundërshtime dhe
22 e ka pasur thirrje për të gjithë për ata që bashkëpunonin me
23 armikun. Dhe më pas ishte përgjegjësi e komandantëve të zonës
24 për të marrë veprime.

25 "PY. Tani e kuptoj mënyrën sesi e përshkruat juve ky

1 ishte një vendim kolektiv i Shtabit të Përgjithshëm?"

2 Dhe ju thoni:

3 "Unë besoj që ka qenë venim kolektiv."

4 Ju keni thënë në paragrafin 37 të Shënimit Përgatitor 2
5 dhe e keni përsëritur disa herë sot këtu që ju nuk e dini se
6 kush i ka lëshuar komunikatat pas janarit 1997, a është e
7 saktë kjo, Dëshmitar?

8 PË. Po.

9 PY. Në qoftë se janë bërë thirrje pas janarit të 1997 për të
10 mos bashkëpunuar, kush i ka bërë këto thirrje, Dëshmitar?

11 PË. Unë ju kam referu atëherë kur kam deklaruar para
12 Tribunalit, para oficerëve të Tribunalit, se ju kam referuar
13 shkrimeve, komunikatave të cilat kam pas mundësi me i lexu.
14 Thirrjeve që kanë bërë komunikatat në brendinë e tyre për ato
15 kategori.

16 PY. Po. Por kur ju sugjerua që ishte një vendim kolektiv i
17 Shtabit të Përgjithshëm ju thatë, po, e pranuat këtë sugjerim
18 të pyetjes së bërë në drejtimin tuaj. Kështu që pyetja që kam
19 për ju është kjo: Kur është vendosur në mënyrë kolektive nga
20 Shtabi i Përgjithshëm dhe nga kush konkretisht në Shtabin e
21 Përgjithshëm është vendosur që të bëhet një thirrje për të mos
22 bashkëpunuar me armikun? Në qoftë se ka ndodhur kështu,
23 kuptohet.

24 PY. Nuk po e di që ka ndodh që është marrë një vendim kështu
25 komplet në Shtabin e Përgjithshëm, domethënë, nuk është marrë

1 një vendim konkret, po kështu në gjeneral është folur për këto
2 kategori. Dhe ato ça i kam lexu në përmes komunikatave që kanë
3 dalë, që kanë dalë në emër të Shtabit të Përgjithshëm,
4 pikërisht atyre ju kam referu, jo që kam pas diçka specifike
5 për të.

6 PY. Dua që të bëjmë një dallim këtu. Tani po thoni që
7 pavarësisht se kush e ka lëshuar komunikatat, ata që i kanë
8 lëshuar komunikatat ata i kanë bërë këto thirrje, këtë po
9 thoni?

10 PË. Po.

11 PY. Përsëri dua që të jemi të qartë tërësisht këtu. Ju thoni
12 që nuk keni njohuri për asnjë takim ose kohë ose vend konkret
13 ose njerëz konkret të cilët kanë diskutuar ndonjëherë çështjen
14 e lëshimit të komunikatave për t'i bërë thirrje njerëzve për
15 të mos bashkëpunuar, a është kështu, është e saktë kjo?

16 PË. Po, kjo është e saktë. Kam thënë edhe një herë, po
17 mundohna me e sqaru, se tash dhe intervistat kur i kam dhënë
18 për Tribunalin i kam dha mbas ngjarjeve domethënë. Dhe kur po
19 referohemi nganjëherë kohës së shkuar edhe po mund të
20 ngatërrohen, domethënë, gjërat për në cilën kohë. Po realisht
21 unë ju kam referu çdo herë komunikatave të cilat i kam parë në
22 opinion, ku në ato komunikata kam lexuar se i është bërë
23 thirrje të gjithë bashkëpunëtoreve që të mos bashkëpunojnë me
24 armikun. Këtë kam dash me thënë gjithmonë.

25 PY. Tani do kalojmë tek një temë tjetër. Në deklaratën që

1 është prova gjyqësore e pranuar tani P01870.5, faqja 10, duke
2 filluar nga rreshti 20 në anglisht dhe në faqen 11, rreshti 1
3 në shqip, ju i keni thënë TPNJ-së se Shtabi i Përgjithshëm ka
4 qenë përgjegjës për shtabin operativ dhe shtabi operativ
5 përbëhej nga komandantët e zonave. A ju kujtohet ta keni thënë
6 këtë, Dëshmitar?

7 PË. Këtë e kam thënë, po. Po e kam thënë në kuptimin në
8 kuptimin e rregullt të hierarkisë mbasi është bë strukturimi i
9 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

10 PY. Në rregull. Kur ka filluar të ekzistojë shtabi operativ?

11 PË. Nga -- shtabi operativ kur janë bë zonat operative dhe me
12 strukturim kujtoj.

13 PY. A ka pasur shtab operativ në 1997?

14 PË. Shtab operativ në 1997-n ka qenë i shkapërderdhur shtabi
15 operativ. Me burgosjen e Nait Hasanit, me largimin e Xheladin
16 Gashit në Shqipëri, pastaj me vrasjen e Zahirit, me burgosjen
17 e Bislam Zogajt, shtabi operativ ka qenë, domethënë, i
18 shpërbërë në kuptimin funksional.

19 PY. Shtabi operativ, mesa keni njohuri juve, a kishte takime,
20 ka bërë takime?

21 PË. Ka bërë takime. Ato takime kryesisht i ka mbajtur Nait
22 Hasani, nganjëherë më duket edhe Xheladin Gashi, për aq sa kam
23 informacion.

24 PY. A keni njohuri se çfarë është diskutuar në këto takime të
25 komandantëve të zonave?

1 PË. Për aq sa më ka fol Nait Hasani, po. Është bë unifikimi i
2 këtyre grupeve, bashkime i tyre. Është bë thirrje si të
3 unifikohen dhe të bashkohen këto grupe, të masivizojnë grupet
4 me njerëz, si dhe është bisedu për format e mbështetjes
5 logjistike të tyre.

6 PY. A e dini në qoftë se ata e kanë diskutuar çështjen e
7 kolaboracionistëve ose bashkëpunuesve, bashkëpunëtorëve në
8 këto takime të komandantëve të zonës, Dëshmitar?

9 PË. Jo, këtë nuk e di.

10 PY. Do t'ju bëj disa pyetje lidhur me një temë që e trajtoi
11 Prokurori me ju.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Të shohim dokumentin SPOE0023829
13 deri në SPOE00230900-ET E Rishikuar 1, në faqen SPOE00230871
14 në anglisht. Dhe versioni në shqip ka të njëjtin numër SPOE.
15 Duhet të jetë në faqen 43 të PDF.

16 PY. Dëshmitar, do t'ju bëj disa pyetje lidhur me këtë. Së
17 pari, atëherë e para, ju kujtohet që ju bënë disa pyetje
18 lidhur me këtë. Ky është një fragment i librit të z. Krasniqi
19 dhe ka të bëjë me bisedat që janë zhvilluar në Negroc, a ju
20 kujtohet kjo, Dëshmitar?

21 PË. Po.

22 PY. A shikoni aty, për shembull, drejtorinë politike në
23 libër, Dëshmitar?

24 PË. Po.

25 PY. Atëherë vetkorrigjohem këtu se është një shkrim nuk është

1 libër. Ku e shikoni, na e thoni pak ju lutem, ku e shikoni
2 drejtorinë politike?

3 PË. Përgjegjës për drejtorinë politike është -- te paragrafi
4 9 dhe 10.

5 PY. Dhe këtu është një diskutim ku thuhet që pjesë e saj do
6 ishin z. Thaçi, z. Krasniqi, z. Veseli dhe Xhavit Haliti, po
7 apo jo?

8 PË. Po.

9 PY. Por, pra, pretendoj që të ketë sa i takon emërimit,
10 emërimi këtu është për drejtorinë e informimit, apo jo? A
11 është e saktë që drejtoria e informimit nënkuptonte që z.
12 Thaçi në atë kohë është marrë me median?

13 PË. Unë nuk e di këtu. Po kjo në shpërputhje me këto ça, me
14 këto emërimet se drejtori politike në atë kohë, unë mesa e di,
15 nuk ka pas. Nuk ka pas.

16 PY. Po. Po pyetja që po ju bëj tani është një pyetje më e
17 përgjithshme. A e keni kuptuar ju asokohe që, në këtë
18 periudhë, domethënë, rreth qershorit të 1998 kryesisht, është
19 marrë me mediat, domethënë, ka qenë përgjegjës për mediat, a e
20 keni kuptuar dhe ju kështu, Dëshmitar?

21 PË. Unë nuk e di me çfarë është marrë në atë kohë z. Thaçi.
22 Për me median nuk më kujtohet dhe nuk e di. Thashë që në
23 qershor e kam pas një rast në familjen time dhe realisht jam
24 marrë më tepër rreth familjes në këtë moment mbas vdekjes së
25 babait. Por nuk më kujtohet që është marrë me mediat. S'më

Dëshmitari: Sokol Bashota (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 156

1 kujtohet.

2 PY. Në rregull.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, shikoj kohën.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Bashota,
5 përfunduar edhe për sot dëshminë. Do të duhet të ktheheni
6 nesër në orën 9.00 të mëngjesit. Do të vazhdojmë nesër
7 paradite në orën 9.00.

8 Z. Qerkini, faleminderit që ishit me ne sot.

9 Mund të largoheni të dy nga salla e gjyqit.

10 z. Bashota, ju lutem mos diskutoni me askënd lidhur me
11 dëshminë përpara Trupit Gjykses, me askënd jashtë Gjykatës.
12 Mbrëmje të këndshme.

13 DËSHMITARI: Faleminderit.

14 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E mbylлим
16 këtu seancën. Do të rishihemi përsëri në orën 9.00 nesër
17 paradite.

18 --- Seanca mbyllet në orën 16.30

19

20

21

22

23

24

25